

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE MJEKËSORE

DISERTACION

I

PARAQITUR NGA

Znj.Brunilda MËHILLI

PËR MARRJEN E GRADËS SHKENCORE

DOKTOR

SPECIALITETI: Shëndet Publik

TEMA: SJELLJET RISKANTE TEK TË RINJTË NË QARKUN E ELBASANIT

Udhëheqës Shkencor: Prof.Dr.Enver ROSHI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË
FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE

DISERTACION

I

PARAQITUR NGA

Znj.Brunilda Mëhilli

PËR MARRJEN E GRADËS SHKENCORE

DOKTOR

SPECIALITETI: Shëndet Publik

TEMA: Sjelljet riskante tek të rinjtë në Qarkun e Elbasanit

Udhëheqës Shkencor: Prof.Dr.Enver ROSHI

MBROHET MË DATË...../...../2016

PARA JURISË

1. _____ **KRYETAR**
2. _____ **ANËTAR (OPONENT)**
3. _____ **ANËTAR (OPONENT)**
4. _____ **ANËTAR**
5. _____ **ANËTAR**

Përmbajtja

Përmbajtja.....	IV
Parathënie	V
Falenderime	VI
Lista e Shkurtimeve.....	VII
Lista e tabelave	VIII
Lista e grafikëve	X
1. HYRJE.....	XIII
1.1 Situata epidemiologjike e sjelljeve riskante në botë.....	XIII
1.2 Situata epidemiologjike e sjelljeve riskante tek të rinjtë në Shqipëri.....	XV
1.3 Të dhëna të përgjithshme mbi Qarkun e Elbasanit.....	XIX
1.4 Konceptet teorike të disa prej sjelljeve riskante	XXI
2. Qëllimi dhe Objektivat e studimit	1
2.1 Qëllimi i studimit.....	1
2.2 Objektivat e studimit.....	1
2.2.1 Objektiva të përgjithshëm	1
2.2.2 Objektiva specifike:	1
3. Metodologjia	3
3.1 Tipi i studimit.....	3
3.2 Zgjedhja e popullatës të marrë në studim	3
3.3 Mbledhja e të dhënave	5
3.4 Analiza Statistikore.....	6
4. Rezultatet.....	7
5. Diskutimi	76
6. Përfundime.....	88
7. Rekomandime	90
8. Referencat.....	92
9. Aneksë	96
10. Përmbledhje	143

Parathënie

Studimi i sjelljeve që ndikojnë në jetën e të rinjve është sa interesant aq edhe i vështirë, sepse janë grupi i popullatës me një dinamikë të vazhdueshme dhe me shumë energji. Të rinjtë përbëjnë atë pjesë të popullatës njerëzore midis moshës 10 dhe 24 vjeç. Shqipëria ka një popullsi me moshë të re, ku 33% janë nën moshën 15 vjeç dhe gjysma nën moshën 25 vjeç. Pra një popullsi me energji vitale sikurse e karakterizon rininë .

Sjelljet riskante janë ato sjellje që mund të kenë efekte negative në zhvillimin e përgjithshëm dhe mirëqënien e të rinjve, ose që mund t'i pengojnë ata nga sukseset dhe zhvillimi i ardhshëm. Sjelljet riskante gjithashtu mund të ndikojnë tek të rinjtë duke ndërprerë zhvillimin e tyre normal ose ti pengojnë ata nga pjesëmarrja në përvojat "tipike" për grupmoshën e tyre.

Disa sjellje riskante janë me interes të veçantë tek profesionistët për shkak të mbizotërimit të tyre tek të rinjtë sot. Shumë nga këto sjellje shkaktojnë një numër të madh të vdekjeve dhe lëndimeve midis adoleshentëve dhe të rinjve, si dhe kanë ndikime negative në shoqëri. Disa nga sjelljet me risk të lartë shëndetësor që kontribuojnë në shkaqet kryesore të vdekjes dhe paaftësisë tek të rinjtë dhe të rriturit, përfshijnë: Sjelljet që kontribuojnë për lëndime të paqëllimshme dhe dhunë, sjelljet seksuale që kontribuojnë për shtatzani të padëshiruar dhe sëmundje seksualisht të transmetueshme, duke përfshirë infeksionin HIV, përdorimi i alkoolit dhe i droga të tjera, konsumi i duhanit, sjelljet dietetike të pashëndetshme (mbipësha dhe obeziteti, aktiviteti i pamjaftueshëm fizik, mënyra e ushqyerjes).

Për shkak se sjelljet riskante mund të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në jetën e të rinjve dhe atyre përreth, është e rëndësishme që prindërit, edukatorët dhe të rriturit e tjerë të interesuar, të bëhen të vetëdijshëm për përhapjen e këtyre sjelljeve, faktorët që rrisin gjasat e tyre, dhe çfarë mund të bëhet për t'i hequr ose për t'i parandaluar ato.

Pra, në këtë kuadër ne ndërmorëm një studim për të vlerësuar shpërndarjen dhe rëndësinë e këtyre sjelljeve riskante, ndikimin që ata kanë tek të rinjtë.

Falenderime

Dëshiroj të falenderoj përzemërsisht udhëheqësin tim shkencor, *Prof.Dr.Enver ROSHI*, për

mbështetjen dhe inkurajimin e tij të vazhdueshëm përgjatë gjithë periudhës së këtij studimi, hartimit të dizertacionit përfundimtar dhe artikujve shkencorë, të botuar në revista kombëtare dhe ndërkombëtare.

Dëshiroj të falenderoj përzemërsisht *Prof.Dr.Petrit BARE* që më krijoi mundësinë për të vazhduar këtë cikël studimi shumë të rëndësishëm për formimin tim të mëtejshëm.

Dëshiroj të falenderoj gjithashtu *Prof.Dr.Skënder TOPI* për inkurajimin dhe mbështetjen e tij të vazhdueshme.

Dëshiroj të falenderoj të gjithë kolegët e Qendrës Spitalore “Xhaferr Kongoli”, Elbasan dhe Rektoratin e Universitetit të Elbasanit, për bashkëpunimin e ngushtë dhe atmosferën mbështetëse dhe miqësore përgjatë gjithë periudhës së këtij studimi.

Dëshiroj të falenderoj të gjithë mësuesit e shkollave të mesme që më ndihmuan në realizimin e këtij studimi dhe Drejtorinë Arsimore në Qarkun e Elbasanit.

Falenderime të veçanta për të gjithë miqtë dhe kolegët e mi që më inkurajuan dhe mbështetën në punën time kërkimore-shkencore.

Së fundi, falenderimet më të veçanta ia rezervoj familjes sime, për mbështetjen maksimale gjatë gjithë periudhës së realizimit të këtij studimi.

Lista e Shkurtimeve

CDC – Qendra për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve në SH.B.A.

YRBSS - Youth Risky Behaviors Surveillance System

SMSRrR - Sistemi i Mbikqyrjes së Sjelljeve Riskante tek të Rinjtë

SH.B.A - Shtetet e Bashkuara të Amerikës

FNT - Faktori Neurotropik i Trurit

5-HT2A - Receptor i Serotoninës

AND - Acidi DesoksiriboNukleik.

BCA - Blood cell concentration

PAGJ - Përqëndrimi i alkoolit në gjak

THC - Tetrahydrocannabinol

CBD - Cannabidiol

CBN - Cannabinol

THCV - Tetrahydrocannabivarin

CBG - Cannabigerol

Met - Metamfetaminë

HIV - Virusi i Imunodeficensës Njerëzore

SPOK - Sëmundja pulmonare obstruktive kronike

SIDS - Sindromi i Vdekjes së Papritur Foshnjore

BMI (body mass index) – TMT (Treguesi i masës trupore)

IQ (Intelligence Quotient) - Koefficienti Intelktual (KI)

ISHP - Instituti i Shëndetit Publik

ADHS - Albania Demographic and Health Survey

SDShSh - Studimi Demografik dhe Shëndetsor në Shqipëri

Lista e tabelave

Tabela Nr. 1 – Ndarja administrative e qarkut Elbasan

Tabela Nr. 2 - Shkolla e Mesme “Shefqet Guzi” Gramsh

Tabela Nr. 3 - Shkolla e Mesme “Zihni Magani” Peqin

Tabela Nr. 4 - Shkolla e Mesme “Kostandin Kristoforidhi” Elbasan

Tabela Nr. 5 - Shkolla e Mesme “Dhaskal Todri” Elbasan

Tabela Nr. 6 - Universiteti “AleksandërXhuvani”, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Elbasan

Tabela Nr. 7 Karakteristikat demografike

Tabela Nr. 8 Përdorimi i Masave mbrojtëse në rrugë

Tabela Nr. 9 Prevalenca e Dhunës tek të rinjtë

Tabela Nr. 10 Prevalenca e Vetëvrasjes

Tabela Nr. 11 Prevalenca e Duhanpirjes

Tabela Nr. 12 Prevalenca e Përdorimit të Alkoolit

Tabela Nr. 13 Prevalenca e Përdorimit të Drogave

Tabela Nr. 14 Prevalenca e Sjelljeve seksuale

Tabela Nr. 15 Prevalenca e Peshës trupore

Tabela Nr. 16 Prevalenca e Aktivitetit Fizik

Tabela Nr. 17 Prevalenca e Mënyrës së Ushqyerjes

Tabela Nr. 18 Prevalenca e Informacionit rreth Shëndetit

Tabela Nr. 19 Lidhja midis Moshës dhe Masave mbrojtëse në rrugë

Tabela Nr. 20 Lidhja ndërmjet Moshës dhe Dhunës tek të rinjtë

Tabela Nr. 21 Lidhja midis Moshës dhe Vetëvrasjes

Tabela Nr. 22 Lidhja midis Moshës dhe Duhanpirjes

Tabela Nr. 23 Lidhja midis Moshës dhe Përdorimit të Alkoolit

Tabela Nr. 24 Lidhja midis Moshës dhe Përdorimit të Drogave

Tabela Nr. 25 Lidhja midis Moshës dhe Sjelljeve seksuale

Tabela Nr. 26 Lidhja midis Moshës dhe Peshës trupore

Tabela Nr. 27 Lidhja midis Moshës dhe Aktivitetit fizik

Tabela Nr. 28 Lidhja midis Moshës dhe Mënyrës së Ushqyerjes

Tabela Nr. 29 Lidhja midis Moshës dhe Informacionit rreth Shëndetit

Tabela Nr. 30 Lidhja midis Gjinisë dhe Masave mbrojtëse në rrugë

Tabela Nr. 31 Lidhja midis Gjinisë dhe Dhunës tek të rinjtë

Tabela Nr. 32 Lidhja midis Gjinisë dhe Vetëvrasjes

Tabela Nr. 33 Lidhja midis Gjinisë dhe Duhanpirjes

Tabela Nr. 34 Lidhja midis Gjinisë dhe Përdorimit të Alkoolit

Tabela Nr. 35 Lidhja midis Gjinisë dhe Përdorimit të Drogave

Tabela Nr. 36 Lidhja midis Gjinisë dhe Sjelljeve seksuale

Tabela Nr. 37 Lidhja midis Gjinisë dhe Peshës trupore

Tabela Nr. 38 Lidhja midis Gjinisë dhe Aktivitetit fizik

Tabela Nr. 39 Lidhja midis Gjinisë dhe Mënyrës së Ushqyerjes

Tabela Nr. 40 Lidhja midis Gjinisë dhe Informacionit rreth Shëndetit

Tabela Nr. 41 Lidhja midis Vendbanimit dhe Masave mbrojtëse në rrugë

Tabela Nr. 42 Lidhja midis Vendbanimit dhe Dhunës tek të rinjve

Tabela Nr. 43 Lidhja midis Vendbanimit dhe Vetëvrasjes

Tabela Nr. 45 Lidhja midis Vendbanimit dhe Përdorimit të Alkoolit

Tabela Nr. 46 Lidhja midis Vendbanimit dhe Përdorimit të Drogave

Tabela Nr. 47 Lidhja midis Vendbanimit dhe Sjelljeve seksuale

Tabela Nr. 48 Lidhja midis Vendbanimit dhe Peshës trupore

Tabela Nr. 49 Lidhja midis Vendbanimit dhe Aktivitetit fizik

Tabela Nr. 50 Lidhja midis Vendbanimit dhe Mënyrës së Ushqyerjes

Tabela Nr. 51 Lidhja midis Vendbanimit dhe Informacionit rreth Shëndetit

Lista e grafikëve

Grafiku Nr. 1 Karakteristikat demografike

Grafiku Nr. 1/1 Moshë

Grafiku Nr. 1/2 Gjinia

Grafiku Nr. 1/3 Klasa

Grafiku Nr. 1/4 Vendbanimi

Grafiku Nr. 2 Prevalenca e Përdorimit të Masave mbrojtëse në rrugë

Grafiku 2/1 Përdorimi i kokores kur nget biçikletën ose motorrin

Grafiku Nr.2/2 Përdorimi i rripit të sigurimit

Grafiku Nr. 2/3 Udhëtimi me makinë me drejtuesin i cili ka konsumuar alkool

Grafiku Nr. 2/4 Drejtim të makinës pasi është konsumuar alkool

Grafiku Nr. 3 Prevalenca e Dhunës tek të rinjtë

Grafiku Nr. 3/1 Armëmbajtje

Grafiku Nr. 3/2 Përfshirja në një ndeshje fizike

Grafiku Nr. 3/3 Përfshirja në një ndeshje fizike me rezultat trajtimin mjekësor

Grafiku Nr. 3/4 Përfshirja në ndeshje fizike në ambientet e shkollës

Grafiku Nr. 3/5 Dhunë fizike nga i dashuri/a

Grafiku Nr. 3/6 Marrëdhënie seksuale me dhunë

Grafiku Nr. 4 Prevalenca e Vetëvrasjes

Grafiku Nr. 4/1 Mendimi për vetëvrasjen

Grafiku Nr. 4/2 Planifikimi për vetëvrasje

Grafiku Nr. 4/3 Përpjekje për vetëvrasje

Grafiku Nr. 4/4 Tentativë për vetëvrasje në 12 muajt e fundit

Grafiku Nr. 4/5 Tentativë vetëvrasjeje që ka kërkuar trajtim mjekësor

Grafiku Nr. 5 Prevalenca e Duhanpirjes

Grafiku Nr. 5/1 Prova e parë e duhanpirjes

Grafiku Nr. 5/2 Moshë e provimit të duhanit për herë të parë

Grafiku Nr. 5/3 Duhanpirja gjatë 30 ditëve

Grafiku Nr. 5/4 Mënyra e sigurimit të cigareve

Grafiku Nr. 5/5 Pirja e duhanit në ambiente shkollore

Grafiku Nr. 5 /6 Tentativa për të ndërprerë pirjen e duhanit

Grafiku Nr. 6 Prevalenca e Përdorimit të Alkoolit

Grafiku Nr. 6/1 Përdorimi i alkoolit për herë të parë

Grafiku Nr. 6/2 Moshë e fillimit të konsumimit të alkoolit për herë të parë

Grafiku Nr. 6/3 Konsumimi i alkoolit gjatë 30 ditëve

Grafiku Nr. 6/4 Mënyra e sigurimit të alkoolit gjatë 30 ditëve

Grafiku Nr. 7 Prevalenca e Përdorimit të Drogave

Grafiku Nr. 7/1 Përdorimi i marihuanës gjatë jetës

Grafiku Nr. 7/2 Përdorimi i marihuanës gjatë 30 ditëve të fundit

Grafiku Nr. 7/3 Përdorimi i marihuanës në territor shkollor

Grafiku Nr. 7/4 Përdorimi i kokainës

Grafiku Nr. 7/5 Përdorimi i kokainës gjatë 30 ditëve të fundit

Grafiku Nr. 7/6 Përdorimi i heroinës

Grafiku Nr. 7/7 Përdorimi i metamfetaminës

Grafiku Nr. 7/8 Përdorimi i ekstazisë

Grafiku Nr. 7/9 Përdorimi i pilulave steroide pa recetë

Grafiku Nr. 7/10 Përdorimi i drogave të lejuara pa recetën e mjekut

Grafiku Nr. 7/11 Përdorimi i shiringës në trup

Grafiku Nr. 7/12 Ofertë droge në ambientet shkollore

Grafiku Nr. 8 Prevalenca e Sjelljeve seksuale

Grafiku Nr. 8/1 Marrëdhënie seksuale

Grafiku Nr. 8/2 Raporti i parë seksual dhe moshë

Grafiku Nr. 8/3 Marrëdhëniet seksuale dhe numri i partnerëve

Grafiku Nr. 8/4 Marrëdhënie seksuale dhe përdorimi i alkoolit dhe drogës

Grafiku Nr. 8/5 Marrëdhënie seksuale dhe përdorimi i kondomit

Grafiku Nr. 8/6 Marrëdhënie seksuale dhe tentativa për të parandaluar shtatzaninë e padëshiruar

Grafiku Nr. 9 Prevalenca e Peshës trupore

Grafiku Nr. 9/1 Perceptimi i peshës trupore

Grafiku Nr. 9/2 Përdorimi i pilulave pa recetë për të ruajtur peshën trupore

Grafiku Nr. 9/3 Mosngrënia për 24 orë për të ruajtur peshën trupore

Grafiku Nr. 9/4 Përdorimi i laksativëve për të ruajtur peshën trupore

Grafiku Nr. 10 Prevalenca e Aktivitetit Fizik

Grafiku Nr. 10/1 Ushtrim aktiviteti fizik gjatë një jave për të paktën 20 minuta

Grafiku Nr. 10/2 Koha e përdorimit të kompjuterit për videoljra ose internet

Grafiku Nr. 10/2 Koha e të parit televizor gjatë ditëve të shkollës

Grafiku Nr. 10/3 Ushtrimi i edukimit fizik gjatë 7 ditëve

Grafiku Nr. 11 Mënyra e Ushqyerjes

Grafiku Nr. 11/1 Përdorimi i lëngjeve të shtrydhur të frutave gjatë një jave

Grafiku Nr. 11/2 Përdorimi i frutave gjatë një jave

Grafiku Nr. 11/3 Përdorimi i sallatës jeshile gjatë një jave

Grafiku Nr. 11/4 Përdorimi i perimeve gjatë një jave

Grafiku Nr. 11/5 Përdorimi i lëngjeve të gazuara gjatë një jave

Grafiku Nr. 11/6 Përdorimi i qumështit gjatë një jave

Grafiku Nr. 11/7 Përdorimi i vaktit të mëngjesit gjatë një jave

Grafiku Nr. 12 Prevalenca e Informacionit rreth Shëndetit

Grafiku Nr. 12/1 Informacion i marrë në shkollë rreth HIV/SIDËS

Grafiku Nr. 12/2 Analiza të kryera për HIV

Grafiku Nr. 12/3 Përdorimi i kremit mbrojtës në ditët me diell

Grafiku Nr. 12/4 Koha e gjumit në ditët normale të shkollës

Grafiku Nr. 12/5 Konsultim me të rriturit ose mësuesin për probleme të ndryshme

1. HYRJE

1.1 Situata epidemiologjike e sjelljeve riskante në botë

Pjesa e popullatës njerëzore e përfaqësuar nga të rinjtë, janë njerëzit mes moshës 10 dhe 24 vjeç¹. Të rinjtë janë përcaktuar shpesh si persona që kanë mbaruar arsimin e detyrueshëm, dhe është moshë në të cilën ata mund të gjejnë punësimin e tyre të parë¹. Të rinjtë përfaqësojnë të ardhmen e çdo shoqërie apo kulture, dhe të vetë shëndetit njerëzor.¹

Megjithatë kushtet sociale janë përcaktuesit madhorë të shëndetit. Forcat sociale veprojnë duke rimodeluar përgjigjet biologjike individuale, sjelljet riskante, ekspozimin ndaj faktorëve ambientale dhe aksesin në shërbime të kujdesit mjekësor. Historia sociale dhe e zhvillimit përmbledh jetën e individit, sipas një renditjeje kronologjike; foshnjëria, fëmijëria, adoleshenca dhe pjekuria, ku secila fazë ka ndikimin saj në jetë². Një periudhë shumë interesante është adoleshenca². Kjo është një kohë e rëndësishme në jetë për marrjen e shumë vendimeve, duke përfshirë arsimimin, miqtë dhe raportet seksuale. Disa prej këtyre vendimeve mund të ndikojnë tek adoleshentët për pjesën tjetër të jetës së tyre. Megjithatë, në mes të kësaj kohe zgjedhesh të mëdha, ajo është gjithashtu një periudhë kyçe e formimit të identitetit, ose ndjenjës së të qenurit vetë personi. Adoleshentët kërkojnë të dinë dhe të jenë të njohur nga të tjerët. Edhe pse formimi i identitetit shtrihet gjatë gjithë jetës së një personi, vitet e adoleshencës janë një kohë shumë e rëndësishme për adoleshentët të cilët duan të përcaktojnë se "kush janë". Përveç kësaj, zhvillimi i trurit të një adoleshenti nuk është i plotë. Pjesa e fundit të trurit që zhvillohet është korteksi frontal, e cila është pjesa e trurit që ndihmon në marrjen e vendimeve dhe kontrollin e impulseve. Kjo mund të çojë shumë adoleshentë, të cilët janë duke u përpjekur për të mësuar një botë të re dhe komplekse, në marrjen e vendimeve apo në bërjen e zgjedhjeve të shpejta ose të menjëhershme pa u menduar shumë. Këto vendime mundet gjithashtu të ndikohen nga prindërit, kolegët, vëllezërit dhe motrat.

Sjelljet riskante janë ato sjellje që mund të kenë efekte negative në zhvillimin e përgjithshëm dhe mirëqënien e të rinjve, ose që mund ti pengojnë ata nga sukseset dhe zhvillimi i ardhshëm³. Sjelljet riskante gjithashtu mund të ndikojnë në të rinjtë duke ndërprerë zhvillimin e tyre normal ose ti pengojnë ata nga pjesëmarrja në përvojat "tipike" për grup moshën e tyre³. Gjatë kalimit nga fëmijëria në moshën e rritur, adoleshentët krijojnë modele sjelljeje dhe bëjnë zgjedhje të jetesës që ndikojnë në shëndetin e tyre aktual dhe të ardhshëm. Çështje serioze të shëndetit dhe të sigurisë të tilla si aksidentet me mjete motorrike, dhuna, përdorimi i drogave, mund të ndikojnë negativisht tek adoleshentët dhe të rinjtë.

Disa adoleshentë gjithashtu luftojnë për të adoptuar sjellje që mund të ulin rrezikun e zhvillimit të sëmundjeve kronike në moshë të rritur, të tilla si ushqyerja e shëndetshme, të angazhohen në aktivitet fizik dhe duke zgjedhur të mos përdorin duhan.

Për shkak se sjelljet riskante mund të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në jetën e të rinjve dhe atyre përreth, është e rëndësishme që prindërit, edukatorët dhe të rriturit e tjerë të interesuar, të bëhen të vetëdijshëm për përhapjen e këtyre sjelljeve, faktorët që rrisin gjasat e tyre, dhe çfarë mund të bëhet për t'i parandaluar ato.

Faktorët mbrojtës janë karakteristikat individuale apo mjedisore, kushtet, apo sjelljet që reduktojnë efektet e ngjarjeve stresuese të jetës⁴. Këta faktorë rrisin aftësinë e individit për të shmangur rreziqet dhe nxisin promovimin e kompetencës sociale dhe emocionale në mënyrë që të lulëzojnë në të gjitha aspektet e jetës, në të tashmen dhe të ardhmen⁴.

Disa të dhëna statistikore lidhur me disa nga sjelljet riskante në botë janë si më poshtë:

Aksidentet me mjete motorrike janë shkaku kryesor i vdekjeve ndërmjet adoleshentëve në SH.B.A. Në 2013, shtatë adoleshentë të moshave 16 deri në 19 vjeçare vdisnin çdo ditë nga lëndimet me mjete motorrike⁵. Drejtuesit e mjeteve, adoleshentë të moshave 16 deri në 19 vjeç janë tre herë më të rrezikuar për një aksident fatal se sa një drejtues automjeti i moshës 20 vjeçare⁵.

Dhuna shkakton më shumë se 1.6 milion vdekje në mbarë botën çdo vit⁶. Më shumë se 90% e këtyre ndodhin në vende me të ardhura të ulëta dhe mesatare⁶. Dhuna është një nga shkaqet kryesore të vdekjes në të gjitha pjesët e botës për persona të moshës 15 - 44 vjeç⁶.

Vetëvrasja është shkaku i dhjetë i vdekjeve në Sh.B.A⁷. Tragjikisht, më shumë se 40.000 njerëz vdiqën nga vetëvrasja në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në 2012⁷. 9.4% e personave 12 vjeç dhe më të rritur përdorën drogë të paligjshme në muajin e fundit (2013)⁸. 6.9% e personave 12 vjeç dhe më të rritur kanë përdorur marihuanë në muajin e fundit (2013)⁹. 2.5% e personave 12 vjeç dhe më të rritur përdorën një drogë jomjekësore psikoterapeutike në muajin e fundit (2013)⁹. Më shumë se gjysma (57 %) në klasën e 12-të dhe gati një e pesta (17%) e klasës së 8-të raportojnë se kanë qenë të dehur të paktën një herë në jetën e tyre¹⁰. Përveç kësaj një e katërta (25%) e klasës së 12-të raportojnë të kenë qenë të pijshëm (pesë ose më shumë herë në dy javët e fundit)¹⁰. Abuzimi i rinisë me alkoolin i kushton vendit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës 8223.5 bilion dollare në vit¹⁰. Përdorimi i alkoolit dhe drogave të tjera midis të rinjve rrit gjithashtu mundësinë për lëndime të paqëllimshme, konfrontime fizike, probleme akademike dhe profesionale, dhe sjellje të tjera të paligjshme. Çdo vit, 5000 të rinj vdesin si rezultat i konsumimit të tepërt të pijeve alkoolike në moshë të mitur.¹¹

1.2 Situata epidemiologjike e sjelljeve riskante tek të rinjtë në Shqipëri

Në krahasim me vendet e tjera europiane, Shqipëria ka një popullsi me moshë të re, ku 33% janë nën moshën 15 vjeç dhe gjysma nën moshën 25 vjeç¹². Moshja mesatare e popullsisë është 28.6 vjeç¹².

Disa të dhëna mbi sjelljet riskante tek të rinjtë janë marrë duke u bazuar në studimin e bërë nga Instituti i Shëndetit Publik Shqiptar gjatë vitit 2009^{13,14}, mbi "Sjelljet me risk tek të rinjtë e shkollave të mesme". Disa prej sjelljeve në risk që u shqyrtuan dhe rezultat prej tyre ishin:

1. Vetëvrasja

- Në vitin 2009, 7.4% e nxënësve të shkollave të mesme kishin menduar seriozisht për të kryer vetëvrasje.

- Prevalenca e planifikimit ndonjëherë për të kryer vetëvrasje gjatë vitit të fundit është 6%.

Në ndarjet sipas klasave vihet re një prevalencë dy herë më e madhe në klasat e 10 përkatësisht 9.6% krahasuar me klasat e 11 dhe 12 (3.9% dhe 4.6%).

- Gjatë vitit të fundit shkollor 4% e nxënësve të shkollave të mesme kishin provuar të kryenin vetëvrasje një ose më shumë herë.

- Prevalenca e të provuarit të kryerjes së vetëvrasjes nuk ka ndonjë ndryshim sinjifikant midis meshkujve dhe femrave përkatësisht 2% dhe 5.4%.

2. Përdorimi i duhanit

- Prevalenca e nxënësve të shkollave të mesme që kanë pirë ndonjëherë duhan është 59.1%.

- Në përgjithësi prevalenca e të provuarit të duhanit ndonjëherë në jetë ishte më e lartë në klasat e 10 dhe 11, përkatësisht 62.8% dhe 60.3% se sa në klasat e 12 ku ishte 51.5%. Gjithashtu prevalencat ndryshojnë edhe midis meshkujve dhe femrave me 67.9% dhe 52.8%, të cilët kishin provuar të pinin ndonjëherë duhan.

- Gjatë 30 ditëve të fundit para studimit 30.3% e nxënësve kishin pirë duhan në një ose më shumë ditë. Në ndarjen sipas klasave përqindjet variojnë nga 32.6% në klasën e 10, 28% në klasën e 11 dhe 31.5% në klasën e 12. Prevalencat ndryshojnë në mënyrë sinjifikative midis meshkujve dhe femrave, përkatësisht 45% dhe 19.9%.

16.4% e nxënësve të shkollave të mesme që pinin duhan ishin përpjekur gjatë vitit të fundit ta linin atë.

- Midis nxënësve duhan pirës me moshë <18 vjeç, 14.2% e tyre i kanë blerë cigaret vetë në një dyqan ose si cigare të hapura në rrugë, 7.4% e tyre ja u ka dhënë një shok gjatë 30 ditëve të fundit.

- Gjatë 30 ditëve të fundit para studimit 9.6% e nxënësve të shkollave të mesme kanë pirë duhan në mjediset e shkollës, dhe prej këtyre më shumë meshkujt 19.7% se sa femrat 2.3%.

- 9.5% e nxënësve kanë pirë duhan përditë për më shumë se 30 ditë gjatë jetës së tyre.

3. Përdorimi i Alkoolit

•Në nxënësit e shkollave të mesme 71.1% e tyre kanë pi një pije alkoolike në një ose më shumë ditë. Prevalenca e përdorimit të alkoolit gjatë jetës është më e lartë tek meshkujt se sa tek femrat përkatësisht 79.3% dhe 65.1%. Ndryshime të lehta vihen re edhe në ndarjet sipas klasave ku klasat e 10 dhe 11 kanë përqindje me të lartë të përdorimit të alkoolit (72.7% dhe 72.2%) se sa ato të klasave të 12 me 66.9%.

- 9.1% e nxënësve kanë pi alkool per herë të parë në moshën ≤ 18 vjeç
- Gjatë 30 ditëve të fundit para studimit 53.4% e nxënësve kishin pi një pije alkoolike në një ose më shumë ditë.
- Në përgjithësi ka një ndryshim sinjifikativ midis meshkujve dhe femrave në përdorimin e alkoolit përkatësisht 68% dhe 43%.
- 24.9% e nxënësve të shkollave të mesme kanë pi 5 ose më shumë pije alkoolike radhazi brenda pak orëve në një ose më shumë ditë brenda 30 ditëve të fundit para studimit. Prevalencat janë të ndryshme për meshkuj 38.7% dhe femra 15%.

4. Përdorimi i drogës

•Përqindja e të rinjve të shkollave të mesme që kanë përdorur një herë ose më shumë marihuanë gjatë gjithë jetës së tyre është 7,4 %. Ndërsa 92,6 % e të rinjtë nuk e kanë provuar asnjëherë marihuanën. 50% të rinjve që kanë përdorur marihuanë të paktën një herë në jetën e tyre e kanë përdorur në moshën 15-16 vjeç; në këtë moshë ata i shtyn kurioziteti për të provuar të paktën një herë efektin e marihuanës, ndër këta pjesa më e madhe janë meshkuj dhe janë shumë pak femra.

•Ndërsa vetëm 3 % e nxënësve kanë deklaruar se kanë përdorur të paktën një herë marihuanë në 30 ditët e fundit ndër të cilët pjesa më e madhe janë meshkuj dhe vetëm një përqindje e papërfillshme janë femra. Vetëm gjysma e tyre e kanë përdorur në mjediset e shkollës.

• 92,6 % e të rinjve nuk kanë përdorur asnjëherë marihuanë në jetën e tyre ndërsa fatmirësisht përqindja e të rinjve që nuk kanë përdorur asnjëherë heroinë është 98,1 %. Nga ata që e kanë përdorur shumica e tyre e kanë provuar vetëm një ose 2 herë dhe shumica e tyre janë meshkuj dhe një përqindje shumë e vogël pothuajse e papërfillshme janë femra. Gjatë 30 ditëve të fundit 99 % e të rinjve nuk kanë përdorur asnjëherë heroinë.

•Rreth 4 përqind e të rinjve kanë përdorur ekstazi. Shumica e tyre janë meshkuj dhe e kanë përdorur vetëm një ose dy herë, janë të moshës 13-14 vjeç dhe vetëm 1 në 4 e ka përdorur gjatë 30 ditëve të fundit.

• Të rinjtë që janë në klasën e dhjetë 93,9 % e tyre nuk e kanë përdorur asnjëherë marihuanën, të tjerët që e kanë përdorur shumica e tyre 2,7 % e kanë përdorur 1 ose 2 herë. Ata të klasës së 11, 6,4 % e tyre e kanë përdorur 1 ose 2 herë.

5. Sjelljet seksuale

- 74,1 % e të rinjve të shkollave të mesme nuk kanë kryer asnjëherë marrëdhënie seksuale
- Ekziston një prevalencë e lartë e meshkujve që kanë kryer marrëdhënie seksuale, rreth 50 % e meshkujve. Nga femrat vetëm 9,4 % e tyre kanë kryer marrëdhënie seksuale
- Ndërsa shumica e femrave, më shumë se 50 % e tyre, e kanë kryer marrëdhënien e parë me një partner më të rritur se vetja, nga ata tjetër pjesa më e madhe e meshkujve e kanë kryer marrëdhënien e parë me një bashkëmoshatarë të tyre.

- 22.3 % e meshkujve kanë kryer marrëdhënie seksuale vetëm me një person, ndërsa 25 % kanë kryer marrëdhënie me 2 ose më shumë partnerë të ndryshëm. Vetëm 8,45% e femrave kanë deklaruar që kanë patur një partner dhe 0,7 % që kanë patur 2 ose më shumë partnerë

- Marrëdhënie seksuale nën efektin e drogës rezultojnë të kenë kryer 3,4 % e të intervistuarve.

- Ndërsa përsa i përket përdorimit të masave mbrojtëse gjatë aktit seksual 16,3 % e të intervistuarve kanë treguar që kanë përdorur masa mbrojtëse.

- Ndër 49,5 % e meshkujve që kanë kryer marrëdhënie seksuale përqindja e meshkujve që kanë përdorur alkool ose drogë para se të kryenin marrëdhënie seksuale është shumë e vogël, 7.7 % e meshkujve dhe 34,8 % e tyre kanë përdorur kondom gjatë marrëdhënies. Përdorimi i kondomeve tek meshkujt zë një vend shumë të rëndësishëm ndër të gjitha metodat e tjera që përdoren për të parandaluar një shtatzani.

- Ndër 9,3 % e femrave që kryejnë marrëdhënie, vetëm 0.5 % e femrave kanë përdorur alkool ose ndonjë lloj droge para marrëdhënies dhe rreth 6 % e tyre tregojnë që partneri i tyre nuk ka përdorur kondom gjatë marrëdhënies. Megjithatë ndër të gjitha metodat që përdoren për të parandaluar një shtatzani, përdorimi i kondomeve është metoda më e përdorshme.

- 95 % e meshkujve raportojnë se nuk e kanë lënë ndonjëherë partneren e tyre shtatzënë dhe vetëm 5 % thonë e kanë lënë një herë. Një përqindje e madhe e femrave, 99,5 % e tyre tregojnë që nuk kanë ngelur asnjëherë shtatzënë.

6. Peshë trupore

- Midis nxënësve të shkollave të mesme 23.7% e tyre e përshkruan veten e tyre si pak mbi peshë ose shumë mbi peshë.

- Prevalenca e nxënësve të cilët e përshkruan veten e tyre si pak mbi peshë ose shumë mbi peshë është shumë herë më e lartë tek femrat (30.6%) se sa tek meshkujt (13.9%). Në ndarjet sipas klasave të 10, 11, dhe 12 vihet re një ndryshim i lehtë midis tyre, i kësaj prevalence përkatësisht (23%, 26.1% dhe 20.7%)

- 31.4% e nxënësve treguan se janë duke u përpjekur për të humbur në peshë. Prevalenca e përpjekjeve për të humbur në peshë është më e lartë tek femrat 38% se sa tek meshkujt me 21.8%. Në ndarjet sipas klasave vihet re një prevalencë më e lartë tek nxënësit e klasave të 10 dhe të 11 në krahasim me klasën e 12 përkatësisht (32%, 33.9% dhe 25.9%).

- 45.4% e nxënësve të shkollave të mesme treguan se kishin bërë ushtrime për të rënë ose mos shtuar në peshë gjatë 30 ditëve të fundit para studimit.

- Prevalenca e nxënësve që kanë bërë ushtrime për të humbur ose mos marrë në peshë gjatë 30 ditëve të fundit në ndarjet sipas klasave është më e lartë në klasat e 11 dhe të 10 përkatësisht (33.9% dhe 32%) krahasuar me klasat e 12 ku është 25%. Nuk ka ndryshim të prevalencave midis meshkujve dhe femrave përkatësisht (45% dhe 45.7%).

- Me qëllim për të humbur ose mos shtuar në peshë 48.9% e nxënësve kishin ngrënë më pak, më pak kalori ose ushqime me pak yndyrna, 18.3% kanë ndenjur pa ngrënë, 2.7% kishin marrë pilula dietetike, pluhur ose lëngje të ndryshme të pakëshilluar nga mjeku, 3.7% kishin vjellë ose marrë laksativë gjatë 30 ditëve të fundit.

- Prevalenca e nxënësve që kanë ngrënë më pak ushqim, më pak kalori ose ushqime më pak yndyre me qëllim që të humbin ose mos shtuar në peshë gjatë 30 ditëve të fundit është 48.9%

- Përqindja e nxënësve që kanë marrë pilula dietetike ose lëngje për të rënë ose mos shtuar në peshë pa u këshilluar me mjekun ishte 2.7% . Nuk ka diferenca të dukshme të

prevalencave në ndarjet sipas klasave. Vihet re një përqindje më e lartë e femrave në përdorimin e mënyrave të ndryshme për të rënë në peshë krahasuar me meshkujt.

- Prevalenca e nxënësve që kanë ndenjur pa ngrënë për 24 orë ose më shumë gjatë 30 ditëve të fundit me qëllim që humbin në peshë ose për të mos shtuar në peshë është më e lartë tek femrat 22.1% se sa tek meshkujt 12.8%.

7. Veprimtaria fizike

- Midis nxënësve të shkollave të mesme 14.4% e tyre kanë kryer për të paktën 30 minuta një veprimtari fizike që nuk i ka bërë të djersisin ose të marrin frymë me shpejtësi në 5 ose më shumë ditë të javës. Nuk vërehet ndonjë ndryshim i madh midis meshkujve dhe femrave përkatësisht (18% dhe 11.9%), ndërsa vihet re një përqindje gati dy herë më e madhe e pjesëmarrjes në këtë veprimtari fizike e nxënësve të klasave të 10 dhe 11 krahasuar me klasën e 12 përkatësisht (15.9%, 16.6% dhe 7.8%).

- 22.4% e nxënësve të shkollave të mesme kanë kryer për të paktën 20 min një veprimtari fizike sportive që i ka bërë të djersisin ose të marrin frymë me vështirësi në tre ose më shumë ditë të javës.

- Prevalenca e pjesëmarrjes në aktivitet të fuqishëm fizik është në mënyrë sinjifikante më e lartë tek meshkujt 76% se sa tek femrat 51.8%. Nuk ka ndonjë ndryshim të dukshëm në ndarjet sipas klasave.

- Mesatarisht gjatë një jave shkolle 79.5% e nxënësve kanë frekuentuar lëndën e edukimit fizik në një ose më shumë ditë.

- Vihet re një ndryshim i lehtë i prevalencës së nxënësve që frekuentojnë lëndën e edukimit fizik mesatarisht gjatë një jave shkolle midis meshkujve dhe femrave përkatësisht (75.2% dhe 82.3%). Nuk vërehet ndonjë ndryshim i dukshëm të kësaj prevalence në ndarjet sipas klasave.

- Midis nxënësve të shkollave të mesme gjatë orës së edukimit fizik 60.1% e tyre stërviten ose luajnë sport më shumë se 20 minuta.

- Mesatarisht gjatë një dite të zakonshme shkolle 47.1% e nxënësve të shkollave të mesme kanë parë tre ose më shumë ore televizor në ditë. Nuk ka ndryshime të dukshme midis meshkujve dhe femrave në të dy studimet e kryera si dhe në ndarjet midis klasave.

- Lidhur me njohuritë e marra në shkollë për HIV dhe SIDË 89% e nxënësve raportojnë që kanë mësuar në shkollë për to.

1.3 Të dhëna të përgjithshme mbi Qarkun e Elbasanit

Qarku i Elbasanit është një nga 12 qarqet në Shqipëri, ka një sipërfaqje prej 3,278 km²dhe një popullsi prej 433,244 banorë¹⁵. Qendra e Qarkut të Elbasanit ndodhet në qytetin e Elbasanit²⁰. Qarku i Elbasanit kufizohet¹⁵:

- në veri me Qarkun e Dibrës
- në veriperëndim me Qarkun e Tiranës
- në perëndim me Qarkun e Fierit
- në jug me Qarkun e Beratit
- në juglindje me Qarkun e Korçës
- në lindje me Republikën e Maqedonisë

Harta e Qarkut të Elbasanit



Shtrirja gjeografike

Qarku i Elbasanit shtrihet në fushën me të njëjtin emër, në krahun e djathtë të rrjedhës së mesme të lumit Shkumbin në lartësinë 120 m. Është rreth fushor dhe pjesërisht kodrinormalor. Lartësia mesatare është 440 m. Maja më e lartë është mali i Jeronishtit (1883 m). Malet ndodhen në verilindje, lindje dhe juglindje (si Labinot dhe Shpati). Kodrat ndodhen në veriperëndim, perëndim dhe jugperëndim si kodrat e Dumresë, Sulovës dhe Llixhës. Fushat ndodhen në pjesën qendrore si fusha e Elbasanit, Cërrikut, Gostimës.

Ndarja administrative

Tabela Nr. 1 – Ndarja administrative e qarkut Elbasan

Rrethi	Banorë	Qendra kryesore	Sipërfaqja (km ²)	Bashkitë	Komunat
Rrethi i Elbasanit	279,991	Elbasani	1,481	Bashkia Belsh, Bashkia Cërrik, Bashkia Elbasan	20
Rrethi i Gramshit	39,789	Gramshi	695	Bashkia Gramsh	9
Rrethi i Librazhdit	76,567	Librazhdi	1,013	Bashkia Librazhd, Bashkia Prrenjas	9
Rrethi i Peqinit	36,897	Peqini	140	Bashkia Peqin	5
Qarku i Elbasanit	433,244	Elbasani	3,329 km²	7	43

Në qarkun e Elbasanit gjenden një numër i konsiderueshëm shkollash të mesme publike dhe jopublike. Në Librazhd gjenden 13 shkolla të mesme, në Elbasan 31, në Gramsh 8 dhe në Peqin 2. Gjithashtu gjendet universiteti publik “A.Xhuvani” me pesë fakultete, të cilët ofrojnë programe të ndryshme studimi, të ciklit të parë dhe të dytë.

1.4 Konceptet teorike të disa prej sjelljeve riskante

Disa sjellje riskante janë me interes të veçantë tek profesionistët për shkak të mbizotërimit të tyre tek të rinjtë sot. Shumë nga këto sjellje shkaktojnë një numër të madh të vdekjeve dhe lëndimeve midis adoleshentëve dhe të rinjve, si dhe kanë ndikime negative në shoqëri. Disa nga sjelljet në risk që kontribuojnë në shkaqet kryesore të vdekjes dhe paaftësisë tek të rinjtë përfshijnë:

- Sjelljet që kontribuojnë për lëndime të paqëllimshme dhe dhunë.
- Sjelljet seksuale që kontribuojnë për shtatzani të padëshiruar dhe sëmundje seksualisht të transmetueshme, duke përfshirë infeksionin HIV.
- Përdorimi i Alkoolit dhe i drogave të tjera.
- Konsumi i duhanit.
- Sjelljet dietetike të pashëndetshme - Mbipësia, Obeziteti, Mënyra e Ushqyerjes, Aktiviteti i pamjaftueshëm fizik.

Këto sjellje riskante janë të monitoruara nga YRBSS - Youth Risky Behaviors Surveillance System – Sistemi Mbikqyrës i Sjelljeve Riskante (SMSRrR) tek të rinjtë¹⁶. YRBSS u zhvillua nga CDC – Qendra për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve në SH.B.A.

YRBSS (Youth Risky Behaviors Surveillance System) - SMSRrR (Sistemi Mbikqyrës i Sjelljeve Riskante) ka qëllime të shumta ¹⁶. Sistemi është projektuar për të përcaktuar prevalencën e sjelljeve në risk tek të rinjtë, të vlerësojë nëse rriten ose ulen këto sjellje, apo qëndrojnë të njëjta me kalimin e kohës, dhe të shqyrtojë bashkëekzistencën e shfaqjes së sjelljeve të tjera riskante.

Një tjetër qëllim i YRBSS është që të sigurojë të dhëna të krahasueshme kombëtare, shtetërore, dhe lokale për të rinjtë¹⁶. Ky sistem gjithashtu është projektuar për të monitoruar progresin drejt arritjes së objektivave kombëtare shëndetësore.

1.5 Sjelljet vetëdëmtuese, dhuna dhe vetëvrasja, llojet, faktorët e riskut, faktorët mbrojtës, parandalimi.

Dhuna ndërpersonale është përcaktuar si "përdorimi i qëllimshëm i forcës fizike ose pushtetit, kundër një personi tjetër ose kundër një grupi apo komuniteti që mund të rezultojë në plagosje, vdekje, dëm psikologjik, apo keqzhvillim."¹⁷Dhuna mund të ndahet në tre kategori të gjera: dhuna e vetë-drejtuar, dhuna ndërpersonale, dhuna kolektive.¹⁷

1.5.1 Dhuna e vetëdrejtuar

Dhuna e vetëdrejtuar është e ndarë në sjelljen vetëvrasëse dhe në vetëabuzimin. Kjo përfshin mendime vetëvrasëse, tentativë vetëvrasëse - të quajtura gjithashtu para vetëvrasje

ose vetlëndim i qëllimshëm në disa vende - dhe vetëvrasje e përfunduar. Vetabuzimi, në të kundërt, përfshin veprime të tilla si vetëgjymtimi¹⁷.

1.5.2 Dhuna ndërpersonale

Dhuna ndërpersonale ndahet në dy nënkategori: dhuna familjare dhe dhuna midis partnerëve intime – që është, kryesisht dhuna mes anëtarëve të familjes dhe partnerëve intime; zakonisht, edhe pse jo ekskluzivisht, zhvillohet në shtëpi. Dhuna komunitare - dhuna midis individëve që janë të palidhur, dhe të cilët mund ose jo të njihen; zakonisht zhvillohet jashtë shtëpisë¹⁷.

1.5.3 Dhuna kolektive

Dhuna kolektive është e ndarë në dhunë shoqërore, politike dhe ekonomike¹⁷. Ndryshe nga dy kategoritë e tjera të gjera, nënlojet e dhunës kolektive sugjerojnë motivet e mundshme për dhunën e kryer nga grupe më të mëdha individësh ose nga shtete.

1.5.4 Dhuna rinore

Në dhunën rinore mund të përfshihen personat midis moshave 10 dhe 24 vjeç, edhe pse modelet e dhunës rinore mund të fillojnë në fëmijërinë e hershme¹⁸.

Aspekte të tjera të dhunës përfshihen në këtë përkufizim. Për shembull, ai përfshin të gjitha aktet e dhunës, qoftë publike apo private, reaktive (në përgjigje të ngjarjeve të mëparshme, si provokim), proaktive (instrumentale - duke parashikuar më shumë rezultate vetmbrojtëse), ose penale, ose jokriminale.

1.5.5 Faktorët e riskut për kryerjen e dhunës tek të rinjtë:

Kërkimet mbi dhunën tek të rinjtë tregojnë se ka disa faktorë që i bëjnë disa popullata më të prekshme ndaj viktimizimit dhe kryerjes së dhunës. Faktorët e riskut rrisin gjasat që një person i ri të bëhet i dhunshëm. Megjithatë, faktorët e riskut nuk janë shkaktarët e drejtpërdrejtë të dhunës rinore. Determinantët sociale përcaktojnë nëse një person do të jetë i dhunshëm apo jo, ndërsa faktorët e riskut kontribuojnë në dhunën tek të rinjtë¹⁹. Determinantët socialë të shëndetit janë kushtet në të cilat njëriëzitet lindin, rriten, jetojnë, punojnë dhe plaken¹⁹. Këto rrethana krijohen nga shpërndarja e parave, energjisë dhe burimeve në nivele globale, kombëtare dhe lokale. Përcaktuesit socialë të shëndetit janë kryesisht përgjegjës për pabarazitë shëndetësore .

Faktorët e riskut mund të jenë individualë, familjarë, bashkëmoshatarë dhe komunitarë.²⁰

➤ Faktorët individualë të riskut përfshijnë²¹:

- Histori e viktimizimit të dhunshëm
- Defiçite të vëmendjes, hiperaktivitet ose çrregullime të të mësuarit
- Histori e sjelljes agresive të hershme
- Përfshirja me drogë, alkool apo duhan
- IQ (Intelligence Quotient) - KI - (Koefiçienti Intelktual) i ulët
- Kontrolli i dobët i sjelljes

- Defiçite në aftësitë njohëse sociale ose aftësitë informative të përpunimit
- Vuajtje të lartë emocionale
- Histori e trajtimit për probleme emocionale
- Qëndrime dhe besime antisociale
- Ekspozimi ndaj dhunës dhe konfliktit në familje

➤ **Faktorët e riskut familjarë përfshijnë²¹:**

- Qëndrimet autoritare gjatë procesit të rritjes së fëmijës
- Praktikrat disiplinore të ashpra, të dobëta ose jokonsistente
- Përfshirja e ulët e prindërve
- Lidhja e ulët emocionale të prindërve apo kujdestarëve
- Arsimimi i ulët i prindërve dhe i të ardhurave.
- Abuzimi prindëror me drogat apo kriminaliteti
- Funksionimi i dobët familjar
- Monitorimi dhe mbikëqyrja e dobët e fëmijëve .

➤ **Faktorët e riskut socialë dhe bashkëmohatarë përfshijnë²¹ :**

- Shoqërimi me bashkëmohatare kriminelë
- Përfshirja në banda
- Refuzime sociale nga bashkëmohatarët
- Mungesa e përfshirjes në aktivitete konvencionale
- Performancë e dobët akademike
- Angazhimi i ulët në shkollë dhe dështim shkollor

➤ **Faktorët e riskut komunitarë përfshijnë²¹:**

- Mundësitë e vogla ekonomike
- Përqëndrime të mëdha të banorëve të varfër
- Shkalla e lartë e përçarjeve familjare
- Niveli i ulët i pjesëmarrjes së komunitetit
- Lagje të ç'organizuar shoqërisht

1.5.6 Faktorët mbrojtës ndaj dhunës rinore

Faktorët mbrojtës ruajnë të rinjtë nga risqet për t'u bërë i dhunshëm²¹. Këta faktorë ekzistojnë në nivele të ndryshme. Deri më sot, faktorët mbrojtës nuk janë studiuar gjerësisht ose rigorozisht sikur se janë studiuar faktorët e riskut. Megjithatë, duke i identifikuar dhe kuptuar, faktorët mbrojtës janë po aq të rëndësishëm sa faktorët e riskut .

Shumica e kërkimeve janë fillestare. Faktorët mbrojtës mund të jenë familjarë, individualë, bashkëmoshatarë dhe komunitarë.

Faktorët mbrojtës familjarë/individualë përfshijnë²¹:

- Sjellje intolerante drejt devijimit
- IQ (Intelligence Quotient) - KI - (Koefficienti Intelektual) i lartë
- Mesatare të lartë pikësh
- Orientimi pozitiv social
- Besimi fetar
- Lidhjet me familjen ose të rriturit jashtë familjes
- Aftësia për të diskutuar problemet me prindërit
- Pritjet e perceptuara prindërore rreth performancës së shkollës janë të larta
- Aktivitetet e shpeshta të përbashkëta me prindërit
- Prania e vazhdueshme e prindit gjatë të paktën një nga këto aktivitete: kur zgjohet, kur vijnë në shtëpi, nga shkolla, në mbrëmje gjatë ngrënies së darkës ose kur shkojnë në shtrat.

➤ Faktorët mbrojtës socialë/bashkëmoshatarë përfshijnë²¹:

- Angazhimi në shkollë
- Përfshirja në aktivitete sociale

1.5.7 Parandalimi i Dhunës Rinore

Dëmtimi i dhunshëm dhe vdekja ndikojnë në mënyrë disproporcionale tek adoleshentët dhe të rinjtë. Udhëzuesi për parandalimin e dhunës tek të rinjtë përshkruan pesë kategoritë e aktiviteteve të cilat janë kyçe për parandalimin e dhunës monitorimin dhe hulumtimin e problemit, zhvillimin dhe vlerësimin e strategjive parandaluese, mbështetëse, si dhe duke rritur programet parandaluese, duke siguruar burime të parandalimit, dhe inkurajuar kërkime të ndryshme.

1.5.8 Vetëvrasja

Vetëvrasja (suicidium- Latinisht, nga caedere sui ", për të vrarë veten") është akt i shkaktuar qëllimisht për të realizuar vdekjen e vetë personit²².

Tentativa për vetëvrasje²³ është një sjellje vetë-drejtuese jo fatale, potencialisht e dëmshme me qëllim që të vdesë si rezultat i sjelljes. Një përpjekje për vetëvrasje mund ose jo të rezultojë në vetëvrasje.

Vetëvrasje e Asistuar është kur një individ e ndihmon tjetrin të shkaktojë vdekjen e tij, në mënyrë të tërthortë nëpërmjet ofrimit të këshillave ose me mjete deri në fund²⁴. Kjo është në kontrast me eutanazinë, ku një person tjetër merr një rol më aktiv në sjellje, në lidhje me vdekjen e një personi²⁵.

Idetë për vetëvrasje. Janë ide që përfshijnë mendimin ose planifikimin për vetëvrasje²⁴.

Zakonisht metoda e vetëvrasjes ndryshon nga vendi dhe është pjesërisht e lidhur me disponueshmërinë. Metodatat e zakonshme përfshijnë: varjen, helmimin me pesticide, dhe armët e zjarrit. Rreth 800.000 deri në një milion njerëz vdesin nga vetëvrasje çdo vit, duke e bërë atë shkaku të dhjetë të vdekjes në mbarë botën²⁶. Raportet janë më të larta në meshkuj se në femra, meshkuj e realizojnë tre deri në katër herë më shumë vetëvrasjen se sa femrat³⁸. Ka rreth 10-20.000.000 tentativa për vetëvrasje çdo vit²⁶. Tentativat jo-fatale vetëvrasëse mund të çojnë në lëndime afatgjata dhe invaliditet . Përpjekjet janë më të zakonshme në të rinjtë dhe femrat.

Nuk ka të dhëna fispatologjike unifikuese themelore për vetëvrasjen. Ajo megjithatë besohet të rezultojë nga një bashkëveprim i faktorëve të sjelljes, social-mjedisorë dhe psikiatrikë²⁷. Nivelet e ulëta të Faktorit Neurotropik të Trurit (FNT) janë të lidhura drejtpërdrejtë me vetëvrasjen dhe në mënyrë indirekte me depresionin, çrregullime të stresit post traumatike, skizofreninë dhe çrregullimet obsesive kompulsive. Studimet post-mortem kanë gjetur nivele të reduktuara të FNT në hippocampus dhe në korteksin prefrontal, në ata me dhe pa faktorë psikiatrikë. Serotonina, një neurotransmetues i trurit, besohet të jetë i ulët në ata që kryejnë vetëvrasje. Kjo është e bazuar pjesërisht në dëshmitë e rritjes së niveleve të receptorëve 5-HT_{2A} të gjetura pas vdekjes. Dëshmi të tjera përfshijnë nivele të reduktuara të një produkti të metabolizmit të serotoninës, acidi 5-hydroxyindoleacetik, në lëngun cerebrospinal.

Epigjenetika përfshin, studimin e ndryshimeve në shprehjen gjenetike në përgjigje të faktorëve të mjedisit të cilat nuk e ndryshojnë ADN themelore, ku besohet gjithashtu që bashkëveprimi i këtyre faktorëve të luajnë një rol në përcaktimin e riskut për vetëvrasje²⁸.

1.5.9 Vetëvrasja: faktorët e riskut dhe mbrojtës

Faktorët e riskut për vetëvrasje si faktorët individualë, relationalë, komunitarë, dhe shoqërore kontribuojnë në rritjen e riskut për vetëvrasje. Ata janë të lidhur me vetëvrasjen, por mund të jenë ose jo shkaqe të drejtpërdrejta.

➤ **Faktorët e riskut janë²⁹:**

- Histori familjare për vetëvrasje.
- Histori familjare për keqtrajtim të fëmijës.
- Përpjekje e mëparshme për vetëvrasje.

- Histori për çrregullime mendore, veçanërisht depresioni klinik
- Histori për abuzim me alkool dhe droga
- Ndjenja e pashpresës
- Tendenca impulsive apo agresive
- Besime kulturore dhe fetare (p.sh., besimi se vetëvrasja është një rezolutë fisnike e një dileme personale)
- Izolimi, një ndjenjë për t'u shkëputur nga njerëzit e tjerë
- Pengesat për të hyrë në trajtimin e shëndetit mendor
- Humbje (relacionale, sociale, punë, apo financiare)
- Sëmundje fizike
- Qasje (akses) të lehtë në metodat vdekjeprurëse
- Mosgatishmëria për të kërkuar ndihmë për shkak të stigmës së lidhur me shëndetin mendor ose çrregullimet shëndetësore lidhur me abuzimin me substanca ose me mendime për vetëvrasje

➤ **Faktorët mbrojtës për vetëvrasje²⁹**

Faktorët mbrojtës mbrojnë individët nga mendimet dhe sjelljet për vetëvrasje⁴². Deri më sot, faktorët mbrojtës nuk janë studiuar gjerësisht ose rigorozisht sikurse faktorët e riskut. Megjithatë, identifikimi dhe kuptimi i faktorëve mbrojtës është po aq i rëndësishëm sa dhe faktorët e riskut.

Faktorët mbrojtës janë²⁹:

- Kujdes efektiv klinik për çrregullime fizike, mendore dhe abuzimin me droga.
- Qasje të lehtë në një shumëllojshmëri të ndërhyrjeve klinike dhe mbështetjeje, kërkimi për ndihmë .
- Mbështetje familjare dhe komunitare .
- Mbështetje nga shëndeti mjekësor mendor.
- Besime kulturore dhe fetare që shkurajojnë vetëvrasjen dhe mbështesin instinktët për vetëmbrojtje .

➤ **Parandalimi i vetëvrasjes³⁰:**

Vetëvrasja është një problem serioz për shëndetin publik me pasoja afatshkurtra dhe afatgjata shëndetësore. Udhëzuesit për parandalimin e vetëvrasjes tek të rinjtë përshkruajnë pesë kategoritë e aktiviteteve të cilat janë kyçe për të realizuar parandalimin monitorimin dhe hulumtimin e problemit, zhvillimin dhe vlerësimin e strategjive parandaluese dhe mbështetëse

si dhe duke rritur programet parandaluese, duke siguruar burime të parandalimit, dhe duke inkurajuar kërkime³⁰.

1.6. Aksidentet rrugore

Tek të rinjtë, shumë sjellje vetëdëmtuese janë të lidhura me drejtimin e mjeteve të ndryshme motorrike³¹. Marrja e një leje drejtimi është konsideruar si një nga arritjet më të mrekullueshme të një të riu, por për fat të keq, aksidentet e makinave përbëjnë shkakun kryesor të vdekjes tek të rinjtë. Shumë lëndime janë shtuar nga dështimi për të vendosur rripin e sigurimit. Kombinimi i përdorimit të alkoolit dhe drejtimit të mjetit motorrik gjithashtu kontribuon në vdekjet midis të rinjve nga aksidentet me to.

1.7. Përdorimi i Alkoolit dhe Drogave

Përdorimi i drogave është një tjetër grup i sjelljeve që kontribuojnë si për dëmtime të menjëhershme, ashtu edhe për dëmtime afatgjata. Konsumimi i alkoolit dhe përdorimi i drogës rrisin rrezikun për aksidente me mjete motorrike, dhunë, marrëdhënie problematike dhe sëmundje të ndryshme³².

1.7.1 Faktorët gjenetike në varësinë ndaj alkoolit dhe drogave të tjera

Faktorët gjenetike të alkoolizmit janë studiuar më gjerësisht³³. Modelet e trashëgimisë në njerëz janë më në përputhje me alkoolizmin, si një çrregullim poligenik. Disa gjene japin një rrezik të reduktuar për alkoolizmin. Përafërsisht gjysma e të gjithë individëve në popullsitë aziatike përmbajnë alelet e aldehid dehidrogenazës që kodon një izoenzimë me aktivitet të reduktuar enzimatik. Ata raportojnë ndjenjën e dehjes edhe në doza shumë të ulëta të alkoolit. Individët që shprehin këtë isoenzimë rrallë abuzojnë me alkool. Faktorë të tjerë gjenetike predispojnë individët në rrezik në rritje për alkoolizëm.

1.7.2 Përdorimi i alkoolit, efektet, pasojat

Alkooli depërton shumë shpejt në gjak. Efektet e tij mund të shfaqen brenda 10 minutash³⁴. Pas marrjes së alkoolit, niveli i përqëndrimit të tij në gjak rritet (PAGJ)³⁵. Sa më i lartë PAGJ, aq më shumë mund të dëmtohem nga efektet e alkoolit. Këto efekte mund të përfshijnë: fjalor jo të qartë, konfuzion, probleme të kujtesës, probleme të përqëndrimit, koma, vdekje³⁴.

Rreziqe të tjera të konsumit të alkoolit mund të përfshijnë: aksidente me mjete motorrike, sjellje të dhunshme³⁴.

Një rrezik që konsumojnë alkool dhe pije të tjera alkoolike mund të përjetojnë efekte afatgjata të alkoolit për periudha të gjatë kohore, të cilat mund të përfshijnë: varësi ndaj alkoolit, probleme shëndetsore si rritje të riskut për disa lloje kanceresh, zhvlerësim të aftësitëve shoqërore në mënyrë të dukshme për shkak të efekteve neurotoksike të alkoolit në tru, veçanërisht në korteksin prefrontal të trurit³⁴.

1.7.3 Përdorimi i drogave, llojet, efektet, pasojat tek të rinjtë dhe trajtimi i tyre

Përdorimi i drogave është një shqetësim madhor i shëndetit publik duke përfshirë edhe atë shëndetsor për shkak të efekteve të dukshme negative fizike që ka në përdoruesit³⁶. Efektet e përdorimit të drogave nuk kufizohen vetëm në dëmtim të trurit por edhe në dëmtime të

organeve të tjera³⁷. Përdorimi i drogave është i lidhur me një mori sjelljesh të tjera që kompromentojnë shëndetin, të tilla si drejtim të rrezikshëm të makinës, përfshirje në sjellje seksuale riskante, dhe dhunë³⁷. Disa prej drogave janë :

a) Kanabisi

Kanabisi, i njohur gjithashtu si marihuanë, dhe me emra të tjera të shumta, është një përgatitje e bimës kanabis e destinuar për përdorim si drogë psikoaktive dhe si medikament³⁸. Kanabis është konsumuar shpesh për efektet e saj psikoaktive dhe fiziologjike, të cilat mund të përfshijnë euforinë, relaksim, dhe një rritje të oreksit⁴⁹. Efektet anësore të padëshiruara përfshijnë; rënie të kujtesës, gojë të thatë, dëmtime në aftësitë motorike, skuqje të syve, dhe ndjenjë paranoje apo ankthi.

b) Metamfetamina

Metamfetamina (Met) është një drogë stimuluese shumë problematike³⁹. Ajo është pluhur që mund të jetë në formë pilule ose në kristale me shkëlqim. Pluhuri mund të hahet ose të inhalohet në hundë. Ajo gjithashtu mund të përzihet me lëng dhe të injektohet në trup me shiringë. Crystal Met përdoret në mënyrë të paligjshme në botë, e zbukuruar në një tub të vogël qelqi.

Një tjetër stimulant me bazë amphetamine është ekstasi ose e quajtur Molly⁴⁰. Ajo përmban edhe halucinogenin mescalinë; mund të merret në mënyrë orale , në formë tablete apo kapsule.

Metamfetamina në fillim shkakton një stimulim të ndjenjave të mira, por më pas përdoruesit mund të ndjehen të paduruar, tepër të ngacmuar, të zemëruar, ose të frikësuar⁴¹. Përdorimi i metamfetaminës shpesh mund të çojë në varësi. Kjo shkakton probleme mjekësore, duke përfshirë; rritje të lartë të temperaturës trupore , kuarje të rëndë, " gojën e metamfetaminës " – dhëmbë të thyer dhe goja e thatë , probleme emocionale dhe në të menduar.

c) Kokaina crack

Crack ose kokaina krak është një formë e kokainës, e cila përdoret me shpesh tek të rinjtë⁴². Krak është në formë kristalesh që mund të nxehet, të thithet apo të tymoset. Ajo quhet "krak" për shkak të tingujve plasaritës që bën kur nxehet. Kokaina krak është një stimulues shumë problematik. Krak duket si kristale të bardha në formë si të çrregullt. Kokaina krak është pothuajse gjithmonë për tu tymosur ose e përgatitur. Përgatitja përfshin ngrohjen e krakut deri sa të lëngëzohet dhe thithjen e avujve nëpërmjet një tubi. Avujt thithen nga mushkëritë, duke prodhuar në mënyrë të menjëhershme një nivel të lartë euforie. Krak është një formë e gatshme e kokainës. Kokaina përdoret për shkak se ajo prodhon eufori, është stimuluese, ndërpret oreksin, dhe mund të përdoret si një lehtësues dhimbjesh.

d) Heroina

Heroina është opium gjysmë-sintetik që përfitohet nga morfina, një substancë natyrale që nxirret nga lëvozhga e farës së bimës aziatike Opium Poppy - lulekuqja⁴³. Heroina gjendet në formë të pluhurit me ngjyrë kafe të errët, të kuqërremtë dhe në formë të pluhurit të bardhë . Heroina mund të injektohet, të tymoset, dhe të nuhatet. Heroina shkakton tolerancë të shpejtë si dhe varësi të lartë fizike dhe psikike.

1.7.4 Pasojat e përdorimit të drogave

Njerëzit e të gjitha moshave vuajnë pasojat e dëmshme të abuzimit me drogën dhe varësisë ndaj saj⁴⁴:

Bebet e ekspozuara ndaj drogave legale dhe ilegale në barkun e nënës mund të rezultojnë në lindje të parakohshme dhe nën peshë. Ky ekspozim ndaj drogës mund të ngadalësojë zhvillimin intelektual të fëmijës dhe të ndikojë në sjelljen e më vonshme në jetë.

Adoleshentët që abuzojnë me drogën shpesh demonstronë sjellje josociale si: veprojnë keq në ambjentet e jashtme, kanë performancë të keqe në shkollë, apo edhe të lenë shkollën. Ata janë në rrezik të shtatzënive të paplanifikuara, dhunës, dhe sëmundjeve infektive.

Përdorimi i drogës nga prindërit shoqërohet shpesh me dhunë familjare si keqtrajtim të fëmijëve apo neglizhim. Kushte të tilla dëmtojnë mirëqënien dhe zhvillimin e fëmijëve në shtëpi dhe mund të përgatisë terrenin për abuzim droge në gjeneratën e ardhshme.

1.7.5 Trajtimi

Trajtimi për abuzimin me drogat mund të jetë mjekësor⁴⁵ dhe psikologjik⁴⁶:

➤ Trajtimi mjekësor⁴⁵

Terapia farmakologjike: Një numër barnash janë miratuar për trajtimin e abuzimit me drogat. Këto përfshijnë terapi zëvendësuese të tilla si buprenorphine and metadon si dhe medikamente antagonistë si Disulfiram dhe naltreksoni. Disa medikamente të tjera, shpesh ato të përdorura fillimisht në kontekste të tjera, kanë qenë efektive duke përfshirë bupropion dhe modafinil.

➤ Trajtimi psikologjik⁴⁶

Bazuar në psikologjinë e sjelljes, disa nga ndërhyrjet mund të jenë: terapi të sjelljes martesore, intervistimi motivues, qasje dhe përforcim me komunitetin, terapi të ekspozimit.

Në fëmijët dhe adoleshentët, terapia njohëse e sjelljes dhe terapia familjare aktualisht janë më të provuara për trajtimin e problemeve me abuzimin e drogave. Këto trajtime mund të administrohen në një shumëllojshmëri formatesh të ndryshme, secila prej të cilave ka nivelet e mbështetjes kërkimore të ndryshme. Alkohikët Anonime është një nga më të njohurit gjerësisht, organizata vetëndihmuese, në të cilën anëtarët e mbështesin njëri-tjetrin të mos përdorin alkool.

1.8 Duhanpirja, efektet, pasojat shëndetsore, parandalimi i tij në shkolla

Duhani dëmton pothuajse çdo organ të trupit ⁴⁷. Njihen pasojat shëndetsore të duhanpirësve në përgjithësi⁴⁷. Ndërprerja e pirjes së duhanit ul rrezikun për sëmundjet e lidhura me duhanpirjen dhe mund të shtojë jetëgjatësinë.

Duhanpirja dhe rreziqet shëndetësore të rritura⁴⁸. Duhanpirësit kanë më shumë gjasa se joduhanpirësit për të zhvilluar sëmundje të zemrës, aksidente cerebrovaskulare, SPOK dhe kancer të mushkërive.

Pirja e duhanit shkakton rënie të shëndetit të përgjithshëm, të tilla si vetëraportim të shëndetit të dobët, rritja e mungesave në punë, dhe për të rriturit shfrytëzimin e kujdesit shëndetësor dhe rritje të kostos shëndetsore.

Duhanpirja e rrit rrezikun e vdekjes nga të gjitha shkaqet në meshkujt dhe femrat. Rreziku për të vdekur nga duhanpirja është rritur gjatë 50 vitëve të fundit në të gjithë botën, në meshkujt dhe femrat.

Parandalimi i përdorimit të duhanit nëpërmjet shkollave⁴⁸. Shkollat luajnë një rol kritik në promovimin e shëndetit të rinisë, duke i ndihmuar ata të krijojnë sjellje të shëndetshme gjatë gjithë jetës. Programet shkollore për të parandaluar përdorimin e duhanit dhe varësisë ndaj tij do të jetë më efektive nëse kanë për qëllim:

- të ndalojnë përdorimin e duhanit në të gjitha ambientet shkollore gjatë gjithë kohës.
- të inkurajojnë dhe të ndihmojnë studentët dhe stafin për të lënë duhanin .
- të jenë pjesë e një programi të koordinuar shëndetësor shkollor përmes të cilit mësimitdhënësit, nxënësit, familjet, administratorët, dhe udhëheqësit e komunitetit të japin mesazhe të qëndrueshme në lidhje me përdorimin e duhanit
- të jenë implementuar brenda kontekstit dhe të përforcohen nga përpjekjet e mbarë komunitetit për të parandaluar përdorimin e duhanit dhe varësinë ndaj tij.

1.9. Sjelljet seksuale, pasojat tek të rinjtë

Sjelljet seksuale përbëjnë një tjetër grup madhor të sjelljeve në risk për shkak të impaktit që ato kanë tek të rinjtë⁴⁹.

Shumë të rinj angazhohen në sjellje riskante seksuale që mund të rezultojnë në efekte të padëshiruara shëndetësore duke përfshirë edhe sëmundjet seksualisht të transmetueshme (SST-ve), të tilla si klamidia, gonorea, dhe HIV. Nëse klamidia nuk trajtohet, mund të ketë pasoja të rënda shëndetësore, veçanërisht për femrat e reja (të tilla si shtatzani tubare, sëmundja inflamatore kronike pelvike)⁵⁰.

Adoleshentët seksualisht aktivë janë midis popullatave që kanë normat më të larta të raportuara të infeksionit nga gonorreja⁵⁰. Nëse nuk trajtohen, sëmundjet seksualisht të transmetueshme mund të rrisin rrezikun e marrjes apo transmetimit të HIV-it - virusi që shkakton SIDËN.⁵¹

Përdorimi i drogave, abuzimi dhe varësia kanë qenë të lidhura ngushtë me infeksion HIV që nga fillimi i epidemisë. Edhe pse përdorimi i drogës me injeksion intravenoz është rruga e drejtpërdrejtë e transmetimit, konsumimi i pijeve alkoolike, pirja e duhanit, apo inhalimi i drogave të tilla si alkooli, kokaina krak, methamfetamina, heroina, shoqërohen gjithashtu me një risk të rritur për infeksionin HIV.

Përdorimi i drogave dhe varësia ndaj tyre kanë një impak të madh në Shëndetin Publik për shumë arsye. Përveç se rrisin rrezikun e transmetimit të HIV-it, përdorimi i drogave mund të ndikojë në shëndetin e përgjithshëm të njerëzve dhe t'i bëjë ata më të ndjeshëm ndaj

infeksionit HIV. Në ata persona që tashmë janë të infektuar me HIV, përdorimi i drogave mund të ndikojë negativisht në përparimin e sëmundjes dhe në efektet e trajtimit.

Një sërë faktorësh kontribuojnë në përhapjen e infeksionit HIV midis përdoruesve të drogave⁵¹:

- Faktorët e riskut seksual. Përdorimi i drogave mund të ulë ndërgjegjësimin për mbrojtje ndaj transmetimit të HIV-it, duke përfshirë edhe mos përdorimin e prezervativit.
- Stigmatizimi dhe diskriminimi i lidhur me përdorimin e drogave. Shpesh, përdorimi i drogës është parë si një aktivitet kriminal dhe jo si një çështje mjekësore që kërkon këshillim dhe rehabilitim. Stigmatizimi mund ti ndalojë përdoruesit që të kërkojnë testimin e HIV-it, kujdes dhe trajtim.
- Nevojat shëndetsore komplekse dhe sociale. Njerëzit që përdorin drogë shpesh kanë nevoja shëndetsore dhe sociale të tjera të ndërlikuara, duke përfshirë edhe nevojën për trajtim të abuzimit të drogave dhe çrregullimeve mendore.
- Efektet mbi zbatimin e trajtimit të HIV-it. Zbatimi jo i duhur i trajtimit mund të çojë në shtame virale rezistente ndaj medikamenteve.

1.10. Të dhëna që lidhen me Treguesin e Masës Trupore (TMT)

Treguesi i masës trupore (TMT) - (BMI-body mass index) është një parametër i përdorur për të përcaktuar mbipeshën dhe obesitetin që në fëmijëri⁵³. Ajo është llogaritur duke përdorur peshën e fëmijës dhe lartësinë. TMT nuk mat lipidet direkt në trup, por ky është një tregues i arsyeshëm i mbipeshës dhe obesitetit të trupit për fëmijët, adoleshentët, të rinjtë dhe të rriturit⁵³.

Mbipesha është prania mbi normën e të qenurit të shëndetshme të yndyrnave trupore. Mbipesha është e zakonshme veçanërisht kur konsumi ushqimor është më i madh se nevojat e organizmit dhe stili i jetës është ai i një jetese sendentare⁵².

Obeziteti është një gjendje mjekësore me një depozitim të tepërt të yndyrës në organe deri në atë masë që mund të ketë efekte negative mbi shëndetin, duke çuar në rritjen e problemeve shëndetsore dhe në jetëgjatësi të reduktuar⁵².

Statusi i peshës së fëmijës përcaktohet duke përdorur percentilet specifike për moshën dhe seksin. Kategoritë e TMT-së që përdoren për të rriturit ndryshojnë nga ato të fëmijëve, sepse përbërja trupore e fëmijëve ndryshon me moshën si dhe ndryshon midis meshkujve dhe femrave.

Mbipesha është përcaktuar si një BMI në ose mbi percentilin 85 % dhe më të ulët se percentilin 95% për fëmijët e të njëjtës moshë dhe gjini⁵².

Obeziteti është përcaktuar si një BMI në ose mbi percentilin 95 për fëmijët e të njëjtës moshë dhe gjini⁵³.

Pasojat e obesitetit në fëmijëri mund të jenë të hershme dhe të vonshme⁵⁴:

Pasojat e hershme mund të jenë⁵⁴: rritje të presionit të gjakut dhe kolesterolit, të cilat janë faktorë rreziku për sëmundje kardiovaskulare, rrezik të rritur për tolerancë të dëmtuar të glukozës, insulinorezistencë dhe diabet tip 2⁵⁵. Fëmijët dhe adoleshentët obezë kanë një risk më të madh të problemeve sociale dhe psikologjike, të tilla si diskriminimi dhe vetërespektim të dobët, të cilat mund të vazhdojnë në moshë të rritur.

Pasojat shëndetësore të vonshme⁵⁴:

- Fëmijët obezë kanë më shumë gjasa që të bëhen obezë kur të rriten. Obesiteti tek të rriturit shoqërohet me një sërë gjendjesh serioze shëndetësore, përfshirë sëmundjet e zemrës, diabet, dhe disa lloje kanceresh⁵⁶.

- Nëse fëmijët janë mbipeshë, obesiteti në moshë të rritur ka të ngjarë të jetë më i rëndë⁵⁷.

Ndërsa një numër në rritje i të rinjve janë mbipeshë apo obezë, një pjesë e madhe e tyre gjithashtu angazhohen në sjellje dietetike jo të shëndetshme për të humbur peshë, duke përfshirë; dietë, të vjella, laksativë, pilula të ndryshme të marra pa recetë nga mjeku.

1.11 Aktiviteti Fizik, efektet në shëndet

Aktiviteti fizik është shumë i rëndësishëm për shëndetin. Ai mund të ndihmojë në: kontrollin e peshës, në uljen e rrezikut për sëmundje kardiovaskulare, për diabet tip 2 dhe sindrom metabolik, apo në uljen e rrezikut për zhvillimin e kancerit në organe të ndryshme⁵⁸. Aktiviteti i rregullt fizik ndihmon në përmirësimin e humorit dhe shëndetit mendor, në forcimin e kockave dhe muskujve, në përmirësimin e aftësisë për të bërë më mirë aktivitetet e përditshme. Ai rrit shanset për të jetuar më gjatë dhe më mirë⁵⁹.

Rekomandohet një aktivitet fizik normal ose i moderuar, p.sh. aktiviteti i moderuar me intensitet aerobik, si ecje të shpejtë, është në përgjithësi i sigurt për shumicën e njerëzve⁵⁹.

Nëse gjendja fizike mund të mos e lejojë, e rëndësishme është që duhet shmangur të qenit joaktivë. Edhe 60 minuta në javë me aktivitet të moderuar me intensitet aerobik është e mirë për shëndetin⁵⁹.

Kontrolli i peshës. Kontrolli i peshës mund të arrihet duke kombinuar aktivitetin fizik me dietën. Shtimi në peshë mund të ndodhë atëherë kur kaloritë që digjen, duke përfshirë edhe ato të djegur gjatë aktivitetit fizik, janë më pak se sa kaloritë që merren nëpërmjet ushqyerjes. Kur duhet të bëhet menaxhimi i peshës njerëzit ndryshojnë përsa i përket aktivitetit fizik për të cilën ata kanë nevojë.

Për të ruajtur peshën mund të bëhet deri në 150 minuta aktivitet i moderuar me intensitet aerobik, 75 minuta aktivitet i fuqishëm me intensitet aerobik, ose një përzierje e barabartë e të dyjave çdo javë. Megjithatë, sasia e saktë e aktivitetit fizik e nevojshme nuk është e qartë sepse ajo ndryshon shumë nga personi në person. Është e mundur që mund të kenë nevojë për

të bërë më shumë se ekuivalenti i 150 minutave aktivitet me intensitet të moderuar në javë për të mbajtur peshën. Arritja dhe ruajtja e një peshe të shëndetshme kërkon si aktivitet të rregullt fizik dhe një plan të shëndetshëm ushqyerje.

1.12 Mënyra e Ushqyerjes, efektet në Shëndetin e të rinjve

Ushqimi i duhur dhe i shëndetshëm ndikon në rritjen dhe zhvillimin e të rinjve. Ushqimi i shëndetshëm ndihmon në parandalimin e një sërë gjendjesh të cilat mund të çojnë në zhvillimin e sëmundjeve të ndryshme, p.sh sëmundje kronike të tilla si sëmundjet kardiovaskulare, kanceri apo diabeti⁶⁰.

- Ushqimi i shëndetshëm ndihmon në zvogëlimin e riskut për obezitet, osteoporozë, deficiensë të hekurit, dhe karies të dhëmbëve⁶¹.

- Një ushqyerje e shëndetshme në fëmijëri dhe adoleshencë është e rëndësishme për rritjen dhe zhvillimin e duhur si dhe në parandalimin e problemeve shëndetësore.

- Udhëzuesit e ndryshëm dietetikë rekomandojnë një dietë të pasur me fruta, perime, drithëra pa yndyrë, produkte të qumështit me yndyrë të ulët për personat e moshës 2 vjeç e më shumë⁶⁰. Udhëzimet gjithashtu rekomandojnë që fëmijët, adoleshentët dhe të rriturit të kufizojnë futjen e yndyrave të ngurta (burimet kryesore me acidet yndyrore të ngopura dhe trans), kolesterolit , kripës, sheqernave, dhe drithërave të rafinuara⁶⁰. Për fat të keq, shumica e të rinjve nuk i ndjekin rekomandimet e përcaktuara⁶⁰ .

- Shkollat janë në një pozicion unik për të promovuar ushqyerje të shëndetshme. Shkollat duhet të pajisen me modele që t'i mundësojnë nxënësit që të mësojnë dhe praktikojnë sjellje për një ushqyerje të shëndetshme.

Por nga ana tjetër sjelljet jo të shëndetshme mund të çojnë në sëmundje të mirëfillta siç janë çrregullimet e ngrënies: Çrregullimet e ngrënies, duke përfshirë anoreksinë nervore , buliminë, janë sëmundje potencialisht të rrezikshme për jetën. Ato janë duke u bërë gjithnjë e më të zakonshme tek adoleshentët dhe të rinjtë⁶². Në këta pacientë, prindërit janë vija e parë e mbrojtjes, dhe luajnë një rol të rëndësishëm për t'i ndihmuar, edukuar të rinjtë për këto lloj çrregullimesh, si dhe në parandalimin e sjelljeve të tjera në risk .

2. Qëllimi dhe Objektivat e studimit

2.1 Qëllimi i studimit

Qëllimi i këtij studimi është gjetja e prevalencës së sjelljeve në risk në të rinjtë e moshës shkollore në qarkun e Elbasanit. Ky studim synon marrjen e informacionit të nevojshëm të prevalencës së sjelljeve në risk sipas moshës, gjinisë, vendbanimit - fshat/qytet; i cili do të ndihmojë në gjetjen dhe përcaktimin e moshave dhe kategorive më të rrezikuara nga sjelljet në risk si dhe do të ndihmojë gjithashtu në hartimin dhe planifikimin e politikave ndërhyrëse në nivele të ndryshme; në nivel rajonal e më gjerë, duke synuar në uljen e prevalencës së sjelljeve në risk në moshat e reja në qarkun e Elbasanit.

2.2 Objektivat e studimit

2.2.1 Objektiva të përgjithshëm

1. Përcaktimi i prevalencës së sjelljeve në risk në të rinjtë e qarkut të Elbasanit për periudhën 2011-2014.
2. Përcaktimi i lidhjes midis disa prej faktorëve socio-demografikë (gjinia, moshë, vendbanimi) dhe sjelljeve në risk.

2.2.2 Objektiva specifike:

1. Përshkrimi i subjekteve të marrë në studim sipas moshës,
2. Përshkrimi i subjekteve të marrë në studim sipas gjinisë
3. Përshkrimi i subjekteve të marrë në studim sipas vendbanimit
4. Prevalenca e njohurive mbi masat mbrojtëse në rrugë sipas;
 - 4.1 Moshës
 - 4.2 Gjinisë
 - 4.3 Vendbanimit
5. Prevalenca e dhunës sipas ;
 - 5.1 Moshës
 - 5.2 Gjinisë
 - 5.3 Vendbanimit
6. Prevalenca e sjelljeve seksuale që kontribuojnë për shtatzani të padëshiruar dhe sëmundje seksualisht të transmetueshme, duke përfshirë infeksionin HIV sipas;
 - 6.1 Moshës
 - 6.2 Gjinisë
 - 6.3 Vendbanimit
7. Prevalenca e përdorimit të alkoolit dhe drogave, sipas;
 - 7.1 Moshës
 - 7.2 Gjinisë
 - 7.3 Vendbanimit
8. Prevalenca e duhanpirjes sipas;
 - 8.1 Moshës
 - 8.2 Gjinisë
 - 8.3 Vendbanimit
9. Prevalenca obezitetit dhe mbipeshës sipas;
 - 9.1 Moshës

- 9.2 Gjinië
- 9.3 Vendbanimit
- 10. Prevalenca e aktivitetit të pamjaftueshëm fizik sipas;
 - 10.1 Moshës
 - 10.2 Gjinië
 - 10.3 Vendbanimit
- 11. Prevalenca e mënyrës së ushyerjes sipas;
 - 11.1 Moshës
 - 11.2 Gjinië
 - 11.3 Vendbanimit
- 12. Prevalenca e informacionit rreth shëndetit;
 - 12.1 Moshës
 - 12.2 Gjinië
 - 12.3 Vendbanimit

3. Metodologjia

3.1 Tipi i studimit

Studimi i realizuar është i tipit i transversal me natyrë deskriptive dhe analitike.

3.2 Zgjedhja e popullatës të marrë në studim

Të dhëna të njohura nga vendi ynë mbi sjelljet riskante u morën si bazë e përzgjedhjes së popullatës për të pasur një përfaqëse sa më të afërt dhe që synon në gjetjen e vlerave të përafërta me ato të ADHS (Albania Demographic Survey), si edhe të YRBSS (Youth Risky Behaviors Surveillance System).

Duke marrë parasysh prevalencën e sjelljeve në risk sipas YRBSS, për studimin tonë u llogarit një mostër e përafërt në 970 veta. Masa e kampionit u bë me qëllim për të patur rezultate të përafërta me studimin e bërë nëpërmjet YBSS. Paraprakisht u morën parasysh për arritjen e një vlere statistikore $p \leq 0.05$ si edhe intervalet e besimit sipas sjelljeve përkatëse në risk.

Nga totali prej 970 nxënës të shkollave të mesme dhe studentë të vitit të parë në universitet, 900 prej tyre morën pjesë në studim. Numri final i pjesëmarrësve në studim rezultoi 900 individë. Shkalla e përgjigjes rezultoi 92.3 %

Rrethet; Gramsh, Peqin, Librazhd dhe Elbasan kishin përkatësisht:

- Gramshi 8 shkolla të mesme publike
- Librazhdi 13 shkolla të mesme publike
- Peqini 2 shkolla të mesme publike
- Elbasani 31 shkolla të mesme publike dhe jopublike

Rrethet e mësipërme u morën si clastër ose tufëza. Duke u bazuar në zgjedhjen e randomizuar u zgjodhën Elbasani, Gramshi dhe Peqini. Për rrethet e Peqinit dhe Gramshit u vazhdua me zgjedhjen e shkollave; për Gramshin u zgjodh shkolla e mesme e përgjithshme “Shefqet Guzi”, kurse për Peqinin u zgjosh shkolla e mesme e përgjithshme “Zihni Magani“, sërish në mënyrë të randomizuar. Për Elbasanin u zgjodhën shkollat e mesme të përgjithshme “Kostandin Kristoforidhi“ dhe “Dhaskal Todri” .

Tabela Nr. 2 - Shkolla e Mesme “Shefqet Guzi” Gramsh

Klasa	Numri klasave	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Klasa e zgjedhur	Numri nxënësve	Kampioni përfundimtar
Klasa X	7	110	115	225	A-C	50	50
Klasa XI	7	109	100	209	A-F-	55	50
Klasa XI	8	120	95	215	D-E	55	50
Totali	22	339	310	649		160	150

Tabela Nr. 3 - Shkolla e Mesme “Zihni Magani” Peqin

Klasa	Numri klasave	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Klasa e zgjedhur	Numri nxënësve	Kampioni përfundimtar
Klasa X	5	64	56	120	A-B	50	50
Klasa XI	5	72	60	132	B-D	55	50
Klasa XII	5	72	60	132	A-C	55	50
Totali	15	136	384	252		160	150

Tabela Nr. 4 - Shkolla e Mesme “Kostandin Kristoforidhi” Elbasan

Klasa	Numri klasave	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Klasa e zgjedhur	Numri nxënësve	Kampioni përfundimtar
Klasa X	8	191	118	309	C-B	65	60
Klasa XI	9	192	148	340	F-C	65	60
Klasa XII	10	199	171	370	F-G	65	60
Totali	27	472	437	1019		195	180

Tabela Nr. 5 - Shkolla e Mesme “Dhaskal Todri” Elbasan

Klasa	Numri klasave	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Klasa e zgjedhur	Numri nxënësve	Kampioni përfundimtar
Klasa X	9	181	159	340	A	65	60
Klasa XI	8	142	96	238	B	65	60
Klasa XII	7	148	104	252	G	65	60
Totali	24	471	359	830		195	180

Tabela Nr. 6 - Universiteti “AleksandërXhuvani”, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Elbasan

	Programi i studimit	Viti akademik	Numri klasave	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Klasa e zgjedhur	Numri i studentëve	Kampioni përfundimta
Çikli i Studimit i parë (Bachelor)	Infermeri e përgjithshme	I(parë)	4	131	28	159	Infermieri e përgjithshme Ia	45	40
	Mami,	I (parë)	3	75	0	75	Mami Ib	45	40
	Fizioterapi	I (parë)	2	50	30	80	Fizioterapi Ib	45	40
	Teknik laboratori	I (parë)	11	35	13	48	Tek Lab Ia	45	40
	Logopedi	I (parë)	1	37	6	43	Logopedi Ia	45	40
	Imazheri	I (parë)	1	47	18	65	Imazheri Ia	45	40
	Totali	I(parë)	9	375	95	470	6	270	240

3.3 Mbledhja e të dhënave

Të rinjtë e përfshirë në këtë studim iu nënshtuan një pyetsori anonim, i cili përmbante pyetje: për gjininë, moshën, klasën, venbanimin dhe për disa sjellje riskante. Pyetsori u përshtat duke iu referuar CDC-së - Qendra e Kontrollit dhe e Parandalimit të Sëmundjeve në SH.B.A. Realizimi i pyetsorit u bë në ambientet e shkollave, në klasa dhe në auditore, duke marrë paraprakisht lejen zyrtare nga rektorati i universitetit të Elbasanit dhe nga drejtoria arsimore e qarkut të Elbasanit.

Karakteristikat demografike të subjekteve të përfshirë në studim konsistuan në moshën, gjininë, klasën si dhe vendbanimin e individëve.

Përkufizimi operativ i karakteristikave demografike të subjekteve të përfshirë në studim përshkruhet më poshtë:

- Moshë: moshë e subjekteve në vite të plota. Ky variabël në analizë u trajtua si variabël numerik (parametër i vazhdueshëm) dhe si variabël kategorik (grup-moshë: variabël ordinal).
- Gjinia: meshkujt kundrejt femrave. Variabël dikotomik/binar.
- Vendbanimi: qytet apo fshat. Në analizë, ky variabël u trajtua si kategorik.
- Klasa: Ky variabël u trajtua si variabël kategorik.
- Sjelljet që kontribuojnë për lëndime të paqëllimshme dhe dhunë (siguria në rrugë, dhuna dhe vetëvrasja) u trajtuan si variabël kategorik
- Sjelljet seksuale që kontribuojnë për shtatzani të padëshiruar dhe sëmundje seksualisht të transmetueshme, duke përfshirë infeksionin HIV u trajtuan si variabël kategorik
- Përdorimi i alkoolit dhe i drogave u trajtuan si variabël kategorik.
- Konsumi i duhanit u trajtua si variabël kategorik.
- Mbipeshë dhe obeziteti u trajtuan si variabël kategorik

- Mënyra e ushqyerjes u trajtua si variabël kategorik
- Aktiviteti fizik u trajtua si variabël kategorik.

3.4 Analiza Statistikore

Procedurat dhe teknikat statistikore të përdorura në punimin aktual paraqiten me hollësi më poshtë:

- Për variablat (ndryshoret) numerike u llogaritën madhësitë e prirjes si qëndrore (mesatarja aritmetike, deviacioni standard, mediana dhe moda)
- Për ndryshoret (variablat) kategorike u paraqitën shpërndarjet frekuenciale (vlerat absolute dhe përqindjet përkatëse).
- Testi ekzakt i H^2 u përdor për lidhjen e karakteristikave demografike (mosha, gjinia, vendlindja) me variablat e faktorëve të sjelljeve në risk .
- Në të gjitha rastet, u konsiderua si statistikisht e rëndësishme (sinjifikante) një vlerë e $P \leq 0.05$.

E gjithë analiza statistikore u realizua në programin SPSS (*Statistical Package for Social Sciences, version 22.0*).

4. Rezultatet


Tabela Nr. 7 Karakteristikat demografike

Karakteristikat demografike	Total Nr=900(%)
Gjinia	
1. Femra	552(61.3)
2. Meshkuj	348(38.7)
Mosha	
1. ≤16 vjeç	273(30.0)
2. 17 vjeç	303(34.0)
3. ≥18 vjeç	324(36.0)
Klasa	
1. Klasa e 10	289(32.0)
2. Klasa e 11	187(21.3)
3. Klasa e 12.	184(20.0)
4. Universitet >12	240(26.7)
Vendbanimi	
Fshat	255(28.3)
Qytet	645(71.7)


Nga tabela Nr. 7 si edhe grafiku Nr. 1 shihet se nga e gjithë popullata e marrë në studim 61.3% e tyre ishin femra dhe 38.7 % e përbënin meshkujt. Shikuar për moshë, moshat mbi 18 vjeç përbënin numrin më të madh të subjekteve të marrë në studim 324 ose 36%. Sipas shpërndarjes në klasa, klasat e 10 ishin më të shumta në numër prej 32% .Të rinjtë në qytet zënë përqindjen më të madhe përkatësisht 255 (71.7%) dhe 645 (28.3%) .

Grafiku Nr. 1 Karakteristikat demografike


Grafiku Nr. 1/1 Mosha



Grafiku Nr. 1/2 Gjinia



Grafiku Nr. 1/3 Klasa



Grafiku Nr. 1/4 Vendbanimi





Tabela Nr. 8 Përdorimi i Masave mbrojtëse në rrugë

<u>Siguria në rrugë</u>	Total Nr=900(%)
Keni përdorur kokore në biçikletë dhe motor?	
1. Asnjëherë	720(80.0)
2. Rrallë	129(14.0)
3. Një pjesën më të madhe të kohës	54(6.0)
Keni përdorur rripin e sigurimit në makinë?	
1. Asnjëherë	123(14.0)
2. Rrallë	381(43.0)
3. Në pjesën më të madhe të kohës	396(43.0)
Keni udhëtuar ndonjëherë me makinë nga persona që kanë konsumuar alkool?	
1. Po	303(34.0)
2. Jo	417(46.0)
3. Nuk jam i sigurt	180(20.0)
I keni dhënë makinës kur keni pasë konsumuar alkool?	
1. 0 herë	816(91.0)
2. 1 - 3 herë	54(6.0)
3. Më shumë se 3 herë	30(3.0)


Nga tabela e mësipërme Nr. 8 dhe grafiku Nr. 2 shihet qartë se 80% e personave të përfshirë në studim thonë se e nuk përdorin kokoren. Në lidhje me përdorimin e rripit të sigurimit, 57% e tyre raportuan se nuk e vendosin asnjëherë ose rrallë rripin e sigurimit. Ndërsa me eksperiencën e tyre në lidhje me drejtues makinash që kishin konsumuar alkool, 34% e subjekteve raportuan se kishin udhëtuar me drejtues të tillë. Në kushtet e konsumimit të alkoolit 9 % e tyre referuan se kishin drejtuar makinë në gjendje të tillë mbi 1-3, dhe 3 ose më shumë herë.

Grafiku Nr. 2 Prevalenca e Përdorimit të Masave mbrojtëse në rrugë


Grafiku 2/1 Përdorimi i kokores kur nget biçikletën ose motorrin



Grafiku Nr.2/2 Përdorimi i rripit të sigurimit



Grafiku Nr. 2/3 Udhëtimi me makinë me drejtuesin i cili ka konsumuar alkool



Grafiku Nr. 2/4 Drejtim të makinës pasi është konsumuar alkool





Tabela Nr. 9 Prevalenca e Dhunës tek të rinjtë

Dhuna	Total Nr=900(%)
Keni mbajtur ndonjëherë një armë si, pistoletë, thikë?	
1. Po	165(18.0)
2. Jo	735(82.0)
Jeni përfshirë ndonjëherë në një zënie (ndeshje)fizike ?	
1. Po	336(37.0)
2. Jo	564(63.0)
Jeni përfshirë ndonjëherë në një zënie (ndeshje) fizike, në të cilën ju jeni dëmtuar dhe keni patur nevojë për trajtim mjekësor?	
1. Po	81(9.0)
2. Jo	273(91.0)
Gjatë 12 muajve të fundit, jeni ndeshur fizikisht brenda ambienteve të shkollës?	
1. Po	81(17.0)
2. Jo	819(83.0)
Gjatë 12 muajve të fundit, ju ka goditur i/e dashuri/e me shuplakë apo ju ka dëmtuar fizikisht?	
1. Po	57(6.0)
2. Jo	843(94.0)
Ju kanë detyruar të keni marrëdhënie seksuale, jashtë dëshirës suaj?	
1. Po	66(8.0)
2. Jo	831(92.0)


Nga tabela Nr. 9 dhe grafiku Nr. 3, në personat e marrë në studim, 18% e tyre kanë mbajtur të paktën një herë armë (pistoletë, thikë). 37% e tyre janë përfshirë në një ndeshje, 9% e tyre janë përfshirë në një ndeshje fizike ku është kërkuar ndihmë mjekësore. 17% e tyre janë ndeshur fizikisht në ambientet e shkollës. 6% e tyre janë goditur ose dëmtuar fizikisht nga partneri/partnerja, dhe 8% e tyre janë detyruar të kryejnë marrëdhënie seksuale edhe kur nuk kanë dashur.

Grafiku Nr. 3 Prevalenca e Dhunës tek të rinjtë


Grafiku Nr. 3/1 Armëmbajtje




Grafiku Nr. 3/2 Përfshirja në një ndeshje fizike




Grafiku Nr. 3/3 Përfshirja në një ndeshje fizike me rezultat trajtimin mjekësor



Grafiku Nr . 3/4 Përfshirja në ndeshje fizike në ambientet e shkollës



Grafiku Nr. 3/5 Dhunë fizike nga i dashuri/a



Grafiku Nr. 3/6 Marrëdhënie seksuale me dhunë





Tabela Nr. 10 Prevalenca e Vetëvrasjes

Vetvrasja	Total Nr=900(%)
Keni menduar ndonjëherë seriozisht për të vrrarë veten	
1. Po	306(11.0)
2. Jo	798(89.0)
Keni bërë ndonjëherë plan se si mund të vrisni veten?	
1. Po	111(11.0)
2. Jo	789(89.0)
Jeni përpjekur ndonjëherë të vrisni veten ?	
1. Po	57(6.0)
2. Jo	843(94.0)
Gjatë 12 muajve të fundit, sa herë keni tentuar të vrisni veten?	
1. 0 herë	816(91.0)
2. 1 ose më shumë herë	84(9.0)
Nëse keni tentuar të vetëvriteni gjatë 12 muajve të fundit, keni rezultuar i dëmtuar, i helmuar, apo me mbidozë saqë keni kërkuar trajtim mjekësor?	
1. Po	72(8.0)
2. Jo	828(92.0)

Nga tabela Nr. 10 dhe grafiku Nr. 4, nga personat e marrë në studim, 11% e tyre kanë menduar seriozisht për të vrrarë veten. 11% e subjekteve kanë bërë plan se si mund të vrasin veten, 6% kanë tentuar vetëvrasjen. 9% e subjekteve kanë menduar të paktën 1 herë gjatë vitit të fundit për të kryer vetëvrasje dhe 8% e tyre bërë tentativë vetëvrasjeje e cila ka kërkuar trajtim mjekësor.

Grafiku Nr. 4 Prevalenca e Vetëvrasjes

Grafiku Nr. 4/1 Mendimi për vetëvrasjen




Grafiku Nr. 4/2 Planifikimi për vetëvrasje



Grafiku Nr. 4/3 Përpjekje për vetëvrasje



Grafiku Nr. 4/4 Tentativë për vetëvrasje në 12 muajt e fundit



Grafiku Nr. 4/5 Tentativë vetëvrasjeje që ka kërkuar trajtim mjekësor




Tabela Nr. 11 Prevalenca e Duhanpirjes


Duhanpirja	Total Nr=900(%)
Keni provuar ndonjëherë të pini duhan, qoftë edhe një, apo dy puf ?	
1. Po	567(63.0)
2. Jo	333(37.0)
Sa vjeç ishit kur keni pi një cigare të plotë për herë të parë ?	
1. Nuk kam pi asnjëherë	435(48.0)
2. 16 ose më i vogël	294(33.0)
3. 17 vjeç	129(14.0)
4. 18 ose më i madh	42(5.0)
Gjatë 30 ditëve të fundit, sa ditë keni pi duhan?	
1. 0 ditë	675(75.0)
2. 1-2 ditë	66(7.0)
3. 3-5 ditë	39(4.0)
4. 6-9ditë	27(3.0)
5. 10-19 ditë	12(1.0)
6. 20-29 ditë	12(1.0)
7. Të 30 ditët	69(9.0)
Gjatë 30 ditëve të fundit, si i siguronit zakonisht cigaret?	
1. Nuk kam pi cigare gjatë 30 ditëve të fundit	675(75.0)
2. I bleva në një dyqan si, supermarket	57(6.0)
3. I bleva tek një makinë shitëse	18(2.0)
4. Ia dhashë dikujt tjetër paratë që të mi blinte	24(3.0)
5. Ia mora dikujt borxh	42(5.0)
6. Një person mbi 18 vjeç ose më i madh mi dha cigaret	12(1.0)
7. I mora nga një personi familjes	30(3.0)
8. I sigurova në një mënyrë tjetër	45(5.0)
Keni pi duhan gjatë 30 ditëve të fundit në ambiente shkollore?	
1. Jo	828(92.0)
2. Po	72(8.0)
Gjatë 12 muajve të fundit keni tentuar të ndërprisni pirjen e duhanit?	
1. Nuk pi duhan	675(75.0)

2. Po	100(10.0)
3. Jo	125(15.0)


Në tabelën Nr. 11 dhe grafiku Nr. 5, shihet se nga personat e marrë në studim, 63% e tyre kanë provuar të pinë duhan, qoftë dhe një paf-puf. 33% e personave kanë qenë më pak se 16 vjeç kur kanë pi cigaren e parë. 9% e tyre kanë pi duhan 20 deri në 30 ditë të muajit. 18% e personave i kanë marrë tek një person tjetër cigaret. 3% e tyre kanë pi në më shumë se 20 ditë të muajit të fundit cigare në ambiente shkollore. 15% nuk kanë tentuar ta lënë duhanin gjatë vitit të fundit

Grafiku Nr. 5 Prevalenca e Duhanpirjes


Grafiku Nr. 5/1 Prova e parë e duhanpirjes




Grafiku Nr. 5/2 Moshja e provimit të duhanit për herë të parë




Grafiku Nr. 5/3 Duhanpirja gjatë 30 ditëve



Grafiku Nr. 5/4 Mënyra e sigurimit të cigareve



Grafiku Nr. 5/5 Pirja e duhanit në ambiente shkollore



Grafiku Nr. 5 /6 Tentativa për të ndërprerë pirjen e duhanit





Tabela Nr. 12 Prevalenca e Përdorimit të Alkoolit

<u>Përdorimi i Alkoolit</u>	Total Nr=900(%)
Keni pi ndonjëherë pije alkoolike, më pak se disa gllënka ?	
1. Po	567(66.0)
2. Jo	303(34.0)
Sa vjeç ishit kur keni pi për herë të parë alkool disa gllënka ?	
1. Nuk kam pi asnjëherë alkool	303(34.0)
2. 16 vjeç ose më i vogël	465(43.0)
3. 17 vjeç	150(17.0)
4. 18 vjeç ose më i madh	54(6.0)
Gjatë 30 ditëve të fundit në sa ditë keni pi një pije alkoolike ?	
1. 1 ditë	396 (44.0)
2. 2 ditë	81(9.0)
3. 3 ditë	18(2.0)
4. 4-5 ditë	72 (8.0)
5. 10-20 ditë	18(2.0)
6. Të 30 ditët	9(1.0)
7. 0 ditë	303(34.0)
Gjatë 30 ditëve të fundit, si e keni siguruar alkoolin që keni pi?	
1. Nuk kam pi alkool gjatë 30 ditëve të fundit	303(34.0)
2. E bleva në një dyqan pijesh apo në supermarket	340(40.0)
3. E mora në një restorant	104(12.0)
4. Ma dha dikush	54(6.0)
5. E mora në një mënyrë tjetër	69(8.0)


Nga tabela Nr. 12 dhe grafiku Nr. 6, nga personat e marrë në studim 66% e tyre kishin provuar më pak se disa gllënka alkool. 52% e personave kishin provuar për herë të parë alkool në moshën 16 vjeç ose më pak. 1.5% e personave kishin pi alkool në më shumë se 20 ditë të muajit të fundit dhe 33% e tyre e blejnë alkoolin për konsum.

Grafiku Nr. 6 Prevalenca e Përdorimit të Alkoolit


Grafiku Nr. 6/1 Përdorimi i alkoolit për herë të parë



Grafiku Nr. 6/2 Moshja e fillimit të konsumimit të alkoolit për herë të parë



Grafiku Nr. 6/3 Konsumimi i alkoolit gjatë 30 ditëve



Grafiku Nr. 6/4 Mënyra e sigurimit të alkoolit gjatë 30 ditëve




Tabela Nr. 13 Prevalenca e Përdorimit të Drogave

<u>Drogat</u>	Total Nr=900(%)
<u>Marihuana</u>	
Gjatë jetës suaj, sa herë keni përdorur marihuanë ?	
1. 0 herë	837(93.0)
2. 1 ose 2 herë	39(4.0)
3. 3 ose më shumë	24(3.0)
Gjatë 30 ditëve të fundit sa herë keni përdorur marihuanë?	
1. 0 herë	837(93.0)
2. 1 ose 2 herë	36(4.0)
3. 3-ose më shumë herë	28(3.0)
Gjatë 30 ditëve të fundit sa herë keni përdorur marihuanë në një territor shkolle ?	
1. 0 herë	855(95.0)
2. 1 ose 2 herë	30(3.0)
3. 3-ose më shumë herë	15(2.0)
<u>Kokaina</u>	
Gjatë jetës suaj sa herë keni përdorur kokainë?	
1. 0 herë	870(96.0)
2. 1 ose 2 herë	15(2.0)
3. 3-ose më shumë herë	15(2.0)
Gjatë 30 ditëve të fundit sa herë keni përdorur kokainë?	
1. 0 herë	864(96.0)
2. 1 ose 2 herë	24(3.0)
3. 3-ose më shumë herë	12(1.0)
<u>Heroina</u>	
Gjatë jetës suaj sa herë keni përdorur heroinë?	

1. 0 herë	870(97.0)
2. 1 ose 2 herë	12(1.0)
3. 3-ose më shumë herë	18(2.0)
<u>Metamfetaminë</u>	
Gjatë jetës suaj sa herë keni përdorur metamfetaminë?	
1. 0 herë	267(96.0)
2. 1 ose 2 herë	24(3.0)
3. 3-ose më shumë herë	9(1.0)
<u>Ekstazi</u>	
Gjatë jetës suaj sa herë keni përdorur ekstazi?	
1. 0 herë	864(96.0)
2. 1 ose 2 herë	18(2.0)
3. 3-ose më shumë herë	18(2.0)
Gjatë jetës suaj sa herë keni përdorur pilula steroide pa recetën e mjekut?	
1. 0 herë	858(95.0)
2. 1 ose 2 herë	27(3.0)
3. 3-ose më shumë herë	15(2.0)
Gjatë jetës suaj sa herë keni përdorur një drogë të lejuar (të tilla si vikodinë, xanax, aderall, kodeinë) pa recetën e mjekut?	
1. 0 herë	864(96.0)
2. 1 ose 2 herë	24(3.0)
3. 3-ose më shumë herë	12(1.0)
Gjatë jetës suaj sa herë keni përdorur një shiringë për të injektuar një drogë të palejuar në trup?	
1. 0 herë	879(97.7)
2. 1 herë	18(2.0)
3. 2 ose më shumë herë	3(0.3)
Gjatë 12 muajve të fundit, ju ka ofruar, shitur apo dhënë, një drogë të palejuar në territor shkollor?	
1. Po	90(10.0)
2. Jo	810(90.0)

Nga tabela Nr. 13 dhe grafiku Nr. 7, nga personat e marrë në studim, 7% e tyre e kanë përdorur marihuanën të paktën 1 herë. 7% e tyre kanë përdorur të paktën një herë marihuanën në muajin e fundit. 5% e personave kanë përdorur marihuanën të paktën 1 herë në territor shkollor.


Ndërkohë 4 % e personave kanë përdorur kokainën të paktën 1 herë gjatë jetës dhe 4% e tyre kanë përdorur të paktën 1 herë gjatë muajit të fundit.

Heroinën e kanë provuar të paktën 1 herë gjatë jetës 3% e subjekteve, metamfetaminën 4%. ekstazinë 4%. 5% kanë përdorur të paktën 1 herë pilula steroide pa recetën e mjekut. 4% e personave kanë përdorur të paktën 1 herë droga të lejuara (vikodinë,xanax,aderall.kodeinë). 2.3% e tyre kanë përdorur të paktën 1 herë në jetë për


të injektuar një drogë të palejuar në trup. 10% e personave pohojnë se një person tjetër iu ka ofruar, shitur apo dhënë drogë të palejuar në mjedis shkollor.

Grafiku Nr. 7 Prevalenca e Përdorimit të Drogave


Grafiku Nr. 7/1 Përdorimi i marihuanës gjatë jetës




Grafiku Nr. 7/2 Përdorimi i marihuanës gjatë 30 ditëve të fundit




Grafiku Nr. 7/3 Përdorimi i marihuanës në territor shkollor




Grafiku Nr. 7/4 Përdorimi i kokainës




Grafiku Nr. 7/5 Përdorimi i kokainës gjatë 30 ditëve të fundit




Grafiku Nr. 7/6 Përdorimi i heroinës




Grafiku Nr. 7/7 Përdorimi i metamfetaminës




Grafiku Nr. 7/8 Përdorimi i ekstazisë




Grafiku Nr. 7/9 Përdorimi i pilulave steroide pa recetë



Grafiku Nr. 7/10 Përdorimi i drogave të lejuara pa recetën e mjekut



Grafiku Nr. 7/11 Përdorimi i shiringës në trup



Grafiku Nr. 7/12 Ofertë droge në ambientet shkollore




Tabela Nr. 14 Prevalenca e Sjelljeve seksuale


Sjelljet seksuale	Total Nr=900(%)
Keni patur ndonjëherë raporte seksuale?	
1. Po	249(28.0)
2. Jo	651(72.0)
Sa vjeç ishit kur patët raporte seksuale për herë të parë?	
1. Nuk kam patur asnjëherë raporte seksuale	636(72.0)
2. 11 ose më i ri	24(2.0)
3. 12 vjeç	12(1.0)
4. 13 vjeç	6(1.0)
5. 14 vjeç	66(7.0)
6. 15 vjeç	54(6.0)
7. 16 vjeç	48(5.0)
8. 17 vjeç ose më i madh	54(6.0)
Gjatë jetës suaj me sa partnerë keni patur raporte seksuale?	
1. Nuk kam patur asnjëherë raporte seksuale	636(72.0)
2. 1 person	270(15.0)
3. më shumë se 1 person	126(13.0)
Përdoret alkool apo ndonjë drogë përpara se të kryenit marrëdhënie seksuale, herën e fundit?	
1. Nuk kam patur asnjëherë raporte seksuale	636(72.0)
2. Po	75(8.0)
3. Jo	234(20.0)
Herën e fundit që kryet marrëdhënie seksuale, përdori partneri juaj kondom?	
1. Nuk kam patur asnjëherë raporte seksuale	636(72.0)
2. Po	138(12.0)
3. Jo	159(16.0)
Herën e fundit që kryet marrëdhënie seksuale, çfarë metode përdorët ju apo partneri juaj për të parandaluar një shtatzani?	
1. Nuk kam kryer asnjëherë marrëdhënie seksuale	636(72.0)
2. Nuk kam përdorur asnjë lloj metode	123(12.0)
3. Pilula	15(2.0)

4. Depo-Provera, dispozitiv intrauterin	0(0.0)
5. Kondom ose ndonjë metodë tjetër	99(11.0)
	27(3.0)


Nga tabela Nr. 14 dhe grafiku Nr. 8 shohim se, 28% e subjekteve raportuan se kanë patur raporte seksuale, ku 8% e totalit të 900 subjekteve kanë patur marrëdhënien e parë seksuale në moshë më të vogël se 14 vjeç. 13% e subjekteve kanë patur raporte seksuale me më shumë se 1 person. 8% e subjekteve kanë kryer marrëdhënie seksuale pas marrjes së alkoolit ose drogës. 16% e subjekteve pohojnë se herën e fundit që kishin kryer marrëdhënie seksuale partneri nuk kishte përdorur kondom. Ndërkohë 13% e subjekteve pohojnë se ata ose partneri/ja nuk kanë përdorur asnjë metodë për të shmangur shtatzaninë e padëshiruar.

Grafiku Nr. 8 Prevalenca e Sjelljeve seksuale


Grafiku Nr. 8/1 Marrëdhënie seksuale




Grafiku Nr. 8/2 Raporti i parë seksual dhe moshja




Grafiku Nr. 8/3 Marrëdhëniet seksuale dhe numri i partnerëve



Grafiku Nr. 8/4 Marrëdhënie seksuale dhe përdorimi i alkoolit dhe drogës



Grafiku Nr. 8/5 Marrëdhënie seksuale dhe përdorimi i kondomit



Grafiku Nr. 8/6 Marrëdhënie seksuale dhe tentativa për të parandaluar shtatzaninë e padëshiruar





Tabela Nr. 15 Prevalenca e Peshës trupore

Pesha trupore	Total Nr=900(%)
Si e perceptoni peshën tuaj trupore?	
1. Nëneshë	180(20.0)
2. Peshë normale	360(50.0)
3. Mbipeshë	180(20.0)
4. Obez/e	90(10.0)
Gjatë 30 ditëve të fundit keni ndenjur 24 orë ose më shumë pa ngrënë në mënyrë që të bini nga pesha apo të ruheni nga shtimi në peshë?	
1. Po	153(17.0)
2. Jo	747(83.0)
Gjatë 30 ditëve të fundit keni përdorur pilula apo lëngje pa përshkrimin e mjekut në mënyrë që të bini nga pesha apo të ruheni nga shtimi në peshë?	
1. Po	78(9.0)
2. Jo	822(91.0)
Gjatë 30 ditëve të fundit, keni përdorur laksativë apo keni vjellë në mënyrë që të bini nga pesha apo të ruheni nga shtimi në peshë ?	
1. Po	54(6.0)
2. Jo	846(94.0)


Nga tabela Nr. 15 dhe grafiku Nr. 9 shohim se 20 % e subjekteve janë nëneshë, 50% në peshën e duhur, 20% janë mbi peshë dhe 10 % janë obezë. 17% e subjekteve kanë qëndruar 24 orë ose më shumë pa konsumuar asgjë gjatë muajit të fundit, 9% e tyre kanë përdorur pilula ose lëngje pa përshkrim nga mjeku për të rënë në peshë ose për të mos shtuar peshë dhe 6% e subjekteve kanë përdorur laksativë ose kanë vjellë në mënyrë të qëllimshme për të rënë nga pesha.

Grafiku Nr. 9 Prevalenca e Peshës trupore


Grafiku Nr. 9/1 Perceptimi i peshës trupore



Grafiku Nr. 9/2 Përdorimi i pilulave pa recetë për të ruajtur peshën trupore



Grafiku Nr. 9/3 Mosngrënia për 24 orë për të ruajtur peshën trupore



Grafiku Nr. 9/4 Përdorimi i laksativëve për të ruajtur peshën trupore




Tabela Nr. 16 Prevalenca e Aktivitetit Fizik

Aktiviteti fizik	Total Nr=900(%)
Gjatë 7 ditëve, në sa ditë keni qenë fizikisht aktivë të paktën 20 minuta në ditë (shënoni të gjithë kohën që keni harxhuar në çdo lloj aktiviteti fizik që rrit pulsën apo ju ka shpeshësuar frymëmarrjen)?	
1. 1 ditë	273(31.0)
2. 2 ditë	120(13.0)
3. 3 ditë	120(13.0)
4. 4 ditë	90(10.0)
5. 5 ditë	39(5.0)
6. 6 ditë	36(3.0)
7. 7 ditë	108(12.0)
8. 0 ditë	114(13.0)
Gjatë ditëve normale të shkollës, sa orë në ditë luani me videolajra apo kompjuter, apo përdorni kompjuterin për punë jashtë shkolle si facebook, internet?	
1. Në ditët e shkollës nuk luaj me videolajra apo kompjuter	198(22.0)
2. Më pak se një orë në ditë	219(24.0)
3. Një orë në ditë	162(18.0)
4. 2 orë në ditë	120(14.0)
5. 3 orë në ditë	66(7.0)
6. 4 orë në ditë	33(4.0)
7. 5 ose më shumë orë në ditë	102(11.0)
Gjatë ditëve normale të shkollës, sa orë në ditë shikoni televizor?	
1. Në ditët e shkollës nuk shoh televizor	108(12.0)
2. Më pak se një orë në ditë	87(10.0)
3. Një orë në ditë	135(15.0)
4. 2 orë në ditë	234(26.0)
5. 3 orë në ditë	159(18.0)
6. 4 orë në ditë	93(10.0)
7. 5 ose më shumë orë në ditë	84(9.0)
Gjatë një jave normale të shkollës, në sa ditë jave shkoni në orët	


e edukimit fizik?

1. 0 ditë	327(36.0)
2. 1 ditë	231(26.0)
3. 2 ditë	240(27.0)
4. 3 ditë	57(6.0)
5. 4 ditë	0(0.0)
6. 5 ditë	45(5.0)


Nga Tabela Nr. 16 dhe grafiku Nr. 10 shohim se 13% e subjekteve raportojnë se nuk kryejnë asnjë ditë të javës aktivitet fizik. 22% e tyre luajnë videolojra ose e përdorin kompjuterin për punë jashtë shkolle për 3 orë ose më shumë në ditë. 37% e subjekteve shohin televizor të paktën 1 orë në ditë dhe 36% e tyre nuk shkojnë në asnjë orë të aktivitetit fizik në shkollë.

Grafiku Nr. 10 Prevalenca e Aktivitetit Fizik


Grafiku Nr. 10/1 Ushtrim aktiviteti fizik gjatë një jave për të paktën 20 minuta



Grafiku Nr. 10/2 Koha e përdorimit të kompjuterit për videolojra ose internet



Grafiku Nr. 10/2 Koha e të parit televizor gjatë ditëve të shkollës



Grafiku Nr. 10/3 Ushtrimi i edukimit fizik gjatë 7 ditëve




Tabela Nr. 17 Prevalenca e Mënyrës së Ushqyerjes

Mënyra e Ushqyerjes	Total Nr=900(%)
Gjatë 7 ditëve të fundit, sa herë keni pi lëng të pastër(të shtrydhur) frutash?	
1. Nuk kam pi gjatë 7 ditëve të fundit	156(17.0)
2. Kam pi 1-3 herë gjatë 7 ditëve të fundit	360(40.0)
3. -6 herë gjatë 7 ditëve	156(17.0)
4. 1 herë në ditë	78(9.0)
5. 2 herë në ditë	51(6.0)
6. 3 herë në ditë	57(6.0)
7. 4 ose më shumë herë në ditë	42(5.0)
Gjatë 7 ditëve të fundit sa herë keni ngrënë fruta(përjashto lëngjet e e frutave)?	
1. Nuk kam ngrënë gjatë 7 ditëve të fundit	63(7.0)
2. Kam ngrënë 1-3 herë gjatë 7 ditëve të fundit	237(26.0)
3. 4-6 herë gjatë 7 ditëve	156(17.0)
4. 1 herë në ditë	96(11.0)


5. 2 herë në ditë	138(15.0)
6. 3 herë në ditë	114(13.0)
7. 4 ose më shumë herë në ditë	96(11.0)
Gjatë 7 ditëve të fundit sa herë keni ngrënë sallatë jeshile?	
1. Nuk kam ngrënë gjatë 7 ditëve të fundit	126(14.0)
2. Kam ngrënë 1-3 herë gjatë 7 ditëve të fundit	321(36.0)
3. 4-6 herë gjatë 7 ditëve	123(14.0)
4. 1 herë në ditë	198(22.0)
5. 2 herë	66(7.0)
6. 3 herë në ditë	21(2.0)
7. 4 ose më shumë herë në ditë	45(5.0)
Gjatë 7 ditëve të fundit sa herë keni ngrënë perime?	
1. Nuk kam ngrënë gjatë 7 ditëve të fundit	75(8.0)
2. Kam ngrënë 1-3 herë gjatë 7 ditëve të fundit	315(35.0)
3. 4-6 herë gjatë 7 ditëve	162(18.0)
4. 1 herë në ditë	204(23.0)
5. 2 herë në ditë	63(7.0)
6. 3 herë në ditë	36(4.0)
7. 4 ose më shumë herë në ditë	45(5.0)
Gjatë 7 ditëve të fundit sa herë keni pi lëngje të tilla si soda, pepsi, kola, sprite?	
1. Nuk kam pi gjatë 7 ditëve të fundit	153(17.0)
2. Kam pi 1-3 herë gjatë 7 ditëve të fundit	390(43.0)
3. 4-6 herë gjatë 7 ditëve	105(12.0)
4. 1 herë në ditë	153(17.0)
5. 2 herë në ditë	60(7.0)
6. 3 herë në ditë	15(2.0)
7. 4 ose më shumë herë në ditë	24(2.0)
Gjatë 7 ditëve të fundit sa gota me qumësht keni pi?	
1. Nuk kam pi fare gjatë 7 ditëve të fundit	330(37.0)
2. 1-3 gota gjatë 7 ditëve të fundit	213(23.0)
3. 4-6 gota gjatë 7 ditëve të fundit	87(10.0)
4. 1 gotë në ditë	213(23.0)
5. 2 gota në ditë	33(4.0)
6. 3 gota në ditë	0(0.0)
7. 4 ose më shumë gota në ditë.	24(3.0)
Gjatë 7 ditëve të fundit, sa herë keni ngrënë mëngjes?	
1. 0 ditë	243(27.0)
2. 1 ditë	96(11.0)
3. 2 ditë	93(10.0)
4. 3 ditë	36(4.0)
5. 4 ditë	42(5.0)
6. 5 ditë	48(5.0)
7. 6 ditë	21(2.0)
8. 7 ditë	321(36.0)

Nga tabela Nr. 17 dhe grafiku Nr. 11 shohim se 17% e subjekteve nuk kanë pi asnjëherë lëng të pastër frutash gjatë javës së fundit. 7% e tyre nuk kanë ngrënë asnjëherë fruta gjatë javës së fundit. 14% e subjekteve nuk kanë konsumuar asnjëherë sallatë jeshile gjatë javës së fundit. 8% e tyre nuk kanë konsumuar asnjëherë perime gjatë javës së fundit. 40% e


subjekteve kishin pi më shumë se 4 herë lëngje si pepsi, kola ose soda gjatë javës së fundit. 37% e tyre nuk kanë pi asnjëherë qumësht gjatë javës së fundit dhe 52% e tyre kishin konsumuar më pak se 2 herë mëngjesin gjatë javës së fundit.

Grafiku Nr. 11 Mënyra e Ushqyerjes


Grafiku Nr. 11/1 Përdorimi i lëngjeve të shtrydhur të frutave gjatë një jave




Grafiku Nr. 11/2 Përdorimi i frutave gjatë një jave




Grafiku Nr. 11/3 Përdorimi i sallatës jeshile gjatë një jave




Grafiku Nr. 11/4 Përdorimi i perimeve gjatë një jave



Grafiku Nr. 11/5 Përdorimi i lëngjeve të gazuara gjatë një jave



Grafiku Nr. 11/6 Përdorimi i qumështit gjatë një jave



Grafiku Nr. 11/7 Përdorimi i vaktit të mëngjesit gjatë një jave





Tabela Nr. 18 Prevalenca e Informacionit rreth Shëndetit

Informacionit rreth <u>Shëndetit</u>	Total Nr=900(%)
Ju kanë mësuar rreth SIDËS apo infeksionit nga HIV në shkollë? 1. Po 2. Jo 3. Nuk jam i/e sigurt	792(88.0) 87(10.0) 21(2.0)
Keni bërë ndonjë analizë për HIV, virusi që shkakton SIDËN?(mos përfshi rastin nëse e keni bërë kur keni dhuruar gjak)? 1. Po 2. Jo 3. Nuk jam i/e sigurt	72(8.0) 777(86.0) 51(6.0)
Kur jeni jashtë për më shumë se një orë në ditët me diell, përdorni kremra mbrojtës me SPF 15 apo më shumë? 1. Asnjëherë 2. Ndonjëherë 3. Shumicën e kohës	681(76.0) 156(17.0) 63(7.0)
Në një ditë normale shkolle sa orë flini mesatarisht? 1. 4 orë ose më pak 2. 5 orë 3. 6 orë 4. 7 orë 5. 8 orë 6. 9 orë 7. 10 orë ose më shumë	135(15.0) 120(13.0) 93(10.0) 222(25.0) 234(26.0) 72(8.0) 24(3.0)
Gjatë 12 muajve të fundit, keni folur me mësuesin/mësuesen apo ndonjë të rritur tjetër në shkollën tuaj për ndonjë problem tuaj që mund të keni patur? 1. Po 2. Jo	267(30.0) 633(70.0)


Nga tabela Nr. 18 dhe grafiku Nr. 12 shohim se 10% e subjekteve thonë se nuk i kanë mësuar rreth SIDËS ose infeksionit HIV në shkollë. 86% e tyre nuk kanë bërë analizë për HIV/SIDËN asnjëherë gjatë jetës. 76% e subjekteve nuk përdorin kremra mbrojtës kundër diellit kur dalin jashtë. 38% e tyre flenë 6 orë ose më pak në ditët normale të shkollës dhe 70% e subjekteve thonë se nuk kanë folur me mësuesin/mësuesin për ndonjë problem që mund të kishin pasur.

Grafiku Nr. 12 Prevalenca e Informacionit rreth Shëndetit


Grafiku Nr. 12/1 Informacion i marrë në shkollë rreth HIV/SIDËS




Grafiku Nr. 12/2 Analiza të kryera për HIV




Grafiku Nr. 12/3 Përdorimi i kemit mbrojtës në ditët me diell



Grafiku Nr. 12/4 Koha e gjumit në ditët normale të shkollës



Grafiku Nr. 12/5 Konsultim me të rriturit ose mësuesin për probleme të ndryshme



4.2 Lidhja midis Moshës dhe Sjelljeve në risk

Tabela Nr .19 Lidhja midis Moshës dhe Masave mbrojtëse në rrugë

Moshë					
Pyetjet	<=16 vjeç	17 vjeç	>=18 vjeç	Chi square	P value
Siguria në rrugë	273(%)	303(%)	324(%)		
Keni përdorur kokore gjatë drejtimit të biçikletës ose motorit?					
1. Asnjëherë	189(69.2)	264(87.1)	267(82.4)	86.3	0.001
2. Rrallë	66(24.2)	39(12.9)	24(7.4)		
3. Në pjesën më të madhe të kohës	18(6.6)	0(0.0)	33(10.2)		
Keni përdorur rripin e sigurimit në makinë?					
1. Asnjëherë	108(39.6)	66(21.8)	138(37.6)	33.6	0.001
2. Rrallë	129(47.2)	150(49.5)	141(48.5)		
3. Në pjesën më të madhe të kohës	36(13.2)	87(28.7)	45(13.9)		
Keni udhëtuar ndonjëherë me makinë që drejtohej nga person që kishte konsumuar alkool?					
1. Po	99(36.3)	108(35.6)	114(35.2)	5.6	0.23
2. Jo	138(50.5)	129(42.6)	126(38.9)		
3. Nuk jam i sigurt	36(13.2)	66(21.8)	84(25.9)		
I keni dhënë makinës kur keni pasë konsumuar alkool?					
1. 0 herë	243(89.0)	288(95.0)	285(88.0)	6.9	0.32
2. 1 -3 herë	15(5.5)	9(3.0)	27(8.3)		
3. më shumë se 3 herë	15(5.5)	6(2.0)	12(3.7)		

Nga Tabela Nr. 19, e cila paraqet shoqërimin midis moshës dhe masave mbrojtëse në rrugë, nuk u gjet lidhje sinjifikante midis faktit se sa shpesh personat kishin udhëtuar në një makinë që drejtohej nga një person i cili kishte konsumuar alkool, se sa herë personat i kishin dhënë makinës në gjendje të tillë dhe moshës. Ndërkohë u gjet një lidhje statistikisht sinjifikante midis moshës dhe faktit nëse personat e vendosnin kokoren kur lëviznin me biçikletë (P value=0.001; moshë 17 vjeç e përdornin më pak kokoren); midis moshës dhe vendosjes së rripit të sigurimit (P value=0.001; moshë 16 vjeç ose më e vogël e vendosnin më pak rripin e sigurimit)

Tabela Nr. 20 Lidhja ndërmjet Moshës dhe Dhunës tek të rinjtë

Moshë					
Pyetjet	<=16 vjeç	17 vjeç	>=18 vjeç	Chi square	P value
Dhuna	273(%)	303(%)	324(%)		
Keni mbajtur ndonjëherë një armë si, pistoletë, thikë?					
1. Po	54(19.8)	57(18.8)	57(17.6)	0.2	0.92
2. Jo	219(80.2)	246(81.2)	258(82.4)		
Jeni përfshirë ndonjëherë në zënie					

(ndeshje fizike), në të cilën ju jeni dëmtuar dhe keni patur nevojë për trajtim mjekësor?					
1. Po	102(37.4)	108(35.6)	129(39.8)	0.4	0.82
2. Jo	171(62.6)	195(64.4)	195(60.2)		
Gjatë 12 muajve të fundit, sa herë jeni ndeshur fizikisht brenda ambjenteve të shkollës?					
1. Jo	234(85.7)	258(85.1)	264(81.5)	5.1	0.53
2. Po	39(14.3)	45(14.9)	60(18.5)		
Gjatë 12 muajve të fundit, ju ka goditur i/e dashuri/e me shuplakë apo ju ka dëmtuar fizikisht?					
1. Po	21(7.7)	27(8.9)	9(2.8)	3.7	0.16
2. Jo	252(92.3)	276(91.1)	315(97.2)		

Nga Tabela Nr. 20 që paraqet shoqërimin midis moshës dhe dhunës ndërmjet të rinjve, nuk u gjet lidhje statistikisht e rëndësishme midis moshës dhe mbajtjes së armëve, përfshirjes në një zënkë ku është nevojitur trajtim mjekësor, nëse personat janë përfshirë në zënkë brenda në ambientet e shkollës, faktit nëse gjatë vitit të fundit partneri i ka goditur me shuplakë.

Tabela Nr. 21 Lidhja midis Moshës dhe Vetëvrasjes

Pyetjet	Moshë			Chi square	P value
	<=16 vjeç	17 vjeç	>=18 vjeç		
Vetëvrasja	273(%)	303(%)	324(%)		
Keni menduar ndonjëherë seriozisht për të vrrarë veten?					
1. Po	24(8.8)	57(18.8)	30(9.3)	5.9	0.052
2. Jo	249(91.2)	246(81.2)	294(90.7)		
Tabela Nr. 44 Lidhja midis Vendbanimit dhe Duhanpirjes

Pyetjet	Vendbanimi			
	Fshat (Nr%) 255 (28.3)	Qytet (Nr%) 645 (71.7)	Chi square	Vlera P
Duhanpirja				
Keni provuar ndonjëherë të pini duhan, qoftë edhe një ,apo dy puf ?				
1. *Po	27(10.6)	39(6.0)	1.8	0.18
2. Jo	228(89.4)	606(94.0)		
Sa vjeç ishit kur keni pi një cigare të plotë për herë të parë?				
1. *Nuk kam pi asnjëherë	144(56.5)	294(45.6)	1.8	0.18
2. 16 ose më i vogël	75(29.4)	225(34.9)	2.5	0.12
3. 17 vjeç	27(10.6)	105(16.3)	0.04	0.85
4. 18 ose më i madh	9(3.5)	21(3.2)		
Gjatë 30 ditëve të fundit, sa ditë keni pi duhan?				
1. *0 ditë	180(70.6)	492(76.3)	1.6	0.21
2. 1-2 ditë	27(10.6)	42(6.5)	7.3	0.01

3. 3-5 ditë	24(9.4)	15(2.3)	0.45	0.50
4. 6-9 ditë	9(3.5)	15(2.3)	0.07	0.79
5. 10-19 ditë	3(1.2)	6(0.9)	1.1	0.29
6. 20-29 ditë	0(0)	9(1.4)	1.6	0.21
7. Të 30 ditët	12(4.7)	66(10.3)		
Gjatë 30 ditëve të fundit, si i siguronit zakonisht cigaret?				
1. *Nuk kam pi cigare gjatë 30 ditëve të fundit	204(80.0)	468(77.2)	3.4	0.07
2. I bleva në një dyqan si, supermarket	6(2.4)	54(8.4)	2.0	0.15
3. I bleva tek një makinë shitëse	0(0)	15(2.3)	1.0	0.31
4. I a dhashë dikujt tjetër paratë që të mi blinte	9(3.5)	42(1.9)	0.8	0.37
5. Ia mora dikujt borxh	18(7.1)	27(4.2)	4.8	0.03
6. Një person mbi 18 vjeç ose më i madh mi dha cigaret	6(2.4)	0(0.0)		
7. I mora nga një person i familjes	9(3.5)	27(4.2)	0.09	0.76
8. I sigurova në një mënyrë tjetër	3(1.1)	12(1.8)	0.19	0.66
Keni pi ndonjëherë cigare në ambiente shkolle?				
1. *Po	48(18.8)	135(20.9)	0.17	0.68
2. Jo	207(81.2)	510(79.1)		
Gjatë 12 muajve të fundit keni tentuar të ndërprisni pirjen e duhanit?				
1. *Nuk kam pi duhan	183(71.8)	417(64.7)	0.9	0.34
2. Po	33(12.9)	108(16.7)	0.7	0.39
3. Jo	39(15.3)	120(18.6)		

Tabela Nr. 45 Lidhja midis Vendbanimit dhe Përdorimit të Alkoolit

Pyetjet	Vendbanimi		Chi square	Vlera P
	Fshat (Nr%) 255 (28.3)	Qytet (Nr%) 645 (71.7)		
Përdorimi i Alkoolit				
Keni pi ndonjëherë pije alkoolike, më pak se disa gllënka?				
1. *Po	156(61.2)	459(71.2)	2.8	0.09
2. Jo	99(38.8)	186(28.8)		
Sa vjeç ishit kur keni pi për herë të parë alkool disa gllënka?				
1. *Nuk kam pi asnjëherë alkool, madje edhe disa gllënka	81(31.8)	135(20.9)	5.5	0.02
2. 16 vjeç ose më i vogël	114(44.7)	387(60.0)	0.001	0.98
3. 17 vjeç	48(18.8)	81(13.1)	1.2	0.28
4. 18 vjeç ose më i madh	12(4.7)	39(6.0)		
Gjatë 30 ditëve të fundit në sa ditë keni pi një pije alkoolike ?				
1. *1 ditë	162(63.5)	642(53.0)	0.04	0.84

2. 2 ditë	30(11.8)	69(10.7)	1.2	0.27
3. 3 ditë	9(3.5)	39(6.0)	2.6	0.11
4. 4-5 ditë	18(7.1)	81(12.6)	0.1	0.74
5. 10-20 ditë	9(3.5)	24(3.7)	0.6	0.45
6. Të 30 ditët	6(2.4)	6(0.9)	2.0	0.16
7. 0 ditë	21(8.2)	84(13.1)		
Gjatë 30 ditëve të fundit, si e keni siguruar alkoolin që keni pi?				
1. *Nuk kam pi alkool gjatë 30 ditëve të fundit	135(52.9)	294(45.6)	2.0	0.16
2. E bleva në një dyqan pijesh apo në supermarket	51(20.0)	177(27.4)	3.2	0.07
3. E mora në një restorant	15(5.9)	81(12.6)	1.9	0.17
4. Ma dha dikush	27(10.6)	30(4.7)	0.03	0.88
5. E mora në një mënyrë tjetër	27(10.6)	63(9.7)		

Nga tabela Nr. 45 ekziston një diferencë statistikisht e rëndësishme (P value=0.02) midis vendbanimit dhe moshës kur kanë konsumuar disa gllënka alkool, ku për moshën 16 vjeç ose më pak, individët në qytet zënë përqindjen më të madhe. 60.0% të subjekteve me banim në qytet kanë provuar alkoolin në moshën 16 vjeçare ose më të vogël).

Tabela Nr. 46 Lidhja midis Vendbanimit dhe Përdorimit të Drogave

Pyetjet	Vendbanimi			
	Fshat (Nr%) 255 (28.3)	Qytet (Nr%) 645 (71.7)	Chi square	Vlera P
Drogat				
Marihuana				
Gjatë jetës suaj, sa herë keni përdorur marihuanë?				
1. *0 herë	237(92.8)	606(94.0)	29.8	0.00001
2. 1 ose 2 herë	9(3.6)	30(4.6)	1.2	0.28
3. 3 ose më shumë herë	9(3.6)	9(1.4)	2.5	0.11
Gjatë 30 ditëve të fundit sa herë keni përdorur marihuanë?				
1. *0 herë	234(91.8)	600(93.0)	0.7	0.39
2. 1 ose 2 herë	6(2.2)	30(4.6)	0.08	0.78
3. 3 ose më shumë herë	15(6.0)	15(2.4)	0.39	0.53
Gjatë 30 ditëve të fundit sa herë keni përdorur marihuanë në një territor shkolle?				
1. 0 herë	237(92.8)	606(94.0)	0.2	0.69
2. 1 ose 2 herë	9(3.6)	30(4.6)	1.2	0.28
3. 3 ose më shumë herë	9(3.6)	9(1.4)	2.5	0.11
Kokaina				
Gjatë jetës suaj sa herë keni përdorur kokainë?				
1. *0 herë	234(91.8)	627(97.6)	1.3	0.25
2. 1 ose 2 herë	12(4.7)	15(2.3)	4.5	0.03
	9(3.5)	3(0.1)		

3. 3 ose më shumë herë				
Gjatë 30 ditëve të fundit sa herë keni përdorur kokainë?				
1. 0 herë	240(94.1)	633(98.1)	0.4	0.54
2. 1 ose 2 herë	6(2.4)	9(1.4)	0.5	0.48
3. 3 ose më shumë herë	9(3.5)	3(0.5)	5.2	0.02
Heroina				
Gjatë jetës suaj sa herë keni përdorur heroinë?				
1. 0 herë	237(92.9)	633(98.1)	2.0	0.16
2. 1 ose 2 herë	12(4.7)	12(1.9)	5.2	0.02
3. 3 ose më shumë herë	6(2.4)	0(0.0)		
Metamfetaminë				
Gjatë jetës suaj sa herë keni përdorur metamfetaminë?				
1. *0 herë	246(96.5)	630(97.6)	1.5	0.21
2. 1 ose 2 herë	0(0.0)	12(1.9)	4.2	0.04
3. 3 ose më shumë herë	9(3.5)	3(0.5)		
Ekstazi				
Gjatë jetës suaj sa herë keni përdorur ekstazi?				
1. *0 herë	243(95.3)	630(97.6)	1.9	0.17
2. 1 ose 2 herë	12(4.7)	12(1.9)	0.39	0.54
3. 3 ose më shumë herë	0(0.0)	3(0.5)		
Gjatë jetës suaj sa herë keni përdorur pilula steroide pa recetën e mjekut?				
1. *0 herë	237(92.9)	627(97.2)	0.6	0.44
2. 1 ose 2 herë	3(1.2)	18(2.8)	7.7	0.005
3. 3 ose më shumë herë	15(5.9)	0(0.0)	5.2	0.02
Gjatë jetës suaj sa herë keni përdorur një drogë të lejuar (të tilla si vikodinë, Xanax, aderall. kodeinë) pa recetën e mjekut?				
1. *0 herë	237(92.9)	630(97.6)	1.9	0.16
2. 1 ose 2 herë	12(4.7)	12(1.9)	2.6	0.11
3. 3 ose më shumë herë	6(2.4)	3(0.5)	0.5	0.47
Gjatë jetës suaj sa herë keni përdorur një shiringë për të injektuar një drogë të palejuar në trup?				
1. *0 herë	249(97.6)	639(98.6)	0.02	0.89
2. 1 herë	3(1.2)	6(1.4)	2.5	0.11
3. 2 ose më shumë herë	3(1.2)	0(0.0)		

Tabela Nr. 47 Lidhja midis Vendbanimit dhe Sjelljeve seksuale

Pyetjet	Vendbanimi			
	Fshat (Nr%) 255 (28.3)	Qytet (Nr%) 645 (71.7)	Chi square	Vlera P
Sjelljet seksuale				
Keni patur ndonjëherë raporte seksuale?				
1. *Po	27(10.6)	48(7.4)	0.8	0.37
2. Jo	228(89.4)	597(92.6)		
Sa vjeç ishit kur patët raporte seksuale për herë të parë?				
1. *Nuk kam patur asnjëherë raporte seksual	183(71.8)	444(68.8)	1.6	0.21
2. 11 vjeç ose më i ri	12(4.7)	12(1.9)	0.8	0.37
3. 12 vjeç	0(0.0)	6(0.9)	0.8	0.37
4. 13 vjeç	0(0.0)	6(0.9)	3.9	0.047
5. 14 vjeç	9(3.5)	72(11.2)	0.006	0.94
6. 15 vjeç	18(7.1)	42(6.5)	0.57	0.45
7. 16 vjeç	12(4.7)	45(7.0)	3.5	0.06
8. 17 vjeç ose më i madh	21(8.2)	18(2.8)		
Gjatë jetës suaj me sa partnerë keni patur raporte seksuale?				
1. Nuk kam patur asnjëherë raporte seksuale	183(71.8)	447(69.3)	0.004	0.95
2. 1 person	36(14.1)	90(14.0)	1.0	0.31
3. më shumë se 1 person	36(14.1)	108(16.7)	0.2	0.63
Përdoret alkool apo ndonjë drogë përpara se të kryenit marrëdhënie seksuale, herën e fundit?				
1. *Nuk kam patur asnjëherë raporte seksuale	168(65.9)	417(64.7)	3.9	0.05
2. Po	36(14.1)	39(6.0)	1.6	0.2
3. Jo	51(20.0)	189(29.3)		
Herën e fundit që kryet marrëdhënie seksuale, përdori partneri juaj kondom?				
1. *Nuk kam patur asnjëherë raporte seksuale	174(68.2)	417(64.7)	0.06	0.81
2. Po	39(15.3)	102(15.8)	0.4	0.52
3. Jo	42(16.5)	126(19.5)		
Herën e fundit që kryet marrëdhënie seksuale, çfarë metode përdorët ju apo partneri juaj për të parandaluar një shtatzani?				
1. *Nuk kam kryer asnjëherë marrëdhënie seksuale	196(76.8)	438(67.9)	0.09	0.77
2. Nuk kam përdorur asnjë lloj metode	43(16.8)	87(13.5)	1.3	0.26
3. Pilula	0(0.0)	9(1.4)	3.8	0.053
4. Depo-Provera, dispozitiv intrauterin	0(0.0)	27(4.2)	7.1	0.008
5. Kondom ose ndonjë metode tjetër	16(6.4)	84(13.0)		

Tabela Nr. 48 Lidhja midis Vendbanimit dhe Peshës trupore

Pyetjet	Vendbanimi			
	Fshat (Nr%) 255 (28.3)	Qytet (Nr%) 645 (71.7)	Chi square	Vlera P
Pesha trupore				
Si e përshkruani veten në lidhje me peshën trupore?				
1. * Nëneshë	48(18.8.)	120(18.6)	0.01	0.92
2. Në peshën e duhur	180(70.6)	441(68.4)	0.02	0.90
3. Mbipeshë	18(7.1)	66(10.2)	10.7	0.001
4. Obez/e	9(3.5)	18(2.8)	0.09	0.77
Çfarë jeni duke bërë aktualisht në lidhje me peshën tuaj?				
1. Po bie nga pesha	57(22.4)	117(18.1)	0.9	0.33
2. Po shtoj në peshë	42(16.5)	129(20.0)	1.0	0.31
3. Po ruaj peshën që kam	111(43.5)	321(49.8)	0.2	0.69
4. Nuk po bëj asgjë në lidhje me peshën trupore	45(17.6)	78(12.1)		
Gjatë 30 ditëve të fundit keni përdorur pilula apo lëngje pa përshkrimin e mjekut në mënyrë që të bini nga pesha apo të ruheni nga shtimi në peshë?				
1. *Po	57(22.4)	93(14.4)	2.8	0.09
2. Jo	198(77.6)	552(85.6)		
Gjatë 30 ditëve të fundit, keni përdorur laksativë apo keni vjellë në mënyrë që të bini nga pesha apo të ruheni nga shtimi në peshë?				
1. *Po	24(9.4)	42(6.5)		
2. Jo	231(90.6)	603(93.5)	0.8	0.39

Tabela Nr. 49 Lidhja midis Vendbanimit dhe Aktivitetit fizik

Pyetjet	Vendbanimi			
	Fshat (Nr%) 255 (28.3)	Qytet (Nr%) 645 (71.7)	Chi square	Vlera P
Aktiviteti fizik				
Gjatë 7 ditëve, në sa ditë keni qenë fizikisht aktive të paktën 60 minuta në ditë(shënoni të gjithë kohën që keni harxhuar në çdo lloj aktiviteti fizik që rrit pulsën apo ju ka shpeshësuar frymëmarrjen)?				
1. *1 ditë	72(28.2)	201(31.2)	0.8	0.37
2. 2 ditë	39(15.3)	75(11.6)	0.4	0.53
3. 3 ditë	39(15.3)	84(13.0)	3.8	0.051
4. 4 ditë	42(16.5)	51(7.9)	2.5	0.12
5. 5 ditë	3(1.2)	39(6.0)	0.5	0.47

6. 6 ditë	6(2.4)	30(4.7)	0.7	0.41
7. 7 ditë	21(8.2)	87(13.5)	0.15	0.69
8. 0 ditë	33(12.9)	78(12.1)		
Gjatë ditëve normale të shkollës, sa orë në ditë luani më videoljra apo kompjuter, apo përdorni kompjuterin për punë jashtë shkolle si facebook, internet?				
1. *Në ditët e shkollës nuk luaj më videoljra apo kompjuter	66(25.9)	117(18.1)	0.9	0.34
2. Më pak se një orë në ditë	63(24.7)	159(24.7)	0.2	0.65
3. një orë në ditë	51(20.0)	108(16.7)	0.9	0.34
4. 2 orë në ditë	36(14.1)	96(14.9)	0.4	0.52
5. 3 orë në ditë	15(5.9)	39(6.6)	0.03	0.86
6. 4 orë në ditë	12(4.7)	27(3.7)	7.5	0.006
7. 5 ose më shumë orë në ditë	12(4.7)	99(15.3)		
Gjatë ditëve normale të shkollës, sa orë në ditë shikoni televizor?				
1. *Në ditët e shkollës nuk shoh televizor	36(14.1)	51(7.9)	0.3	0.61
2. Më pak se një orë në ditë	27(10.6)	51(7.9)	0.6	0.45
3. një orë në ditë	42(16.5)	87(13.5)	1.8	0.18
4. 2 orë në ditë	72(28.2)	186(28.8)	10.2	0.001
5. 3 orë në ditë	27(10.6)	138(21.4)	0.04	0.83
6. 4 orë në ditë	36(14.1)	57(8.8)	4.4	0.04
7. 5 ose më shumë orë në ditë	15(5.9)	75(11.7)		

Tabela Nr. 50 Lidhja midis Vendbanimit dhe Mënyrës së Ushqyerjes

Pyetjet	Vendbanimi			
	Fshat (Nr%) 255 (28.3)	Qytet (Nr%) 645 (71.7)	Chi square	Vlera P
Mënyra e Ushqyerjes				
Gjatë 7 ditëve të fundit, sa herë keni pi lëng të pastër (të shtrydhur) frutash?				
1. *Nuk kam pi gjatë 7 ditëve të fundit	36(14.1)	123(19.1)	0.7	0.39
2. Kam pi 1-3 herë gjatë 7 ditëve të fundit	111(43.5)	273(42.3)	1.5	0.22
3. 4-6 herë gjatë 7 ditëve	39(15.4)	75(11.6)	0.7	0.39
4. 1 herë në ditë	45(17.6)	105(16.3)	0.4	0.53
5. 2 herë në ditë	9(3.5)	48(7.4)	2.9	0.09
6. 3 herë në ditë	6(2.4)	3(0.5)	0.5	0.49
7. 4 ose më shumë herë në ditë	9(3.5)	18(2.8)		
Gjatë 7 ditëve të fundit sa herë keni ngrënë fruta (përfshijto lëngjet e frutave)?				
1. *0 ditë	84(32.9)	207(32.1)	1.1	0.29
2. 1 ditë	57(22.4)	201(31.2)	0.02	0.89
3. 2 ditë	75(29.4)	177(27.4)	3.6	0.059
4. 3 ditë	24(9.4)	21(3.3)	0.009	0.93

5. 5 ditë	15(5.9)	39(6.0)		
Gjatë 7 ditëve të fundit sa herë keni ngrënë sallatë jeshile?				
1. *Nuk kam ngrënë gjatë 7 ditëve të fundit	24(9.4)	36(5.6)	0.4	0.50
2. Kam ngrënë 1-3 herë gjatë 7 ditëve të fundit	69(27.1)	147(22.8)	0.5	0.46
3. 4-6 herë gjatë 7 ditëve	51(20.0)	114(17.7)	4.7	0.03
4. 1 herë në ditë	12(4.7)	78(12.1)	0.2	0.72
5. 2 herë në ditë	51(20.0)	93(14.4)	0.9	0.33
6. 3 herë në ditë	33(12.9)	87(13.4)	4.7	0.03
7. 4 ose më shumë herë në ditë	15(5.9)	90(14.0)		
Gjatë 7 ditëve të fundit sa herë keni ngrënë perime?				
1. *Nuk kam ngrënë gjatë 7 ditëve të fundit	36(14.1)	90(14.0)	0.07	0.79
2. *Kam ngrënë 1-3 herë gjatë 7 ditëve të fundit	105(41.2)	237(36.7)	0.01	0.92
3. 4-6 herë gjatë 7 ditëve	39(15.3)	93(14.4)	0.1	0.72
4. 1 herë në ditë	48(18.8)	141(21.9)	1.0	0.32
5. 2 herë në ditë	27(10.6)	39(6.0)	1.9	0.17
6. 3 herë në ditë	0(0.0)	15(2.3)	3.7	0.054
7. 4 ose më shumë herë në ditë	0(0.0)	30(4.7)		
Gjatë 7 ditëve të fundit sa herë keni pi lëngje të tilla si soda, pepsi, kola, sprite?				
1. *Nuk kam pi gjatë 7 ditëve të fundit	36(13.0)	123(19.1)	0.7	0.39
2. Kam pi 1-3 herë gjatë 7 ditëve të fundit	111(43.5)	273(42.3)	1.5	0.22
3. 4-6 herë gjatë 7 ditëve	39(14.1)	75(11.6)	0.7	0.39
4. 1 herë në ditë	45(20.0)	105(16.3)	0.4	0.53
5. 2 herë në ditë	9(3.5)	48(7.4)	2.9	0.09
6. 3 herë në ditë	6(2.4)	3(0.5)	0.5	0.49
7. 4 ose më shumë herë në ditë	9(3.5)	18(2.8)		
Gjatë 7 ditëve të fundit sa gota me qumësht keni pi?				
1. *Nuk kam pi fare gjatë 7 ditëve të fundit	54(21.2)	102(15.8)	0.6	0.43
2. 1-3 gota gjatë 7 ditëve të fundit	102(40.0)	255(39.5)	0.2	0.68
3. 4-6 gota gjatë 7 ditëve të fundit	51(20.0)	114(17.7)	3.5	0.06
4. 1 gotë në ditë	12(4.7)	69(10.7)	1.4	0.23
5. 2 gota në ditë	9(3.5)	39(6.0)	0.01	0.94
6. 3 gota në ditë	15(5.9)	27(4.2)	0.7	0.39
7. 4 ose më shumë gota në ditë.	12(4.7)	39(6.1)		
Gjatë 7 ditëve të fundit, sa herë keni ngrënë mengjes?				
1. *0 ditë	75(29.4)	180(27.9)	0.08	0.78
2. 1 ditë	24(9.4)	66(10.2)	1.3	0.25
3. 2 ditë	39(15.3)	57(8.8)	0.7	0.39
4. 3 ditë	15(5.9)	21(3.3)	0.08	0.78
5. 4 ditë	12(4.7)	24(3.7)	1.4	0.24
6. 5 ditë	6(2.4)	36(5.6)	0.4	0.50

7. 6 ditë	3(1.2)	15(2.3)	0.5	0.47
8. 7 ditë	81(31.7)	246(38.2)		

Tabela Nr. 51 Lidhja midis Vendbanimit dhe Informacionit rreth Shëndetit

Pyetjet	Vendbanimi			
	Fshat (Nr%) 255 (28.3)	Qytet (Nr%) 645 (71.7)	Chi square	Vlera P
Informacionit rreth Shëndetit				
Ju kanë mesuar rreth SIDËS apo infeksionit nga HIV në shkollë?				
1. *Po	231(90.6)	573(88.8)		
2. Jo	21(8.2)	54(8.4)	0.01	0.94
3. Nuk jam i/e sigurt	3(1.2)	18(2.8)	0.7	0.4
Keni bërë ndonjë analizë për HIV, virusi që shkakton SIDËN?(mos përfshi rastin nëse e keni bërë kur keni dhuruar gjak)?				
1. *Po	27(10.5)	39(6.0)	1.9	0.16
2. Jo	210(82.4)	570(88.4)	0.2	0.62
3. Nuk jam i/e sigurt	18(7.1)	36(5.6)		
Kur jeni jashtë për më shumë se një orë në ditët me diell, përdorni kremra mbrojtës me SPF 15 apo më shumë ?				
1. *Asnjëherë	138(54.0)	345(53.5)	1.2	0.28
2. Rrallë	108(42.4)	243(37.7)	3.4	0.07
3. Shumicën e kohës	9(3.6)	57(8.8)	1.6	0.21
Në një ditë normale shkolle sa orë flini mesatarisht?				
1. *4 orë ose më pak	21(8.2)	108(16.7)	7.8	0.005
2. 5 orë	51(20.1)	63(9.8)	1.3	0.25
3. 6 orë	24(9.4)	63(9.8)	6.2	0.01
4. 7 orë	87(34.1)	141(21.9)	0.08	0.78
5. orë	45(17.6)	201(31.2)	2.3	0.13
6. orë	24(9.4)	51(7.9)	0.02	0.89
7. 10 orë ose më shumë	3(1.2)	18(2.7)		
Gjatë 12 muajve të fundit, keni folur me mësuesin/mësuesen apo ndonjë të rritur tjetër në shkollën tuaj për ndonjë problem tuaj që mund të keni patur ?				
1.*Po	168(65.9)	453(70.2)	0.5	0.46
2.Jo	87(34.1)	192(29.8)		

5. Diskutimi

5.1 Përmbledhja e Gjetjeve Kryesore të Studimit

1. Përqindja e subjekteve femra është 61.3%, ndërsa përqindja e subjekteve meshkuj është 38.7%.
2. Përqindja e subjekteve të moshës 16 vjeç ose më të vegjël është 30%, e subjekteve 17 vjeç është 34% dhe e subjekteve 18 vjeç ose më të mëdhenj është 36%.
3. 32% e subjekteve ndjekin klasën e 10-të; 21.3% ndjekin klasën e 11-të; 20% ndjekin klasën e 12-të dhe 26.7% janë në universitet.
4. Përqindja e subjekteve që janë me banim në qytet është 28.3% dhe e subjekteve që janë me banim në fshat është 71.7%.
5. Përqindja e subjekteve që nuk e përdorin kokoren kur lëvizin me biçikletë është 80% (asnjëherë) që e vendosin kokoren rrallë është 14%, që kanë ngarë makinën pasi kanë konsumuar alkool është 10% (të paktën një herë gjatë muajit të fundit e kanë drejtuar makinën pasi kanë pi alkool).
6. Përqindja e subjekteve që kanë mbajtur armë ndonjëherë në jetë është 18%. Përqindja e subjekteve që janë përfshirë në zënie fizike është 9%. Përqindja e subjekteve që janë detyruar të kryejnë marrëdhënie seksuale me dhunë është 8%.
7. Përqindja e subjekteve që kanë menduar ndonjëherë seriozisht vetëvrasjen është 11%. Përqindja e subjekteve që kanë bërë ndonjëherë plan për të kryer vetëvrasje është 12%. Përqindja e subjekteve që janë përpjekur të kryejnë vetëvrasje është 6%. Përqindja e subjekteve që gjatë vitit të fundit kanë tentuar të kryejnë vetëvrasje aq sa është dashur trajtim mjekësor është 8% .
8. Përqindja e subjekteve që kanë provuar ndonjëherë duhanin është 53%, e subjekteve që e kanë provuar duhanin 17 vjeç ose më të vegjël është 41%.
9. Përqindja e subjekteve që kanë provuar ndonjëherë alkoolin është 66%, e subjekteve që e kanë provuar alkoolin në moshën 16 vjeç është 69.2%.
10. Përqindja e subjekteve që kanë provuar marihuanën është 7%, që kanë përdorur marihuanë të paktën një ditë gjatë muajit të fundit është 7%. Përqindja e personave që kanë provuar kokainë është 4%, që kanë pi të paktën një ditë të muajit të fundit kokainë është 4%. Përqindja e personave që kanë përdorur heroinë është 3%. Përqindja e subjekteve që kanë përdorur metamfetaminë është 4%. Përqindja e subjekteve që kanë përdorur ekstazi është 4%. Përqindja e subjekteve që kanë përdorur pilula steroide pa recetën e mjekut është 5%. Përqindja e subjekteve që kanë përdorur një drogë të lejuar pa përkrahjen e mjekut është 4%. Përqindja e personave që kanë përdorur shiringë për të injektuar drogë të palejuar është 2.3%. Përqindja e subjekteve që iu është ofruar, shitur drogë në mjedise shkollore është 10%.
11. Përqindja e subjekteve që kanë patur raporte seksuale është 28%. Përqindja e subjekteve që kanë qenë 16 vjeç ose më të vegjël kur kanë patur raportin e parë seksual është 21%.

Përqindja e personave që kanë patur 1 ose më shumë partnerë seksualë është 13%. Përqindja e personave që kanë përdorur drogë ose alkool para marrëdhënies seksuale është 8%. Përqindja e subjekteve të cilët ata ose partnerët e tyre nuk kanë përdorur asnjë metodë për të parandaluar shtatzaninë gjatë marrëdhënies së fundit është 14%.

12. Përqindja e subjekteve që nuk kanë ngrënë për 24 orë ose më shumë gjatë muajit të fundit për të rënë në peshë është 17%. Përqindja e subjekteve që kanë përdorur pilula pa recetën e mjekut për rënie në peshë është 9%. Përqindja e subjekteve që kanë përdorur laksativë ose kanë vjellë gjatë muajit të fundit për të rënë në peshë është 6%.

13. Përqindja e subjekteve që kanë bërë 1 ditë ose më pak aktivitet fizik gjatë javës është 43%. Përqindja e subjekteve që luajnë videolojra për më shumë se 3 orë është 22%. Përqindja e subjekteve që shikojnë më shumë se 3 orë televizor në ditë është 37%. Përqindja e subjekteve që shikojnë në një ditë ose më pak në orët e aktivitetit fizik në shkollë gjatë javës së shkollës është 62%.

14. Përqindja e subjekteve që nuk kanë pi lëng të pastër frutash gjatë javës së fundit është 17%. Përqindja e subjekteve që nuk kanë ngrënë fare fruta është 7%. Përqindja e subjekteve që nuk kanë ngrënë fare perime është 8%. Përqindja e subjekteve që gjatë javës së fundit kanë pi më shumë se 4 herë pije si kola, pepsi është 41%. Përqindja e subjekteve që kanë pi më pak se 3 gota qumësht gjatë javës së fundit është 61%. Përqindja e subjekteve që kanë ngrënë mëngjes më pak se 4 herë gjatë javës së fundit është 52%.

15. Përqindja e subjekteve që nuk kanë mësuar rreth HIV në shkollë është 10%. Përqindja e subjekteve që nuk vendosin kremra mbrojtës kur dalin jashtë është 76%. Përqindja e subjekteve që flenë më pak se 7 orë ose më pak gjumë në ditë është 63%. Përqindja e subjekteve që nuk kanë folur me mësuesen për problemet që kanë patur është 70%.

16. Ekziston një diferencë statistikisht e rëndësishme (P value=0.001) midis moshës dhe vënies së kokores midis subjekteve, ku mosha 17 vjeçare (87.1%) nuk e vendosin asnjëherë kokoren.

17. Ekziston një diferencë statistikisht e rëndësishme (P value=0.001) midis moshës dhe vendosjes së rripit të sigurimit midis subjekteve, ku mosha 18 vjeç ose më e madhe e vendosin më rrallë rripin e sigurimit (57.4% e tyre e vendosin rrallë ose asnjëherë).

18. Ekziston një diferencë statistikisht e rëndësishme (P value=0.02) midis moshës dhe bërjes së një plani për vetëvrasje midis subjekteve, ku mosha 17 vjeç kanë përqindjen më të lartë.

19. Ekziston një diferencë statistikisht e rëndësishme (P value=0.01) midis moshës dhe se sa herë është tentuar vetëvrasja gjatë vitit të fundit midis subjekteve, ku numrin më të madh të herëve dhe përqindjen më të lartë e shfaqin mosha 17 vjeç.

20. Ekziston një diferencë statistikisht e rëndësishme (P value=0.001) midis moshës dhe nëse personat e kanë provuar duhanin (qoftë dhe një paf-puf) ku mosha më e lartë është ajo 18 vjeç ose më e madhe (36.1% e tyre e kanë provuar).

21. Ekziston një diferencë statistikisht e rëndësishme (P value=0.004) midis moshës dhe përdorimit të masave mbrojtëse parandaluese të shtatzanisë midis subjekteve, ku 17 dhe 18

vjeçarët i përdorin më pak (14.9% e 17 vjeçarëve dhe 15.7% e individëve 18 vjeç ose më të mëdhenj nuk përdorin ndonjë masë mbrojtëse).

22. Ekziston një diferencë statistikisht e rëndësishme (P value=0.03) midis moshës dhe nëse personat kishin ndenjur pa ngrënë për 24 orë ose më shumë për të rënë në peshë gjatë muajit të fundit midis subjekteve, ku mosha 16 vjeç ose më e vogël zënë përqindjen më të madhe (23.1% e tyre kanë ndenjur 24 orë ose më shumë pa ngrënë gjatë muajit të fundit për të rënë nga pesha).

23. Ekziston një diferencë statistikisht e rëndësishme (P value=0.03) midis përdorimit të pilulave për rënie në peshë pa përshkrimin e mjekut dhe moshës nga subjektet, ku mosha që i përdor më shumë është ajo 17 vjeç (5.9% e tyre kanë përdorur pilula për rënie në peshë pa përshkrimin e mjekut).

24. Ekziston një diferencë statistikisht e rëndësishme (P value=0.02) midis moshës dhe aktivitetit fizik nga subjektet ku më pak aktivë ishin mosha 18 vjeç ose më e madhe (40.7% e tyre janë aktivë 1 ose më pak ditë të javës).

25. Ekziston një diferencë statistikisht e rëndësishme (P value=0.001) midis moshës dhe shkuarjes në orët e aktivitetit fizik në shkollë nga subjektet, ku më pak shkojnë të rinjtë e moshave 18 vjeç ose më të mëdhenj (74.3% e tyre shkojnë 1 ose më pak ditë jave në orët e aktivitetit fizik).

26. Ekziston një diferencë statistikisht e rëndësishme (P value=0.005) midis moshës dhe përdorimit të lëngjeve të pastra të frutave nga subjektet, ku më pak përdorues janë mosha 17 vjeç (57.4% e tyre kanë pi më pak se 3 herë në javë lëng të pastër frutash).

27. Ekziston një diferencë statistikisht e rëndësishme (P value=0.01) midis moshës dhe konsumimit të frutave nga subjektet, ku më pak konsumues janë moshat 16 vjeç ose më e vogël (34.2% e tyre përdorin fruta më pak se 3 herë në javë).

28. Ekziston një diferencë statistikisht e rëndësishme (P value=0.001) ku mosha 16 vjeç ose më e vogël konsumojnë më pak qumësht se moshat e tjera (74.8% e tyre kanë pi më pak se 3 gota qumësht në ditë).

29. Ekziston një diferencë statistikisht e rëndësishme (P value=0.001) midis moshës dhe konsumimit të mëngjesit nga subjektet, ku mosha 16 vjeç ose më e vogël e konsumojnë mëngjesin më pak se moshat e tjera (64.9% e tyre kanë konsumuar mëngjes në më pak se 4 ditë të javës).

30. Ekziston një diferencë statistikisht e rëndësishme (P value=0.04) midis moshës dhe bërjes së analizave për HIV nga subjektet, ku mosha që i kanë kryer më shumë është ajo 18 vjeç ose më e madhe (13% e tyre kanë kryer analiza për HIV).

31. Ekziston një diferencë statistikisht e rëndësishme (P value=0.04) midis gjinisë dhe vënies së kokores nga subjektet, ku femrat e vendosin kokoren më pak se meshkujt, 80% e tyre nuk e vendosin asnjëherë kokoren.

32. Ekziston një diferencë statistikisht e rëndësishme (P value=0.02) midis moshës dhe drejtimit të makinës pas konsumimit të alkoolit nga subjektet, ku meshkujt zënë përqindjen më të madhe (2.7% e tyre kanë drejtuar makinën në më shumë se 1 herë gjatë muajit të fundit pasi kishin konsumuar alkool).
33. Ekziston një diferencë statistikisht e rëndësishme (P value=0.0001) midis gjinisë dhe mbajtjes së armëve nga subjektet, ku meshkujt zënë përqindjen më të madhe (40.5% e tyre kanë mbajtur armë).
34. Ekziston një diferencë statistikisht e rëndësishme (P value=0.001) midis gjinisë dhe përfshirjes së subjekteve në një konflikt ku është nevojitur ndihma mjekësore, ku meshkujt zënë përqindjen më të madhe (68.1% e meshkujve janë përfshirë në një zënkë ku është nevojitur trajtimi mjekësor).
35. Ekziston një diferencë statistikisht e rëndësishme (P value=0.0001) midis gjinisë dhe përfshirjes në një zënie në ambientin e shkollës nga subjektet, ku meshkujt zënë përqindjen më të madhe (19.8% e meshkujve janë përfshirë në një zënkë brenda ambienteve të shkollës).
36. Ekziston një diferencë statistikisht e rëndësishme (P value=0.00001) midis gjinisë dhe goditjes me shuplakë nga i/e dashuri/a ku meshkujt zënë përqindjen më të madhe (25.9% e meshkujve raportojnë të jenë goditur me shuplakë nga partnerja e tyre).
37. Ekziston një diferencë statistikisht e rëndësishme (P value=0.001) midis gjinisë dhe të menduarit seriozisht për të vrarë veten nga subjektet, ku meshkujt zënë përqindjen më të madhe (13.8% e meshkujve kanë menduar seriozisht për të vrarë veten).
38. Ekziston një diferencë statistikisht e rëndësishme (P value=0.02) midis gjinisë dhe bërjes së një plani për të vrarë veten nga ana e subjekteve, ku femrat zënë përqindjen më të madhe (15.8% e femrave kanë bërë plan se si mund të kryejnë vetëvrasje).
39. Ekziston një diferencë statistikisht e rëndësishme (P value=0.02) midis gjinisë dhe numrit të ditëve të muajit që subjektet kanë pi duhan, ku meshkujt zënë përqindjen më të lartë në më shumë ditë (46.6% e meshkujve kanë pi duhan për 1 ose më shumë ditë gjatë muajit të fundit).
40. Ekziston një diferencë statistikisht e rëndësishme (P value=0.001) midis gjinisë dhe të provuarit të alkoolit nga subjektet, ku meshkujt zënë përqindjen më të madhe (80.2% e meshkujve kanë provuar alkoolin).
41. Ekziston një diferencë statistikisht e rëndësishme (P value=0.02) midis gjinisë dhe numrit të herëve kur subjektet kanë përdorur marihuanë gjatë jetës ku përqindjen më të lartë për më shumë herë e zënë meshkujt (11.7% e meshkujve kanë përdorur marihuanë për 1 ose më shumë herë gjatë jetës).
42. Ekziston një diferencë statistikisht e rëndësishme (P value=0.01) midis gjinisë dhe numrit të herëve të përdorimit të heroinës nga subjektet, ku meshkujt zënë një përqindje më të madhe në më shumë numër herësh (6.9% e meshkujve kanë përdorur heroinë për 1 ose më shumë herë gjatë jetës).

43. Ekziston një diferencë statistikiisht e rëndësishme (P value=0.007) midis gjinisë dhe nëse personave iu është ofruar drogë e palejuar në një mjedis shkollor dhe përqindjen më të lartë e zënë meshkujt (13.9% e meshkujve iu është ofruar ose shitur drogë në një mjedis shkollor).

44. Ekziston një diferencë statistikiisht e rëndësishme (P value=0.001) midis gjinisë dhe nëse subjektet kanë patur raporte seksuale, ku përqindjen më të madhe e zënë meshkujt (61.2% e meshkujve kanë patur raporte seksuale).

45. Ekziston një diferencë statistikiisht e rëndësishme (P value=0.001) midis gjinisë dhe moshës së marrëdhënies së parë seksuale të subjekteve ku meshkujt kanë moshën më të vogël të marrëdhënies së parë seksuale krahasuar me femrat (61.2% e meshkujve kanë patur raporte seksuale në moshën më të vogël se 16 vjeç).

46. Ekziston një diferencë statistikiisht e rëndësishme (P value=0.001) midis gjinisë dhe numrit të partnerëve seksualë gjatë jetës, ku përqindjen më të lartë për më shumë se 1 partner, e zënë meshkujt (39.8% e meshkujve kanë patur më shumë se 1 partner gjatë jetës).

47. Ekziston një diferencë statistikiisht e rëndësishme (P value=0.001) midis gjinisë dhe nëse ata ose partneri/a kanë përdorur ndonjë metodë për të parandaluar shtatzani të padëshiruar, ku përqindjen më të lartë për përgjigje negative e zënë meshkujt (26.7% e meshkujve raportojnë se ata ose partnerët e tyre nuk kanë përdorur ndonjë metodë për parandalimin e një shtatzanie).

48. Ekziston një diferencë statistikiisht e rëndësishme (P value=0.04) midis gjinisë dhe nëse gjatë muajit të fundit subjektet kanë ndenjur 24 orë ose më shumë pa ngrënë për të rënë në peshë ku përqindjen më të lartë e zënë femrat (20.1% e femrave kanë qëndruar 24 orë ose më shumë pa ngrënë gjatë muajit të fundit për të rënë nga pesha).

49. Ekziston një diferencë statistikiisht e rëndësishme (P value=0.01) midis gjinisë dhe përdorimit të pilulave nga subjektet për dobësim pa përkrimin e mjekut, ku përqindjen më të lartë e zënë meshkujt (12.1% e meshkujve raportojnë se kanë përdorur pilula për dobësim pa përkrimin e mjekut).

50. Ekziston një diferencë statistikiisht e rëndësishme (P value=0.004) midis gjinisë dhe konsumimit të frutave nga subjektet, ku përqindjen më të ulët për përdorim e zënë meshkujt (43.9% e meshkujve kanë përdorur fruta më pak se 3 herë në javë).

51. Ekziston një diferencë statistikiisht e rëndësishme (P value=0.01) midis gjinisë dhe përdorimit të kremrave mbrojtës, ku meshkujt janë më pak përdorues (91.4% e tyre nuk përdorin asnjëherë kremra mbrojtës).

52. Ekziston një diferencë statistikiisht e rëndësishme (P value=0.02) midis vendbanimit dhe moshës kur subjektet kanë konsumuar disa gllënka alkool, ku për moshën 16 vjeç ose më të vogël, individët në qytet zënë përqindjen më të madhe (60.0% e subjekteve me banim në qytet kanë provuar alkoolin në moshën 16 vjeçare ose më të vegjël).

53. Ekziston një diferencë statistikiisht e rëndësishme (P value=0.05) midis vendbanimit dhe përdorimit të alkoolit ose drogës para marrëdhënies seksuale prej subjekteve, ku individët në

qytet zënë përqindjen më të madhe (15.8% e individëve me banim në qytet kishin përdorur alkool ose drogë para marrëdhënieve seksuale).

54. Ekziston një diferencë statistikisht e rëndësishme (P value=0.006) midis vendbanimit dhe qëndrimit për 5 orë ose më shumë në ditë në videoljërë ose në kompjuter të subjekteve, ku përqindjen më të lartë e zënë individët në qytet (15.3% e subjekteve me banim në qytet qëndrojnë në videoljërë ose në kompjuter për 5 orë ose më shumë në ditë).

55. Ekziston një diferencë statistikisht e rëndësishme (P value=0.001) midis vendbanimit dhe qëndrimit para televizorit, ku përqindjen më të lartë e zënë individët në qytet (41.8% e subjekteve me banim në qytet rrinë para televizorit për 3 orë ose më shumë në ditë).

5.2 Krahasimi i gjetjeve me literaturën

Krahasimi i gjetjeve të studimit tonë u realizua me studimin e bërë nga ISHP në 2009^{13,14} dhe nga studimi i bërë nga CDC në SH.B.A nëpërmjet YRBSS në 2013⁶³:

1. Përqindja e subjekteve femra është 61.3%, përqindja e subjekteve meshkuj është 38.7%.
2. Përqindja e subjekteve të moshës 16 vjeç ose më të vegjël është 30%, e subjekteve 17 vjeç është 34% dhe e subjekteve 18 vjeç ose më të mëdhenj është 36%.
3. 32% e subjekteve ndjekin klasën e 10-të; 21.3% ndjekin klasën e 11-të; 20% ndjekin klasën e 12-të dhe 26.7% janë në universitet.
4. Përqindja e subjekteve që janë me banim në qytet është 28.3% dhe e subjekteve që janë me banim në fshat është 71.7%.

5. Përdorimi i Masave mbrojtëse në rrugë;

Përdorimi i kokores; 80% e personave të përfshirë në studim raportojnë se nuk e përdorin kokoren; ku femrat kanë përqindjen më të lartë (80%) se sa meshkujt (78.5%). Përsa i përket moshës, mund të themi që 17 vjeçarët e përdorin më pak kokoren, asnjëherë(87.1%) dhe rrallë (12.9%). Krahasimi i këtyre rezultateve me studimin e bërë nëpërmjet YRBSS në SH.B.A. në vitin 2013 rezultoi se në SH.B.A 87.9% e të rinjve nuk përdornin kokore gjatë ngarjes së bicikletës, ku përqindjen më të madhe e zinin meshkujt (88.6%) në raport me femrat (87%). Ndërsa në studimin tonë përqindjen më të madhe e zënë femrat. Në lidhje me vendbanimin, përqindjen më të madhe e zënë të rinjtë në qytet në mospërdorimin e kokores.

Përdorimi i rripit të sigurimit: 57% e subjekteve raportuan se nuk e vendosin asnjëherë ose rrallë rripin e sigurimit; ku femrat kanë përqindjen më të lartë se sa meshkujt; 35.9% femra dhe 32.8% meshkuj. Ndërsa mosha 18 vjeç ose më e madhe e vendosin më rrallë rripin e sigurimit (86.1% e tyre e vendosin rrallë ose asnjëherë). Krahasuar kjo me studimin e bërë nëpërmjet YRBSS në SH.B.A. në 2013 rezultoi se 7.6% nuk e përdorin ose e përdornin rrallë rripin e sigurimit, ku përqindjen më të madhe e përbënin meshkujt (9.1%) se sa femrat (6.1%). Në studimin tonë femrat kanë përqindjen më të lartë të përdorimit rrallë të rripit të sigurimit. Në lidhje me vendbanimin, të rinjtë në fshat zënë përqindjen më të madhe në mospërdorimin e rripit të sigurimit.

Në lidhje me udhëtimin e të rinjve me një drejtues makinë që kishte konsumuar alkool, 34% raportuan se kishin udhëtuar me drejtues të tillë; ku meshkujt zënë përqindjen më

të lartë (48.2%) në raport me femrat (27.7%). E krahasuar kjo me studimin e bërë nëpërmjet YRBSS në SH.B.A. në 2013, përqindja e subjekteve që kishin udhëtuar me një drejtues makinë që kishte konsumuar alkool ishte 21.9% dhe kjo prevalencë ishte më e lartë tek femrat (24.8%) se sa tek meshkujt (18.9%). Ndërsa në kushtet e konsumimit të alkoolit, 9 % e tyre referuan se kishin drejtuar makinën në gjendje të tillë më shumë se 3 herë. Përsa i përket konsumimit të alkoolit më shumë se 3 herë, përqindjen më të lartë e zënë meshkujt (10.3%) se sa femrat (1.6%). Krahasuar me studimin e bërë nëpërmjet YRBSS në SH.B.A. në 2013, prevalenca e drejtimit të makinës pasi kishin konsumuar alkool ishte më e lartë tek meshkujt (12.0%) se sa tek femrat (7.8%). Pra ka ngjashmëri në drejtimin e makinës pasi kanë konsumuar alkool, ku meshkujt zënë përqindjen më të lartë. Në lidhje me vendbanimin, përqindjen më të lartë e zënë të rinjtë në qytet.

6. Dhuna tek të rinjtë. Përqindja e subjekteve që kanë mbajtur armë ndonjëherë në jetë është 18%. Meshkujt zënë përqindjen më të lartë (40.5%) se sa femrat (4.9%). Përqindja e subjekteve që janë përfshirë në zënie fizike është 9%; ku meshkujt zënë përqindjen më të lartë (68.1%) se sa femrat (18.5%). Përqindja e subjekteve që janë ndeshur fizikisht në ambientet e shkollës është 17%; ku meshkujt zënë përqindjen më të lartë (19.8%) se sa femrat (1.6%). Ndërsa 6% e subjekteve janë goditur ose dëmtuar fizikisht nga partneri/partnerja, ku meshkujt zënë përqindjen më të lartë (25.9%) se sa femrat (10.8%). 8% e subjekteve raportojnë se janë detyruar të kryejnë marrëdhënie seksuale me dhunë. Krahasuar me studimin e bërë nëpërmjet YRBSS në SHBA në 2013 rezultoi se prevalenca e mbajtjes së armëve ishte më e lartë tek meshkujt (28.1%) sesa tek femrat (7.9%), përfshirja në zënie fizike ishte më e lartë tek meshkujt (30.2%) se sa tek femrat (19.2%), zënie në ambiente shkolle ishte më e lartë tek meshkujt (10.7%) se sa tek femrat (5.6%). Prevalenca e dhunës seksuale ishte më e lartë tek femrat (14.4%) se sa tek meshkujt (6.2%). Pra ka ngjashmëri përsa i përket dhunës tek të rinjtë ku përqindjen më të madhe e zënë meshkujt se sa femrat. Në lidhje me vendbanimin, përqindjen më të lartë e zënë të rinjtë në qytet.
7. Vetëvrasje: Përqindja e subjekteve që kanë menduar ndonjëherë seriozisht vetëvrasjen është 11%, ku përqindjen më të madhe e zënë moshë 17 vjeç (18.8%) dhe më shumë janë meshkujt (13.8%) se sa femrat (2.7%), ndërsa në studimin e bërë nga ISHP në 2009, 7.4% e nxënësve të shkollave të mesme kishin menduar seriozisht për të kryer vetëvrasje, pra shihet se ka një tendencë rritjeje. Ndërsa ka ndryshim në raport me studimin e bërë nëpërmjet YRBSS në SH.B.A. në 2013, ku prevalenca e të menduarit seriozisht për të bërë vetëvrasje ishte më e lartë tek femrat (22.4%) se sa tek meshkujt (11.6%).

Përqindja e subjekteve që kanë bërë ndonjëherë plan për të kryer vetëvrasje është 11%, moshë me përqindjen më të lartë është ajo 17 vjeç (19.8%), ndërsa femrat (15.8%) zënë përqindjen më të lartë se sa meshkujt (6.9%). Në studimin e bërë nga ISHP, në 2009, përqindja e planifikimit ndonjëherë për të kryer vetëvrasje gjatë vitit të fundit ishte 6%. Ndërsa midis meshkujve dhe femrave ishte përkatësisht 4.8% dhe 6.8%. Në studimin e bërë nëpërmjet YRBSS në SH.B.A. në 2013, prevalenca e të bërit plan për vetëvrasje ishte më e lartë tek femrat (16.9%) se sa tek meshkujt (10.3%). Pra ka ngjashmëri për sa i përket gjinisë ku përqindjen më të madhe e zënë femrat.

Prevalenca e subjekteve që janë përpjekur të kryejnë vetëvrasje është 6%, përqindjen më të madhe e zënë femrat (13.5%) se sa meshkujt (12.9%), pa ndonjë ndryshim sinjifikant. Në studimin e bërë nga ISHP në 2009, prevalenca e të provuarit të kryerjes së vetëvrasjes nuk kishte ndonjë ndryshim sinjifikant midis meshkujve dhe femrave

përkatësisht 2% dhe 5.4%. Pra në ngjashmëri me studimin tonë. Në studimin e bërë nëpërmjet YRBSS në SH.B.A. në 2013, prevalenca e subjekteve që ishin përpjekur të kryejnë vetëvrasje ishte më e lartë tek femrat (10.6%) se sa tek meshkujt (5.4%).

Përqindja e subjekteve që kanë provuar të paktën 1 herë gjatë vitit të fundit për të kryer vetëvrasje është 9%, ku përqindjen më të madhe e zënë moshë 17 vjeç (14.4%). Në studimin e bërë nga ISHP në 2009, 4% e nxënësve të shkollave të mesme kishin provuar të kryenin vetëvrasje një ose më shumë herë. Pra në studimin tonë ka një rritje të prevalencës së numrit të herëve për të provuar vetëvrasje.

Përqindja e subjekteve që gjatë vitit të fundit kanë tentuar të kryejnë vetëvrasje aq sa është dashur trajtim mjekësor është 8%.

8. Duhanpirja; Përqindja e subjekteve që kanë provuar ndonjëherë duhanin është 63%. Në studimin e bërë nga ISHP në 2009, prevalenca e nxënësve të shkollave të mesme që kishin pi ndonjëherë duhan ishte 59.1%. Pra ka një rritje të përqindjes së fillimit të duhanpirjes në studimin tonë krahasuar me atë të studimit të ISHP në 2009 . Në lidhjen midis moshës dhe duhanpirjes nëse personat e kanë provuar ndonjëherë gjatë jetës duhanin, moshë me përqindjen më të lartë është ajo 18 vjeç ose më e madhe; në lidhjen midis moshës dhe fillimit të duhanit, moshë 17 vjeç raportojnë një përqindje më të lartë të fillimit të duhanit. Ndërkohë në lidhjen midis gjinisë dhe moshës në të cilën personat kanë nisur duhanin, moshë 16 vjeç është moshë ku meshkujt zënë përqindjen më të madhe; numrit të ditëve të muajit të fundit në të cilat personat kanë pi duhan, ku meshkujt zënë përqindjen më të madhe; mënyrës së sigurimit të cigareve, ku përqindjen më të lartë e zënë meshkujt, numrit të ditëve në të cilat personat kanë pi duhan në ambiente shkollore gjatë muajit të fundit, ku meshkujt zënë përqindjen më të madhe; faktit nëse personat kanë tentuar të lënë duhanin gjatë vitit të fundit, ku meshkujt zënë përqindjen më të lartë (29.3%) se sa femrat (7.1%). Në studimin e bërë nëpërmjet YRBSS, prevalenca e konsumit të duhanit për herë të parë ishte më e madhe tek meshkujt (42.5%) se sa tek femrat (39.6%). Gjithashtu fillimi i duhanit në moshë të vogël (13 vjeç) ishte më i lartë tek meshkujt se tek femrat. Ndërsa prevalenca e tentativës për të lënë duhanin ishte më e lartë tek femrat (51.0%) se tek meshkujt (45.4%). Pra ka një ndryshim në tentativën për të lënë duhanin ku në studimin tonë përqindjen më të madhe e zënë meshkujt.
9. Përdorimi i alkoolit; Përqindja e subjekteve që kanë provuar ndonjëherë alkoolin është 66%, meshkujt (80.2 %) zënë përqindjen më të madhe se sa femrat (60.9). Në studimin e bërë nga ISHP, prevalenca e përdorimit të alkoolit gjatë jetës ishte më e lartë tek meshkujt se sa tek femrat, përkatësisht 79.3% dhe 65.1%. Në studimin e bërë nëpërmjet YRBSS, prevalenca e konsumimit të alkoolit ishte më e lartë tek meshkujt (42.1%) se sa tek femrat (39.2%). Pra ka ngjashmëri përse i përket raportit të meshkujve dhe femrave si në studimi tonë edhe në studimet të bërë nga ISHP dhe nëpërmjet YRBSS. Ndërkohë në lidhjen midis vendbanimit dhe përdorimit të alkoolit ose drogës para marrëdhënieve seksuale, individët në qytet zënë përqindjen më të madhe; 15.8% e individëve me banim në qytet kanë përdorur alkool ose drogë para marrëdhënieve seksuale.

10. Përdorimi i Drogave: Përqindja e subjekteve që kanë provuar marihuanën është 7%. Në studimin e bërë nga ISHP, përqindja e të rinjtë të shkollave të mesme që kishin përdorur gjatë gjithë jetës së tyre është 7,4 %. Pra ka ngjashmëri në prevalencën e përdorimit të marihuanës. Në studimin e bërë nëpërmjet YRBSS, 8.6% kishin provuar marihuanën. Pra ka ndryshim më të lartë në raport me studimin tonë.

Përqindja e personave që kanë provuar kokainë është 4%, në studimin e bërë nga ISHP-së në 2009, prevalenca e të rinjve që kishin përdorur kokainë ishte 3.2%. Në studimin e bërë nëpërmjet YRBSS, prevalenca e të rinjve që kishin përdorur kokainë ishte 5.5%. Pra shihet një rritje e prevalencës në raport me studimin e ISHP, por një prevalencë më të ulët në raport me studimin e bërë nëpërmjet YRBSS .

Përqindja e të rinjve që kanë përdorur shiringë për të injektuar një drogë të palejuar është 2.3%. Në studimin e bërë nga ISHP në 2009 përqindja e të rinjve që kishin përdorur drogë me injektim ishte 1,2 %. Në studimin e bërë nëpërmjet YRBSS, 1.7% e subjekteve kishin përdorur shiringë për injektim droge. Pra vihet re një përqindje më e lartë e përdorimit të drogës me injektim në studimin tonë.

Përqindja e të rinjve që iu është ofruar, shitur drogë në mjedise shkollore është 10%. Në studimin e bërë nga ISHP, 8 % e subjekteve iu ishte ofruar ose dhënë drogë në mjediset e shkollës. Në studimin e bërë nëpërmjet YRBSS, 22.1% e subjekteve iu ishte ofruar drogë në ambjente shkolle. Pra shihet një përqindje më e lartë e studimit tonë në raport me atë të ISHP, por më e ulët se ajo e studimit të bërë nëpërmjet YRBSS në 2013.

11. Sjelljet seksuale; përqindja e subjekteve që kanë patur raporte seksuale është 28%, ku përqindjen më të madhe e zënë meshkujt (61.2%).

Në studimin e bërë nga ISHP, 25.9% e të rinjve të shkollave të mesme kishin kryer marrëdhënie seksuale dhe shihet prevalencë më e lartë tek meshkujt që kishin kryer marrëdhënie seksuale, rreth 50 % e meshkujve ndërsa femrat vetëm 9,4 % e tyre kishin kryer marrëdhënie seksuale. Në studimin e bërë nëpërmjet YRBSS, përqindja e subjekteve që kishin patur raporte seksuale ishte 46.8%. Pra në studimin tonë shihet një rritje e përqindjes së subjekteve që kishin patur ndonjëherë marrëdhënie seksuale në krahasim me studimin e bërë nga ISHP, por që është më i ulët se përqindja e studimit të bërë nëpërmjet YRBSS.

Përqindja e personave që kanë patur më shumë se 1 partner seksual është 13%, ku përqindjen më të lartë për më shumë se 1 partner e zënë meshkujt (39.8%). Në studimin e bërë nga ISHP, 25 % e subjekteve kishin kryer marrëdhënie me më shumë se 1 partner. Përqindja e subjekteve që kishin patur raporte seksuale me më shumë se një person ishte 15.0%. Prevalenca ishte më e lartë tek meshkujt (16.8%) se sa tek femrat (13.2%). Shihet që prevalenca e studimit tonë është më e ulët se sa ajo e studimit të bërë nga ISHP,por më e lartë se sa ajo e studimit të bërë nëpërmjet YRBSS.

Përqindja e personave që kanë përdorur drogë ose alkool para marrëdhënies seksuale është 8%. Ndërsa në studimin e bërë nga ISHP, marrëdhënie seksuale nën efektin e drogës rezultojnë të kishin kryer 3,4 % e subjekteve. Në studimin e bërë nëpërmjet YRBSS, 22.4% e subjekteve kishin përdorur alkool apo drogë përpara aktivitetit të fundit seksual. Pra shihet një përqindje e lartë e subjekteve që kishin përdorur drogë

apo alkool para marrëdhënies seksuale në studimin tonë në raport me studimin e ISHP, po një përqindje më e ulët se ajo e studimit të bërë nëpërmjet YRBSS.

Përqindja e subjekteve të cilët ata, ose partnerët e tyre nuk kanë përdorur asnjë metodë për të parandaluar shtatzaninë gjatë marrëdhënies së fundit është 14%, ndërsa në lidhje me moshën, subjektet 17 vjeç dhe 18 vjeç i përdorin më pak (14.9% e 17 vjeçarëve dhe 15.7% e individëve 18 vjeç ose më të mëdhenj nuk përdorin ndonjë masë mbrojtëse). Ndërsa për sa i përket raportit meshkuj-femra, përqindjen më të lartë për përgjigje negative e zënë meshkujt (26.7% e meshkujve raportojnë se ata ose partnerët e tyre nuk kanë përdorur ndonjë metodë për parandalimin e një shtatzanie). Në studimin e bërë nëpërmjet YRBSS 13.7% e subjekteve raportuan se nuk kishin përdorur asnjë metode mbrojtëse për të parandaluar një shtatzani gjatë aktivitetit të fundit seksual. Pra shihet një përqindje e afërt e mospërdorimit të metodave mbrojtëse për të parandaluar një shtazani në studimin tonë dhe në studimin e bërë nëpërmjet YRBSS.

12. Mbipësia dhe obeziteti; përqindja e subjekteve që janë mbi peshë është 20 %, 50% janë në peshën e duhur, 20% janë mbi peshë dhe 10 % janë obezë. Ndërsa përqindja e femrave që përshkruajnë veten si mbipeshë (10.8%) dhe obezë (3.8%) është më e lartë se tek meshkujt përkatësisht (6.9%) dhe (1.7%). Në studimin e bërë nga ISHP në 2009, midis nxënësve të shkollave të mesme 23.7% e tyre e përshkruanin veten e tyre si pak mbi peshë ose shumë mbi peshë. Në studimin e bërë nëpërmjet YRBSS në 2013, 13.7% e subjekteve ishin obezë. Prevalenca e obezitetit ishte më e lartë tek meshkujt (16.6%) se sa tek femrat (10.8%). 31.1% e subjekteve e përshkruanin veten si mbipeshë. Prevalenca e subjekteve që përshkruanin veten mbipeshë ishte më e lartë tek femrat (36.3%) se sa tek meshkujt (25.9%). Prevalenca e mbipeshës ishte më e lartë tek meshkujt (16.9%) se tek femrat (14.3%). Prevalenca e subjekteve të cilët e përshkruanin veten e tyre si pak mbi peshë ose shumë mbi peshë ishte shumë herë më e lartë tek femrat (30.6%) se sa tek meshkujt (13.9%). Pra shihet që ndryshimi në përshkrimin e peshës trupore është më i lartë tek femrat se sa tek meshkujt, si në studimin tonë ashtu edhe në atë të ISHP si dhe në studimin e bërë nëpërmjet YRBSS. Ndërsa përqindja e subjekteve obezë (10%) është më e ulët në studimin tonë në krahasim me atë të bërë nëpërmjet YRBSS (13.7%).

17% e subjekteve kanë qëndruar 24 orë ose më shumë pa konsumuar asgjë gjatë muajit të fundit, krahasuar kjo me studimin e bërë nga ISHP në 2009, 18.3% e subjekteve kishin ndenjur pa ngrënë. Ndërsa sipas studimit të bërë nëpërmjet YRBSS, prevalenca e përpjekjes për të rënë nga pesha, duke qëndruar pa ngrënë për më shumë se 24 orë ishte 13.0%; prevalenca ishte më e lartë tek femrat (18.7%) se sa tek meshkujt (7.4%). Pra shihet se përqindja e subjekteve që kishin qëndruar 24 orë ose më shumë pa konsumuar është më e lartë se ajo e studimit të bërë nëpërmjet YRBSS por më e ulët se përqindja e subjekteve në studimin e bërë nga ISHP.

9% e subjekteve kanë përdorur pilula ose lëngje pa përshkrim nga mjeku për të rënë në peshë ose për të mos shtuar në peshë. Në studimin e bërë nga ISHP, përqindja e subjekteve që kishin marrë pilula dietetike ose lëngje për të rënë ose mos shtuar në peshë pa u këshilluar me mjekun ishte më e ulët respektivisht 2.7%.

6% e subjekteve kanë përdorur laksativë ose kanë vjellë në mënyrë të qëllimshme për të rënë nga pesha. Në studimin e bërë nga YRBSS, 4.4% e subjekteve kishin provokuar të vjellën ose kishin përdorur laksativë që të ruanin apo të binin nga pesha gjatë 30 ditëve. Prevalenca ishte më e madhe tek femrat (6.6%) se sa tek meshkujt (2.2%). Pra shihet që ka një prevalencë më të lartë të femrave në raport me meshkujt për të përdorur metoda për të ruajtur peshën apo për të rënë nga pesha.

13. Aktiviteti fizik; 13% e subjekteve raportojnë se nuk kryejnë asnjë ditë të javës aktivitet fizik. Përqindja e femrave është më e lartë (15.8%) se sa e meshkujve (6.9). Në studimin e bërë nëpërmjet YRBSS, 15.2% e subjekteve nuk kishin marrë pjesë të paktën një ditë në javë në një aktivitet fizik, dhe prevalenca ishte më e lartë tek femrat (19.2%) se sa tek meshkujt (16.1%). Pra shihet se në studimin tonë përqindja e subjekteve që nuk bëjnë aktivitet fizik është më e ulët, por ka ngjashmëri përsa i përket prevalencës më të lartë tek femrat. 22% e subjekteve luajnë videolojra ose e përdorin kompjuterin për punë jashtë shkolle 3 orë ose më shumë në ditë. Në studimin e bërë nëpërmjet YRBSS, 41.3% e studentëve kishin luajtur me videolojra dhe kompjuter për punë jashtë shkolle për 3 ose më shumë orë në ditë gjatë ditëve të shkollës. Shihet një përqindje më e ulët në studimin tonë. Në lidhjen midis vendbanimit dhe qëndrimit për 5 orë ose më shumë në ditë në videolojra ose në kompjuter, përqindjen më të lartë e zënë individët në qytet (15.3% e subjekteve me banim në qytet qëndrojnë në videolojra ose në kompjuter për 5 orë ose më shumë në ditë).

37% e subjekteve shohin televizor 3 orë ose më shumë në ditë. Në studimin e bërë nga ISHP në 2009, mesatarisht gjatë një ditë të zakonshme shkolle 47.1% e nxënësve të shkollave të mesme kishin parë 3 ose më shumë orë televizor në ditë. Në studimin e bërë nëpërmjet YRBSS, 32.5% e studentëve kishin parë televizor 3 ose më shumë orë në ditë gjatë ditëve të shkollës. Pra shihet një përqindje më e ulët në studimin tonë, krahasuar me atë të bërë nga ISHP, por më e lartë se ajo e bërë nëpërmjet YRBSS. Në lidhjen midis vendbanimit dhe qëndrimit para televizorit, përqindjen më të lartë e zënë individët në qytet (41.8% e subjekteve me banim në qytet rrinë para televizorit për 3 orë ose më shumë në ditë).

36% e subjekteve nuk shkojnë në asnjë orë të aktivitetit fizik në shkollë, ndërsa 64% shkojnë 1 ose më shumë orë gjatë javës. Në studimin e bërë nga ISHP, mesatarisht gjatë një jave shkolle 79.5% e nxënësve kishin frekuentuar lëndën e edukimit fizik në një ose më shumë ditë. Në studimin e bërë nëpërmjet YRBSS, 48.0% e studentëve kishin ndjekur orët e edukimit fizik për një ose më shumë ditë në javë. Prevalenca ishte më e lartë tek meshkujt (53.3%) se sa tek femrat (42.8%). Pra në studimin tonë shihet një përqindje e lartë e të rinjve që nuk shkojnë në orët e edukimit fizik.

14. Mënyra e Ushqyerjes; 17% e subjekteve nuk kanë pi asnjëherë lëng të pastër frutash gjatë javës së fundit, dhe 7% e tyre nuk kanë ngrënë asnjëherë fruta gjatë javës së fundit. Ndërsa në lidhje me moshën, moshë 16 vjeç ose më e vogël kanë përqindjen më të lartë në një numër më të vogël ditësh të konsumit të frutave dhe lëngjeve të frutave. Në studimin e bërë nëpërmjet YRBSS, 37.4% nuk kishin ngrënë fruta apo pirë lëng frutash një ose disa herë gjatë javës. Në studimin tonë vihet re një përqindje më e ulët e moskonsumimit të frutave dhe lëngjeve të frutave.

Në studimin tonë 22% e të rinjve nuk kanë konsumuar asnjëherë sallatë jeshile dhe perime. Në studimin e bërë nëpërmjet YRBSS, 6.6% e subjekteve nuk kishin konsumuar perime gjatë javës së fundit. Prevalenca ishte më e lartë midis meshkujve (7.5%) se sa midis femrave (5.7%). Pra shihet një përqindje më e lartë në studimin tonë e të rinjve të cilët nuk konsumojnë perime.

Në studimin tonë, 37% nuk kanë pi qumësht gjatë javës së fundit. Ndërsa në lidhje me moshën dhe mënyrën e ushqyerjes, moshën 18 vjeç ose më të madhe kanë përqindjen më të lartë për më pak ditë gjatë të cilave konsumojnë qumësht. Në studimin e bërë nëpërmjet YRBSS, 19.4% e subjekteve nuk kishin pi qumësht gjatë javës së fundit. Prevalenca ishte më e lartë tek femrat (25.4%) se sa tek meshkujt (13.2%). Në studimin tonë shihet një prevalencë më e lartë e të rinjve të cilët nuk konsumojnë qumësht.

Në studimin tonë, 27% e subjekteve nuk kanë ngrënë mëngjes gjatë javës së fundit. Në studimin e bërë nëpërmjet YRBSS, 13.7% e subjekteve nuk kishin ngrënë mëngjes gjatë javës së fundit. Pra shihet një përqindje më e lartë në studimin tonë e subjekteve të cilët nuk kishin konsumuar mëngjes gjatë javës së fundit.

Në studimin tonë 17% e subjekteve nuk kanë pi lëngje të tilla si pepsi, kola. Në studimin e bërë nëpërmjet YRBSS, 22.3% e subjekteve nuk kishin pi soda, kola, gjatë javës së fundit. Pra shihet një përqindje më e ulët e subjekteve në studimin tonë.

15. Informacioni rreth Shëndetit; 90% e subjekteve raportojnë se kanë mësuar rreth SIDËS ose infeksionit HIV në shkollë. Në studimin e bërë nga ISHP, lidhur me njohuritë e marra në shkollë për HIV dhe SIDËN, 89% e nxënësve raportuan që kishin mësuar në shkollë për to. Në studimin e bërë nëpërmjet YRBSS, 85.3 % e subjekteve kishin mësuar në shkollë rreth SIDËS ose infeksionit HIV. Shihet një përqindje pak më e lartë e subjekteve në studimin tonë rreth njohurive të marra në shkollë rreth SIDËS ose infeksionit HIV.

86% nuk kanë bërë analizë për HIV/SIDËN asnjëherë gjatë jetës. Në studimin e bërë nëpërmjet YRBSS, 87.1% e studentëve nuk ishin testuar për HIV, duke mos përfshirë testimin e bërë gjatë dhurimit të gjakut. Në studimin tonë vihet re një përqindje më e ulët e subjekteve që nuk kanë bërë analizë për HIV/SIDËN.

Në studimin tonë 36% e subjekteve raportojnë se flenë 8 orë ose më shumë në ditët normale të shkollës. Në studimin e bërë nëpërmjet YRBSS, 31.7% e subjekteve kishin fjetur 8 ose më shumë orë gjatë një natë normale. Pra shihet një përqindje më e lartë në studimin tonë .

70% e subjekteve raportuan se nuk kanë folur me mësuesin/mësuesen për ndonjë problem që mund të kishin pasur.

6. Përfundime

Në përgjithësi, studimi ynë mbi prevalencën e sjelljeve në risk tek të rinjtë në qarkun e Elbasanit ofroi një panoramë të hollësishme lidhur me këtë çështje.

Studimi ynë është një ndër studimet e pakta që janë kryer në Qarkun e Elbasanit. Ai jep informacion në lidhje me sjelljet në risk për të rinjtë e këtij qarku. Është studiuar prevalenca e sjelljeve në risk në tërësi, si dhe lidhja e tyre me karakteristika të tilla, si moshë, gjinia dhe venbanimi. Të dhënat e studimit tonë ishin të krahasueshme me ato të studimit të bërë nga ISHP në 2009 dhe nga studimi i bërë nëpërmjet YRBSS në 2013 në SH.B.A.

- Sjelljet vetëdëmtuese; përdorimi i masave mbrojtëse në rrugë; pjesa më e madhe e subjekteve raportuan se nuk përdorin mjete mbrojtëse si kokorja në ngarjen e biçikletës apo rripi i sigurimit në drejtimin e makinës. Sa më e madhe të ishte moshë aq më tepër rritej abuzimi. Kjo mund të ndikojë në rritjen e numrit të aksidenteve. Femrat kanë përqindjen më të lartë në mos mbajtjen e masave mbrojtëse si kokorja, ndërsa meshkujt zënë përqindjen më të lartë në mospërdorimin e rripit të sigurimit të makinës. Ndërsa meshkujt që kanë drejtuar makinën kur kishin konsumuar alkool janë më të shumtë në raport me femrat, përqindjen më të madhe e zënë të rinjtë në qytet.

Dhuna; një pjesë e të rinjve raportuan se kanë mbajtur armë dhe janë konfrontuar fizikisht me njëri-tjetrin, ku pjesën më të madhe e përbënin meshkujt sesa femrat.

Vetëvrasja; një pjesë e të rinjve raportuan se kanë menduar për të vrarë veten, ku përqindjen më të lartë e zinin meshkujt. Ndërsa kanë bërë plan dhe kanë tentuar të vetvriten, predominojnë femrat në raport me meshkujt, (si tek femrat edhe tek meshkujt predominon më shumë moshë 17 vjeç). Përqindjen më të madhe e zënë të rinjtë në qytet.

- Konsumimi i duhanit dhe i alkoolit u raportua në mbi gjysmën e të rinjve. Një përqindje e konsiderueshme e kanë filluar në moshë më të vogël se 16 vjeç. Ato e kanë blerë vetë dhe e kanë konsumuar në ambjentet e shkollës. Përqindjen më të madhe e zënë meshkujt në raport me femrat. Përqindjen më të madhe e zënë të rinjtë në qytet.
- Përdorimi i drogave u raportua më tepër tek djemtë se sa tek vajzat dhe një pjesë raportuan se u është ofruar drogë në ambjente shkolle. Përqindjen më të madhe e zënë të rinjtë në qytet.
- Në lidhje me sjelljet seksuale, të rinjtë raportuan se kanë patur raporte seksuale për herë të parë në moshën 16 vjeçare ose më të vegjël, dhe një pjesë e tyre, kryesisht djemtë nuk përdorin metoda kontrceptive me rritjen e moshës. Përqindjen më të madhe e zënë të rinjtë në qytet. Ndërkohë të rinjtë e moshës 17 vjeç kanë një përqindje më të lartë të marrëdhënieve seksuale në moshë të vogël.
- Obeziteti dhe mbipesha. Të rinjtë raportuan se një pjesë e tyre kanë përdorur një metodë për të rënë nga pesha. Një pjesë e tyre bëjnë aktivitet fizik të paktën 2-3 herë në javë. Këtu predominojnë më shumë meshkujt, ndërsa femrat janë të prirura të

raportojnë më tepër peshë normale. Gjithashtu me rritjen e moshës ulet edhe numri i herëve që të rinjtë bëjnë aktivitet fizik. Në lidhje me orët e harxhuara para televizorit gjatë ditëve të shkollës, më shumë se gjysma e të rinjve harxhojnë të paktën një orë në ditë në televizor, kompjuter dhe videolojra ku përqindjen më të madhe e zënë të rinjtë në qytet.

- Mënyra e Ushqyerjes. Pjesa më e madhe e të rinjve raportuan se kanë ngrënë më pak se dy herë mëngjes në javë. Shumica e tyre konsumonin më tepër produkte të paketuara dhe më pak produkte të freskëta. Përqindjen më të madhe e zënë të rinjtë në qytet.
- Informacioni rreth shëndetit; pjesa më e madhe e të rinjve nuk kanë bërë asnjëherë analiza me dëshirë për kontroll rutinë. Pjesa më e madhe e tyre nuk flasin me të rriturit për ndonjë problem të tyre. Gjithashtu një pjesë e konsiderueshme flenë pak orë gjumi gjatë natës. Përqindjen më të madhe e zënë të rinjtë në qytet.

Të gjitha këto të dhëna tregojnë se sjelljet në risk tek të rinjtë në Qarkun e Elbasanit janë në rritje dhe në ndryshim të vazhdueshëm, si dhe të krahasueshme me studime të tjera të kësaj natyre të realizuara në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

7. Rekomandime

Bazuar në gjetjet dhe konkluzionet e këtij studimi janë formuluar rekomandimet e mëposhtme:

- Duke parë rëndësinë dhe ndikimin që kanë sjelljet riskante në shëndetin dhe jetën e të rinjve, kërkohet si përparësi promovimi i tyre nga të gjithë aktorët e shoqërisë, përfshirë këtu sistemin shëndetësor, bashkëmoshatarët, familjen, shkollën dhe komunitetin.
- Promocioni i Shëndetit duhet të konsiderohet si një investim i vlefshëm me një impakt të dallueshëm mbi shëndetin e të rinjve. Nga ky këndvështrim, edukimi dhe promocioni shëndetësor si dhe strategjitë e komunikimit për ndryshimin e sjelljeve mbi çështje të tilla si sjelljet riskante, duhet të jenë pjesë të rëndësishme të gjithë programeve të Shëndetit publik që implementohen për të rinjtë.
- Strategjitë e komunikimit duhet të përqëndrohen në dhënien e informacioneve të sakta dhe të adresojnë dhe promovojnë problematikat e të rinjve mbi sjelljet në risk.
- Promovimi i sjelljeve në risk duhet të jetë një tjetër fokus i rëndësishëm i punës edukativo-shëndetësore. Hartimi i materialeve të ndryshme informuese për të rinjtë lidhur me sjelljet në risk duhet të jetë i standartizuar dhe i unifikuar. Ato duhet të jenë të hartuara nga profesionistët e fushës.
- Rekomandohet rifreskimi periodik i informacionit ekzistues të kurrikulave shkollore si dhe sigurimi i trajnimit të vazhdueshëm të mësuesve që merren me edukimin shëndetsor të të rinjve.
- Edukimi dhe promocioni shëndetsor mbi shëndetin e të rinjve dhe sjelljeve që ndikojnë në to duhet të jetë pjesë integrale e çdo hallke të shërbimit shëndetsor.
- Qendrat aktuale të këshillimit dhe shoqatat rinore duhet ta orientojnë punën e tyre drejt të qenit miqësor me të rinjtë, që t'u shërbejnë më mirë me programet dhe mundësitë që ato kanë.
- Ndërtimi i kapaciteteve njerëzore si në stafin e mësuesve dhe atë shëndetsor, me qëllim realizimin e programeve të ndryshme për promovimin e sjelljeve të shëndetshme që ndikojnë tek të rinjtë dhe tek e ardhmja e tyre.
- Përfshirja e bashkëmoshatarëve, prindërve dhe komuniteteve nëpërmjet implementimit të programeve të ndryshme në komunitet, duhet konsideruar si një nga strategjitë më të sukseshme në krijimin e mjediseve mbështetëse për të rinjtë.
- Një tjetër strategji që duhet konsideruar është edukimi i politikbërësve dhe vendimarrësve në nivel rajonal apo kombëtar në mbështetjen e këtij grupi nëpërmjet hapjes së shërbimeve të ndryshme multidisiplinare.
- Për një përgjigje multisektoriale komunikimi me median dhe mediat e ndryshme sociale duhet të ndërtohet në mënyrë që të jenë mbështetëse.

- Kur zgjedhim kanalet e komunikimit për dhënien e mesazheve, është e rëndësishme të kemi parasysh se cila media është më efektive dhe përdor gjuhën më të mirë.
- Ndërtimi dhe forcimi i kapaciteve të mediave lokale është gjithashtu mjaft i nevojshëm në dhënien e mesazheve të ndryshme për këtë grup të popullatës.
- Është i nevojshëm realizimi periodik i studimeve të kësaj natyre për të parë trendet si dhe për të vlerësuar progresin e bërë.

8. Referencat

1. <http://www.unesco.org/new/en/social-and-human-sciences/themes/youth/youth-definition/>
2. Robert Wardinger. Psikiatria.Historia Sociale dhe e Zhvillimit,fq48.
3. <http://www.cdc.gov/healthyyouth/>
4. <http://www.cdc.gov/healthyyouth/protective/index.htm>
5. http://www.cdc.gov/MotorVehicleSafety/Teen_Drivers/teendrivers_factsheet.html
6. Krug EG et al., eds. World report on violence and health. Geneva, World Health Organization, 2002.
7. <http://www.cdc.gov/violenceprevention/suicide/datasources.html>
8. https://www.rand.org/content/dam/rand/pubs/technical_reports/2009/RAND_TR622.pdf
9. <http://www.cdc.gov/nchs/fastats/drug-use-illegal.htm>
10. <http://www.cdc.gov/alcohol/fact-sheets/alcohol-use.htm>
11. Centers for Disease Control and Prevention. Web-based injury Statistics Query and Reporting System (WiSQARS). Atlanta, GA: National Center for injury Prevention and Control. Available at http://www.cdc.gov/injury/wisqars/leading_causes_death.html. Last updated January 2015.
12. Census,Instat 2011.
13. Sjelljet me risk tek të rinjtë e shkollave te mesme".fq 10-15
14. Sjelljet me risk tek të rinjtë e shkollave te mesme".fq 15-20
15. Wikipedia. Tregues sipas Qarqeve. Popullsia e Qarkut Elbasan
16. Morbidity and Mortality Weekly Report-Methodology of the Youth Risk Behavior Surveillance System — March 1, 2013
17. Krug et al., "World report on violence and health", World Health Organization, 2002
18. Mercy, J.A., Butchart, A., Farrington, D., Cerda, M. (2002). Youth violence. In Etienne Krug, L.L. Dahlberg, J.A. Mercy, A.B. Zwi & R. Lozano (Eds.), World Report on Violence and Health pp 23–56. Geneva, Switzerland: World Health Organization
19. http://www.who.int/social_determinants/sdh_definition/en/

20. Mercy J, Butchart A, Farrington D, Cerdá M. Youth violence. in: Krug E, Dahlberg LL, Mercy JA, Zwi AB, Lozano R, editors. World report on violence and health. Geneva (Switzerland):World Health Organization; 2002. p. 25–56.
21. <http://www.cdc.gov/ViolencePrevention/sexualviolence/riskprotectivefactors.html>
22. Chang, B; Gitlin, D; Patel, R (September 2011). "The depressed patient and suicidal patient in the emergency department: evidence-based management and treatment strategies". *Emergency medicine practice* 13 (9): 1–23; quiz 23–4. PMID 22164363
23. Stedman's medical dictionary (28th ed.). Philadelphia: Lippincott Williams & Wilkins. 2006. ISBN 978-0-7817-3390-8.
24. Krug, Etienne (2002). World Report on Violence and Health (Vol. 1). Genève: World Health Organization. p. 185. ISBN 978-92-4-154561-7
25. Gullota, edited by Thomas P.; Bloom, Martin (2002). The encyclopedia of primary prevention and health promotion
26. awton K, van Heeringen K (April 2009). "Suicide". *Lancet* 373 (9672): 1372–81. doi:10.1016/S0140-6736(09)60372-X. PMID 19376453.
27. Pjevac, M; Pregelj, P (October 2012). "Neurobiology of suicidal behaviour". *Psychiatria Danubina*. 24 Suppl 3: S336–41. PMID 23114813.
28. Autry, AE; Monteggia, LM (Nov 1, 2009). "Epigenetics in suicide and depression". *Biological Psychiatry* 66 (9): 812–3. doi:10.1016/j.biopsych.2009.08.033.PMC 2770810. PMID 19833253
29. U.S. Public Health Service 1999)DeLeo D, Bertolote J, Lester, D. Self-directed violence. 2002. Chapter 7.
30. World Health Organization. Preventing suicide: A global imperative. Geneva, Switzerland: WHO; 2014
31. Centers for Disease Control. (2012). Teen drivers: Fact sheet. Accessed from http://www.cdc.gov/Motorvehiclesafety/teen_drivers/teendrivers_factsheet.html
32. <http://www.cdc.gov/nchs/fastats/drug-use-illegal.htm>.
33. Alcoholism and drug dependency 386. biology of addiction - Robert O. Messing <http://www.harrisonsonline.com/>
34. <http://www.cdc.gov/alcohol/fact-sheets/alcohol-use.htm>
35. http://en.wikipedia.org/wiki/Blood_alcohol_content
36. <http://www.cdc.gov/nchs/fastats/drug-use-illegal.htm>.
37. *Pharmacotherapy*. 2013 Feb;33(2):195-209. doi: 10.1002/phar.1187.
38. https://en.wikipedia.org/wiki/Cannabis_sativa

39. <http://www.nlm.nih.gov/medlineplus/methamphetamine.html>
40. Methamphetamine Use and Oral Health (American Dental Association) - PDF
41. Methamphetamine Use and Pulmonary Hypertension (Pulmonary Hypertension Association) – PDF
42. <http://www.drugabuse.gov/publications/drugfacts/cocaine>
43. <http://www.drugabuse.gov/publications/drugfacts/heroin>
44. <http://www.drugabuse.gov/drugs-abuse>
45. O'Donohue, W; K.E. Ferguson (2006). "Evidence-Based Practice in Psychology and Behavior Analysis" (ACCESSDATE = 2008-03-24). *The Behavior Analyst Today* (Joseph D. Cautilli) 7 (3): 335–350. doi:10.1037/h0100155
46. Chambless, D.L. et al. (1998). "An update on empirically validated therapies" (PDF). *Clinical Psychology* (American Psychological Association) 49: 5–14. Retrieved 2008-03-24.
47. http://www.cdc.gov/tobacco/data_statistics/fact_sheets/health_effects/effects_cig_smoking/#definition.
48. U.S. Department of Health and Human Services. *The Health Consequences of Smoking—50 Years of Progress: A Report of the Surgeon General*. Atlanta: U.S. Department of Health and Human Services, Centers for Disease Control and Prevention, National Center for Chronic Disease Prevention and Health Promotion, Office on Smoking and Health, 2014 [accessed 2014 Feb 6].
49. CDC. Youth risk behavior surveillance—United States, 2011. *MMWR* 2012;61(SS-4).
50. Weinstock H, Berman S, Cates W. Sexually transmitted diseases among American youth: incidence and prevalence estimates, 2000. *Perspectives on Sexual and Reproductive Health* 2004;36(1):6-10.
51. CDC. Diagnoses of HIV infection and AIDS in the United States and dependent areas, 2009. *HIV Surveillance Report*, Volume 2.
52. <http://www.cdc.gov/healthyyouth/obesity/facts.htm>
53. Krebs NF, Himes JH, Jacobson D, Nicklas TA, Guilday P, Styne D. Assessment of child and adolescent overweight and obesity. *Pediatrics* 2007;120:S193–S228.
54. Daniels SR, Arnett DK, Eckel RH, et al. Overweight in children and adolescents: pathophysiology, consequences, prevention, and treatment. *Circulation* 2005;111;1999–2002
55. Li C, Ford ES, Zhao G, Mokdad AH. Prevalence of pre-diabetes and its association with clustering of cardiometabolic risk factors and hyperinsulinemia among US adolescents: NHANES 2005–2006. *Diabetes Care* 2009;32:342–347.

56. Guo SS, Chumlea WC. Tracking of body mass index in children in relation to overweight in adulthood. *American Journal of Clinical Nutrition* 1999;70:S145–148
57. Freedman DS, Kettel L, Serdula MK, Dietz WH, Srinivasan SR, Berenson GS. The relation of childhood BMI to adult adiposity: the Bogalusa Heart Study. *Pediatrics* 2005;115:22–27
58. <http://www.cdc.gov/physicalactivity/everyone/health/index.html>
59. U.S. Department of Health and Human Services. Physical Activity Guidelines Advisory Committee report. Washington, DC: U.S. Department of Health and Human Services, 2008.
60. Dietary Guidelines Advisory Committee. Report of the Dietary Guidelines Advisory Committee on the Dietary Guidelines for Americans, 2010, to the Secretary of Agriculture and the Secretary of Health and Human Services. Washington, DC: U.S. Department of Agriculture; 2010.
61. CDC. Recommendations to prevent and control iron deficiency in the United States. *MMWR* 1998;47:1–29
62. Robert Wardinger. *Psikiatria. Çrregullimet e ngrënies*. fq 511,512.
63. Morbidity and Mortality Weekly Report-Methodology of the Youth Risk Behavior Surveillance System vol 63.No 4 —June 13, 2013

9. Aneksë

9.1 Pyetësor

Ky studim është rreth sjelljeve shëndetsore. Është realizuar në mënyrë që ju të na tregoni se çfarë mund të ndikojë në shëndetin tuaj. Informacioni që do të na jepni mund të përmirësojë edukimin shëndetsor tek të rinjtë si ju. MOS E SHKRUANI emrin tuaj në këtë pyetësor. Asnjë nuk do ta dijë se çfarë keni shkruar. Përgjigjuni pyetjeve duke u bazuar në atë se çfarë ju bëni në të vërtetë. Plotësimi i këtij pyetësori është vullnetar. Nëse nuk dëshironi ti përgjigjeni ndonjë pyetjeje, lëreni bosh pa e plotësuar. Pyetjet lidhur me kualifikimin tuaj do të përdoren vetëm për të përshkruar se çfarë lloj studentësh e plotësuan këtë pyetësor. Informacioni nuk do të përdoret për të zbuluar emrin tuaj. Anjë emër nuk do të raportohet. Lexojini të gjitha pyetjet. Kur të keni mbaruar, ndiqni udhëzimet e personit që po e bën këtë studim. Falemnderit për ndihmën tuaj.

Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme lidhur me Masat mbrojtëse në rrugë: Siguria në rrugë

Keni përdorur kokore në biçikletë dhe motor?:

1.Asnjëherë 2.Rrallë 3.Një pjesën më të madhe të kohës

Keni përdorur rripin e sigurimit në makinë?

1.Asnjëherë 2.Rrallë 3.Në pjesën më të madhe të kohës

Keni udhëtuar ndonjëherë me makinë nga persona që kanë konsumuar alkool?

1.Po 2.Jo 3.Nuk jam i sigurt

I keni dhënë makinës kur keni pasë konsumuar alkool?

1. 0 herë 2. 1 -3 herë 3.Më shumë se 3 herë

Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme lidhur me Dhunën :

1.Keni mbajtur ndonjëherë një armë si, pistoletë, thikë?

1.Po 2.Jo

2.Jeni përfshirë ndonjëherë në një zënie (ndeshje) fizike ?

1.Po 2.Jo

3.Jeni përfshirë ndonjëherë në një zënie (ndeshje) fizike, në të cilën ju jeni dëmtuar dhe keni patur nevojë për trajtim mjekësor?

1.Po 2. Jo

4.Gjatë 12 muajve të fundit, sa herë jeni ndeshur fizikisht brenda ambjenteve të shkollës?

1.Po 2. Jo

5.Gjatë 12 muajve të fundit, ju ka goditur i/e dashuri/a me shuplakë apo ju ka dëmtuar fizikisht?

1.Po 2. Jo

6.Ju kanë detyruar të keni marrëdhënie seksuale, kur ju nuk keni dashur?

1.Po 2.Jo

Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme lidhur me Vetëvrasjen :

1.Keni menduar ndonjëherë seriozisht për të vrrarë veten?

1.Po 2.Jo

2.Keni bërë ndonjëherë plan se si mund të vrisni veten?

1.Po 2.Jo

3.Jeni përpjekur ndonjëherë të vrisni veten ?

1.Po 2.Jo

4.Gjatë 12 muajve të fundit, sa herë keni tentuar të vrisni veten?

1. 0 herë 2. 1 ose më shumë herë

5.Nëse keni tentuar të vetëvriteni gjatë 12 muajve të fundit, keni rezultuar i dëmtuar, i helmuar, apo me mbidozë sa që keni kërkuar trajtim mjekësor?

1.Nuk kam tentuar 2.Po 3.Jo

Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme lidhur me Konsumin e duhanit :

1.Keni provuar ndonjëherë të pini duhan, qoftë edhe një ,apo dy puf ?

1.Po 2.Jo

2.Sa vjeç ishit kur keni pi një cigare të plotë për herë të parë ?

1.Nuk kam pi asnjëherë 2. 16 vjeç ose më i vogël 3.17 vjeç

4.18 ose më i madh

3.Gjatë 30 ditëve të fundit, sa ditë keni pi duhan?

1.0 ditë 2.1-2 dit 3.3-5 ditë 4.6-9ditë

5.10-19 ditë 6.20-29 ditë 7.Të 30 ditët

4.Gjatë 30 ditëve të fundit, si i siguronit zakonisht cigaret?

1.Nuk kam pi cigare gjatë 30 ditëve të fundit 2.I bleva në një dyqan si, supermarket

- 3.I bleva tek një makinë shitëse 4. Ia dhashë dikujt tjetër paratë që të mi blinte
 5.Ia mora dikujt borxh 6.Një person mbi 18 vjeç ose më i madh mi dha cigaret
 7.I mora nga një person i familjes 8.I sigurova në një mënyrë tjetër
 5.Keni pi gjatë 30 ditëve të fundit duhan në ambiente shkollore?

1.Jo 2.Po

6.Gjatë 12 muajve të fundit keni tentuar të ndërprisni pirjen e duhanit ?

1.Nuk kam pi duhan gjatë 12 muajve të fundit

2. Po 3. Jo

Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme lidhur me Përdorimin e Alkoolit :

1.Keni pi ndonjëherë pije alkoolike, më pak se disa gllënka ?

1.Po 2. Jo

2.Sa vjeç ishit kur keni pi për herë të parë alkool disa gllënka ?

1.Nuk kam pi asnjëherë alkool 2.16 vjeç ose më i vogël

3. 17 vjeç 4.18 vjeç ose më i madh

3.Gjatë 30 ditëve të fundit në sa ditë keni pi një pije alkoolike ?

1. 1 ditë 2. 2 ditë 3. 3 ditë 4. 4-5 ditë

5. 10-20 ditë 6.Të 30 ditët 7. 0 ditë

4.Gjatë 30 ditëve të fundit, si e keni siguruar alkoolin që keni pi?

1. Nuk kam pi alkool gjatë 30 ditëve të fundit

2.E bleva në një dyqan pijesh apo në supermarket 3.E mora në një restorant

4.Ma dha dikush 5.E mora në një mënyrë tjetër

Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme lidhur me Drogat :

Marihuana

1.Gjatë jetës suaj,sa herë keni përdorur marihuanë ?

1. 0 herë 2.1 ose 2 herë 3. 3 ose më shumë herë

2.Gjatë 30 ditëve të fundit sa herë keni përdorur marihuanë?

1. 0 herë 2. 1 ose 2 herë 3. 3 ose më shumë herë

3.Gjatë 30 ditëve të fundit sa herë keni përdorur marihuanë në një territor shkolle ?

1. 0 herë 2. 1 ose 2 herë 3. 3 ose më shumë herë

Kokaina

1.Gjatë jetës suaj sa herë keni përdorur kokainë?

1. 0 herë 2. 1 ose 2 herë 3. 3 ose më shumë herë

2.Gjatë 30 ditëve të fundit sa herë keni përdorur kokainë?

1. 0 herë 2. 1 ose 2 herë 3. 3 ose më shumë herë

Heroina

1.Gjatë jetës suaj sa herë keni përdorur heroinë?

1. 0 herë 2. 1 ose 2 herë 3. 3 ose më shumë herë

Metamfetaminë

1.Gjatë jetës suaj sa herë keni përdorur metamfetaminë?

1.0 herë 2. 1 ose 2 herë 3. 3 ose më shumë herë

Ekstazi

1.Gjatë jetës suaj sa herë keni përdorur ekstazi?

1.0 herë 2. 1 ose 2 herë 3. 3 ose më shumë herë

2.Gjatë jetës suaj sa herë keni përdorur pilula steroide pa recetën e mjekut?

1.0 herë 2. 1 ose 2 herë 3. 3 ose më shumë herë

3.Gjatë jetës suaj sa herë keni përdorur një drogë të lejuar (të tilla si vikodinë, xanax, aderall, kodeinë) pa recetën e mjekut?

1.0 herë 2. 1 ose 2 herë 3. 3 ose më shumë herë

4. Gjatë jetës suaj sa herë keni përdorur një shiringë për të injektuar një drogë të palejuar në trup ?

1. 0 herë 2. 1 herë ose 2 herë 3. 3 ose më shumë herë

5.Gjatë 12 muajve të fundit, ju ka ofruar, shitur apo dhënë, një drogë të palejuar në territor shkollor?

1. Po 2. Jo

Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme lidhur me Sjelljet seksuale :

1.Keni patur ndonjëherë raporte seksuale?

1. Po 2. Jo

2.Sa vjeç ishit kur patët raporte seksuale për herë të parë?

1. nuk kam patur asnjëherë raporte seksuale 2. 11 vjeç ose më i ri

3. 12 vjeç 4. 13 vjeç 5. 14 vjeç

6. 15 vjeç 7. 16 vjeç 8. 17 vjeç ose më i madh

3. Gjatë jetës suaj me sa partnerë keni patur raporte seksuale?

1. Nuk kam patur asnjëherë raporte seksuale 2. 1 person

3. Më shumë se 1 person

4. Përdoret alkool apo ndonjë drogë përpara se të kryenit marrëdhënie seksuale, herën e fundit?

1. Nuk kam patur asnjëherë raporte seksuale

2. Po 3. Jo

5. Herën e fundit që kryet marrëdhënie seksuale, përdori partneri juaj kondom?

1. Nuk kam patur asnjëherë raporte seksuale

2. Po 3. Jo

6. Herën e fundit që kryet marrëdhënie seksuale, çfarë metode përdorët ju apo partneri juaj për të parandaluar një shtatzani?

1. Nuk kam kryer asnjëherë marrëdhënie seksuale 2. Nuk kam përdorur asnjë lloj metode

3. Pilula 4. Depo-Provera, dispozitiv intrauterin 5. Kondom ose ndonjë metodë tjetër

Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme lidhur me peshën trupore:

1. Çfarë jeni duke bërë aktualisht në lidhje me peshën tuaj?

1. Po bie nga pesha 2. Po shtoj në peshë 3. Po ruaj peshën që kam

4. Nuk po bëj asgjë në lidhje me peshën trupore

2. Gjatë 30 ditëve të fundit keni ndenjur 24 orë ose më shumë pa ngrënë në mënyrë që të bini nga pesha apo të ruheni nga shtimi në peshë?

1. Po 2. Jo

3. Gjatë 30 ditëve të fundit keni përdorur pilula apo lëngje pa përshkrimin e mjekut në mënyrë që të bini nga pesha apo të ruheni nga shtimi në peshë?

1. Po 2. Jo

4. Gjatë 30 ditëve të fundit, keni përdorur laksativë apo keni vjellë në mënyrë që të bini nga pesha apo të ruheni nga shtimi në peshë ?

1. Po 2. Jo

Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme lidhur me Aktivitetin fizik:

1.Gjatë 7 ditëve, në sa ditë keni qenë fizikisht aktivë të paktën 20 minuta në ditë (shënoni të gjithë kohën që keni harxhuar në çdo lloj aktiviteti fizik që rrit pulsën apo ju ka shpeshtësuar frymëmarrjen)?

1. 1 ditë 2. 2 ditë 3. 3 ditë 4. 4 ditë
5. 5 ditë 6. 6 ditë 7. 7 ditë 8. 0 ditë

2.Gjatë ditëve normale të shkollës, sa orë në ditë luani më video lojra apo kompjuter, apo përdorni kompjuterin për punë jashtë shkolle si facebook, internet?

1. Në ditët e shkollës nuk luaj më video lojra apo kompjuter 2. Më pak se një orë në ditë
3. Një orë në ditë 4. 2 orë në ditë 5. 3 orë në ditë
6. 4 orë në ditë 7. 5 ose më shumë orë në ditë

3.Gjatë ditëve normale të shkollës, sa orë në ditë shikoni televizor?

1. Në ditët e shkollës nuk shoh televizor 2. Më pak se një orë në ditë
3. Një orë në ditë 4. 2 orë në ditë 5. 3 orë në ditë
6. 4 orë në ditë 7. 5 ose më shumë orë në ditë

4.Gjatë një jave normale të shkollës, në sa ditë jave shkoni në orët e edukimit fizik?

1. 0 ditë 2. 1 ditë 3. 2 ditë
4. 3 ditë 5. 4 ditë 6. 5 ditë

Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme lidhur me Mënyrën e Ushqyerjes:

1.Gjatë 7 ditëve të fundit, sa herë keni pi lëng të pastër(të shtrydhur) frutash?

1. Nuk kam pi gjatë 7 ditëve të fundit 2. Kam pi 1-3 herë gjatë 7 ditëve të fundit
3. 6 herë gjatë 7 ditëve 4. 1 herë në ditë 5. 2 herë në ditë
6. 3 herë në ditë 7. 4 ose më shumë herë në ditë

2.Gjatë 7 ditëve të fundit sa herë keni ngrënë fruta(përfshijto lëngjet e e frutave)?

- 1.Nuk kam ngrënë gjatë 7 ditëve të fundit 2. Kam ngrënë 1-3 herë gjatë 7 ditëve të fundit
3. 4-6 herë gjatë 7 ditëve 4. 1 herë në ditë 5. 2 herë në ditë
6. 3 herë në ditë 7. 4 ose më shumë herë në ditë

3.Gjatë 7 ditëve të fundit sa herë keni ngrënë sallatë jeshile?

- 1.Nuk kam ngrënë gjatë 7 ditëve të fundit 2. Kam ngrënë 1-3 herë gjatë 7 ditëve të fundit

3. 4-6 herë gjatë 7 ditëve 4. 1 herë në ditë 5. 2 herë në ditë

6. 3 herë në ditë 7. 4 ose më shumë herë në ditë

4.Gjatë 7 ditëve të fundit sa herë keni ngrënë perime ?

1.Nuk kam ngrënë gjatë 7 ditëve të fundit 2. Kam ngrënë 1-3 herë gjatë 7 ditëve të fundit

3. 4-6 herë gjatë 7 ditëve 4. 1 herë në ditë 5. 2 herë në ditë

6. 3 herë në ditë 7. 4 ose më shumë herë në ditë

5.Gjatë 7 ditëve të fundit sa herë keni pi lëngje të tilla si soda, pepsi, kola, sprite?

1.Nuk kam pi gjatë 7 ditëve të fundit 2. Kam pi 1-3 herë gjatë 7 ditëve të fundit

3. 4-6 herë gjatë 7 ditëve 4. 1 herë në ditë 5. 2 herë në ditë

6. 3 herë në ditë 7. 4 ose më shumë herë në ditë

6.Gjatë 7 ditëve të fundit sa gota me qumësht keni pi?

1. Nuk kam pi fare gjatë 7 ditëve të fundit 2. 1-3 gota gjatë 7 ditëve të fundit

3. 4-6 gota gjatë 7 ditëve të fundit 4. 1 gotë në ditë

5. 2 gota në ditë 6. 3 gota në ditë 7. 4 ose më shumë gota në ditë.

7.Gjatë 7 ditëve të fundit, sa herë keni ngrënë mëngjes?

1. 0 ditë 2. 1 ditë 3. 2 ditë 4. 3 ditë

5. 4 ditë 6. 5 ditë 7. 6 ditë 8. 7 ditë

Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme lidhur me Informacionin rreth Shëndetit:

1.Ju kanë mësuar rreth SIDËS apo infeksionit nga HIV në shkollë?

1. Po 2. Jo 3.Nuk jam i/e sigurt

2.Keni bërë ndonjë analize për HIV, virusi që shkakton SIDËN?(mos përfshi rastin nëse e keni bërë kur keni dhuruar gjak)?

1. Po 2. Jo 3.Nuk jam i/e sigurt

3.Kur jeni jashtë për më shumë se një orë në ditët me diell, përdorni kremra mbrojtës me SPF 15 apo më shumë ?

1.Asnjëherë 2.Rrallë 3.Shumicën e kohës

4.Në një ditë normale shkolle sa orë flini mesatarisht ?

1. 4 orë ose më pak 2. 5 orë 3. 6 orë 4. 7 orë 5. 8 orë

6. 9 orë 7. 10 orë ose më shumë

5.Gjatë 12 muajve të fundit, keni folur me mësuesin/mësuesen apo ndonjë të rritur tjetër në shkollën tuaj për ndonjë problem tuaj që mund të keni patur ?

1.Po 2.Jo

Ky është fundi i pyetësorit

Falemnderit për ndihmën tuaj.

9.2 Tabela e kampionimit 1

Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan											
Cikli i parë i studimeve											
Nr	Fakulteti	Programet	Gjithsej			Viti parë		Viti i dytë		Viti i tretë	
			F	M		F	M	F	M		
1	Fakulteti Ekonomik	Ekonomia dhe e drejta	405	209	196	49	65	55	83	105	48
		Financë kontabilitet	440	280	160	79	51	93	61	108	48
		Administrim biznes	421	197	224	53	60	70	74	74	90
		Informatikë ekonomike	418	106	312	24	103	34	105	48	104
		Ekonomi turizmi	180	77	103	18	25	29	42	30	36
		Administrim biznes dhe inxhinieri	198	56	142	12	44	24	54	20	44
		Shkenca juridike në biznes	116	70	46	37	19	33	27		
		Shkenca juridike në Sektorin Publik	123	78	45	45	15	33	30		
		Gjithsej FE	2301	1073	1228	317	382	371	476	385	370
2	Fakulteti Shkenacave të Edukimit	Punonjës social	214	149	65	42	20	55	22	52	23
		Psikologji	224	186	38	57	14	68	14	61	10
		Filozofi sociologji	179	103	76	30	19	43	28	30	29
		Edukatë qytetare	186	97	89	33	24	37	35	27	30
		Cikli ulët	342	289	53	102	17	97	19	90	17
		Parashkollorë	210	206	4	79	1	72	1	55	2
		Edukim fizik dhe sporte	183	29	154	9	39	9	66	11	49
		Gjithsëj FSHE	1538	1059	479	352	134	381	185	326	160
3	Fakulteti Shkencape Humane	Anglisht	348	234	114	75	23	75	47	84	44
		Gazetari	148	86	62	20	25	34	23	32	14
		Italisht	111	52	59	11	15	22	25	19	19
		Frëngjisht	48	24	24	9	4	8	9	7	11
		Gjermanisht	19	4	15			3	6	1	9
		Gjuhë letërsi	277	235	42	84	19	87	7	64	16
		Histori gjeografi	235	139	96	46	33	49	34	44	29
		Histori dhe gjuhë gjermane	49	21	28			9	14	12	14
		Gjeografi dhe gjuhë italiane	178	80	98	22	21	29	41	29	36
		Gjuhë shqipe dhe frënge	63	29	34			17	17	12	17
		Gazetari Anglisht	162	92	70	25	21	32	24	35	25
		Gjuhë shqipe dhe Rome	0	0	0						
		Gjithsej FSHH	1638	996	642	292	161	365	247	339	234
4	Fakulteti Shkencape Mjeksore Teknike	Infermieri mami	303	294	9	75	0	109	5	110	4
		Infermieri e përgjithshme	433	355	78	131	28	117	22	107	28
		Fizioterapi	253	170	83	50	30	68	31	52	22
		Logopedi	112	86	26	37	6	49	20	0	0
		Imazheri	131	91	40	47	18	44	22	0	0
		Teknik laborator	115	82	33	35	13	47	20	0	0
		Gjithsej FSHMT	1347	1,078	269	375	95	434	120	269	54
5	Fakulteti Shkencape të Natyrës	Matematike fizike	175	77	98	28	22	30	33	19	43
		Biologji kimi	286	193	93	62	26	67	30	64	37
		Teknologji informacioni	377	53	324	4	75	21	111	28	138
		Fizikë kompjuterike	137	12	125	2	38	5	45	5	42
		Teknolog laborant	140	76	64	16	14	29	25	31	25
		Matematikë Informatike	51	22	29	13	12	9	17	0	0
		Gjithsej FSHN	1166	433	733	125	187	161	261	147	285
Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan			7990	4639	3351	1461	959	1712	1289	1466	1103

9.3 Tabela e kampionimit 2

Rrethi	Nr.	Emri i shkollës së mesme (gjimnaz+profesionale)	Nxënës të shkollës		Nr.klasave gjithsej	klasa 10		Nr.para leleve	klasa 11		Nr.para leleve	klasa 12		Nr.pareleleve	klasa 13		Nr.pareleleve
			GJ	F		GJ	F		GJ	F		GJ	F				
Librazhd	1	Halit Berzeshta	462	291	14	180	111	5	127	75	4	155	105	5			
Librazhd	2	Halit Berzeshta (Mekanike)	82	0	4	22	0	1	19	0	1	18	0	1	23	0	1
Librazhd	3	Ibrahim Muça	737	382	20	252	124	7	248	133	6	237	125	7			
Librazhd	4	Polis Gostimë	153	81	6	40	22	2	49	23	2	64	36	2			
Librazhd	5	Dialaver Nezha	524	260	24	71	39	2	53	27	2	68	27	2			
Librazhd	6	Shefqet Dosku	130	66	6	49	28	2	45	21	2	36	17	2			
Librazhd	7	Isak Alla	91	44	3	34	14	1	23	12	1	31	18	1			
Librazhd	8	Orenjë	132	52	5	60	28	2	44	12	2	28	12	1			
Librazhd	9	Rrahman Çota	257	122	9	83	38	3	87	41	3	87	43	3			
Librazhd	10	Arif Kuka	151	82	6	58	30	2	43	25	2	50	27	2			
Librazhd	11	Ahmet Elezi	74	38	3	23	11	1	23	12	1	28	15	1			
Librazhd	12	Dalip Toçka	59	26	3	21	9	1	18	10	1	19	7	1			
Librazhd	13	Sali Halili	320	158	10	123	56	4	84	46	3	109	56	3			
Elbasan	1	Mihal Shahini	367	47	14	99	9	4	123	16	4	138	22	4	29	0	2
Elbasan	2	Sali Ceka	891	211	30	460	111	14	260	73	9	107	18	4	69	6	3
Elbasan	3	Ali Myftiu	1030	85	37	446	43	13	297	24	10	230	10	9	125	5	5

Elbasan	4	Kostandin Shpataraku	169	83	6	69	33	2	48	27	2	53	23	2			
Elbasan	5	Kodhel Dedja	52	33	3	19	16	1	19	7	1	16	11	1			
Elbasan	6	Miranda Baku	284	181	10	99	60	4	115	76	3	81	50	3			
Elbasan	7	Pedagogjike	409	260	10	144	92	3	120	76	3	143	91	4			
Elbasan	8	Tomorr Sinani	363	209	12	132	76	4	134	73	4	129	73	4			
Elbasan	9	Kosovë	52	29	3	26	10	1	21	13	1	16	9	1			
Elbasan	10	Sami Frashëri	476	297	17	190	111	6	153	84	5	156	110	6			
Elbasan	11	Mahmut & Ali Cungu	349	170	13	123	47	4	121	65	4	128	59	5			
Elbasan	12	Onufri	146	46	7	41	14	2	36	8	2	38	14	2	30	6	1
Elbasan	13	Sali N.Ballkoçi	130	63	6	43	17	2	42	20	2	49	28	2			
Elbasan	14	11 Dëshmorët	92	40	3	31	15	1	24	9	1	37	16	1			
Elbasan	15	Mehmet Bajraktari	148	95	6	55	35	2	44	23	2	60	41	2			
Elbasan	16	Kostandin Kristoforidhi	820	498	31	309	191	8	340	192	9	370	199	10	198	58	4
Elbasan	17	Dhaskal Todri	791	451	24	340	181	9	238	142	8	252	148	7			
Elbasan	18	Vasil Kamami	448	253	13	177	90	5	147	74	4	144	92	4			
Elbasan	19	Mahir Domi	325	184	12	107	56	3	116	64	4	125	68	5			
Elbasan	20	Anastas Çakalli	347	210	11	126	69	4	105	65	3	127	83	4			
Elbasan	21	Ibrahim Ceka	81	36	3	33	22	1	33	9	1	28	12	1			

Elbasan	22	Osman Gjini	331	215	12	128	75	4	101	60	4	124	85	4			
Elbasan	23	Ibrahim Bozhiq	88	36	3	33	17	1	36	12	1	29	14	1			
Elbasan	24	Dëshiran	141	32	6	44	17	2	56	32	2	42	34	2			
Elbasan	25	Fiqiri Balteza	148	79	6	57	25	2	52	29	2	42	24	2			
Elbasan	26	Ahmet Dakli	599	329	20	213	111	7	202	110	6	207	116	7			
Elbasan	27	Liria	168	0	7	52	0	2	66	0	3	51	0	2			
Elbasan	28	Arianiti	59	35	6	15	12	2	23	13	2	20	9	2			
Elbasan	29	Iliria	74	24	3	3	3	1	5	2	1	4	4	1			
Elbasan	30	Nikolla Koperniku	52	30	3	15	10	1	16	10	1	24	12	1			
Elbasan	31	Inkus	45	23	3	9	5	1	15	6	1	12	6	1			
GRAMSH	1	"Shefqet Guzi"	627	328	22	214	99	7	198	109	7	215	120	8			
GRAMSH	2	"Muharrem Zela"	108	47	3	35	20	1	31	12	1	42	15	1			
GRAMSH	3	"Tahir Sadiku"	35	16	3	13	6	1	12	6	1	10	4	1			
GRAMSH	4	"Afez Berbiu"	85	41	3	27	14	1	25	10	1	33	17	1			
GRAMSH	5	"Çaush Senja"	62	25	3	23	11	1	12	3	1	27	11	1			
GRAMSH	6	"Xhile Liçi"	54	30	3	17	10	1	22	13	1	15	7	1			
GRAMSH	7	"Xhezar Meçi"	93	64	3	35	24	1	31	21	1	27	19	1			
GRAMSH	8	"Jonuz Çarçiu"	68	28	3	23	11	1	23	11	1	22	6	1			

PEQIN	1	Zihni Magani (Gjimnaz)	398	200	15	146	64	5	120	64	5	132	72	5			
PEQIN	2	M.K.Ataturk (Gjimnaz)	474	248	15	160	89	5	159	89	5	155	70	5			

10.Përmbledhje

Qëllimi: Disa nga sjelljet në risk që kontribuojnë në shkaqet kryesore të vdekjes dhe paaftësisë tek të rinjtë dhe të rriturit, përfshijnë: Sjelljet që kontribuojnë për lëndime të paqëllimshme dhe dhunë, sjelljet seksuale që kontribuojnë për shtatzani të padëshiruar dhe sëmundje seksualisht të transmetueshme, duke përfshirë infeksionin HIV, përdorimi i alkoolit dhe droga të tjera, përdorimi i duhanit, sjelljet dietetike të pashëndetshme. Të dhënat lidhur me nivelin e këtyre sjelljeve në qarkun e Elbasanit janë shumë të kufizuara. Në këtë kontekst, qëllimi i këtij studimi është gjetja e prevalencës së sjelljeve në risk në të rinjtë e moshës shkollore në qarkun e Elbasanit. Ky studim synon marrjen e informacionit të nevojshëm të prevalencës së sjelljeve në risk sipas moshës, gjinisë, venbanimit- fshat/ qytet, i cili do të ndihmojë në gjetjen dhe përcaktimin e moshave dhe kategorive më të rrezikuara nga sjelljet në risk, dhe do të ndihmojë gjithashtu në hartimin dhe planifikimin e politikave ndërhyrëse në nivele të ndryshme, në nivel rajonal e më gjerë duke synuar në uljen e prevalencës së sjelljeve në risk në moshat e reja në qarkun e Elbasanit.

Materialet dhe metodat: Urealizua një studim i tipit i transversal, deskriptiv dhe analitik. Për të njehsuar prevalencën e sjelljeve në risk u llogarit numri i subjekteve të marrë në studim, i cili rezultoi me 970 të rinj, nga të cilët 900 prej tyre iu përgjigjën pyetsorit. Shkalla e përgjigjes ishte 92.3%. U përdor zgjedhja e popullatës me tufëza (clustër), e randomizuar për vlerësimin e sjelljeve riskante.

Rezultatet: 61.3%, e subjekteve ishin femra dhe 38.7% ishin meshkujt. Shikuar për moshë, moshat mbi 18 vjeç përbënin numrin më të madh të subjekteve të marrë në studim, 36%. Sipas shpërndarjes në klasa, klasat e 10 ishin më të shumta në numër (32%). 28.3% e subjekteve jetonin në fshat dhe 71.7% në qytet. Pjesa më e madhe e të rinjve nuk i zbatonin rregullat kur qarkullonin me mjete të ndryshme motorrike ose jomotorrike. Pjesa më e madhe e meshkujve deklaroi se kishin mbajtur armë dhe ishin konfrontuar fizikisht në ambiente shkolle. Femrat raportuan më tepër se kishin bërë plan dhe tentativë për të vrarë veten. Përdorimi i duhanit dhe i alkoolit u raportua i lartë në moshë të vogël dhe më tepër tek djemtë. Gjithashtu përdorimi i drogave u raportua më i lartë tek djemtë dhe ua kishin ofruar dhe konsumuar në ambiente shkolle. Një pjesë e të rinjve e kishin filluar aktivitetin seksual në moshë të vogël dhe nuk kishin përdorur metoda mbrojtëse. Pjesa më e madhe e të rinjve nuk hanin mëngjes dhe përdornin më tepër pije dhe produkte të konservuara sidomos ata që jetojnë në qytet. Pjesa më e madhe e të rinjve nuk flasin me të rriturit për probleme që ata mund të kenë patur.

Përfundime : Të dhënat e studimit tonë ishin të krahasueshme me ato të studimit të bërë nga ISHP dhe të dhënat nga studimi i bërë nëpërmjet YRBSS - Youth Risky Behaviors Surveillance System- SMSRR - Sistemi i Mbikqyrjes së Sjelljeve Riskante tek të Rinjtë(SH.B.A). Është e nevojshme ndërmarrja e programeve të ndryshme edukuese në nivel bashkëmoshatar, prindëror, në nivel shkolle dhe komuniteti. Gjithashtu përfshirja e profesionistëve të shëndetësisë sidomos të shëndetit publik në hartimin e programeve të ndryshme që ndikojnë në shëndetin e të rinjve në nivel rajonal dhe kombëtar.

Fjalë Kyçe: Studim transversal, Elbasan , sjellje në risk, të rinjtë, shkolla.

Abstract

Purpose: Some of the risk behaviors that contribute to the leading causes of death and disability among young people and adults, include: behaviors that contribute to unintentional injuries and violence, sexual behaviors that contribute to unintended pregnancies and sexually transmitted diseases, including HIV infection, alcohol and other drug use, tobacco consumption, unhealthy dietary behaviors. Data regarding the level of these behaviors in the city of Elbasan are very limited. So the goal of this study is to find the prevalence of risk behaviors in young people of school age in Elbasan. This study aims to obtain the necessary information for the prevalence of risk behaviors by age, gender, location rural / urban, which will help in locating and determining the ages and the most vulnerable categories of risk behaviors and will also help planning policies and programs at various levels, such as at the regional level and beyond, aiming to reduce the prevalence of risk behaviors at youth in Elbasan.

Materials and methods: It was conducted a transversal study, a descriptive and analytical one. To gauge the prevalence of risk behaviors was estimated the number of subjects that took part the study, which resulted in 970. 900 of them responded the questionnaire. The response rate was 92.3%. It was used the bundles choice of population (cluster), the randomized evaluation of the risk behaviors .

Results: 61.3% of persons were females and 38.7% were males. According for age, people over 18 years old were most of the individuals that took part in the study, 36%. According the distribution in classes, grades 10th were greater in number(32%). 28.3% lived in the rural areas and 71.7% in the urban ones. Most of the young people did not follow the rules when they circulated through various motorized or non motorized vehicles. Most of the males declared that had carried guns and were confronted physically in school environments. Females reported mostly that had originally planned and attempted to kill themselves. The consumption of tobacco and alcohol was reported higher at a younger age and more in males. Although illegal drug use was reported higher among males and those drugs were offered and consumed in school environments. A part of the youth had started sexual activity at a younger age and had not used a protective method. Mostly of youth did not had breakfast and used more canned beverage products, especially those living in urban areas. A great part of young people did not talk about problems they may have had with their adults.

Conclusions: The data of our study were comparable to those of a study made by PHI – Public Health Institute and data drawn from study by YRBSS - Youth Risky Behaviors Surveillance System. It is necessary to undertake different educational programs at peers, parental, school and community levels. It is also important the involvement of health professionals, especially public health, in developing various programs that affect the health of young people in regional and national level.

Keyword: transversal study , Elbasan , risk behavior, youth, schools.